



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit  
Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije  
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

# Strategjia e Arsimit 2022-2026

Prishtinë, 2022



# Strategjia e Arsimit 2022-2026

**MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT**  
Shtator 2022

**Dizajni dhe faqosja:**  
Envinion



## Fjala e Ministres

Arsimi është mundësi për arritjen e potencialit më të lartë njerëzor të një individi dhe, si i tillë, është burim shumë i rëndësishëm për zhvillimin shoqëror e ekonomik të vendit. Prandaj, secili/a prej nesh në rolet tona kemi përgjegjësi ndaj fëmijëve dhe të rinjve tanë që t'u mundësojmë atyre arsimim e zhvillim cilësor. Strategjia e Arsimit, si dokument bazë për zhvillimin e sektorit të arsimit në pesë vitet e ardhshme, është përqendruar në analizën e gjendjes në fushat e rëndësishme parësore të sektorit të arsimit, të përcaktuara me Programin e Qeverisë 2021-2025 dhe në dokumentet e tjera të politikave shtetërore si dhe në vlerësimin e zbatimit të strategjisë paraprake. Strategjia shpreh përcaktimin tonë që Republika e Kosovës të jetë pjesë e trendit global për zhvillim të qëndrueshëm dhe është hartuar në frymën e Agjendës 2030 të miratuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, në veçanti të objektivit SDG4: “Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të drejtë dhe nxitja e mundësive për mësim gjatë gjithë jetës për të gjithë”. Si rrjedhojë, Strategjia 2022-2026 është organizuar në pesë shtylla.

Shtylla e parë është edukimi në fëmijërinë e hershme, ku synojmë rritje domethënëse të pjesëmarrjes së fëmijëve të moshës 0-5 vjeç, por edhe përmirësim të cilësisë së shërbimeve. Edukimi i hershëm cilësor, përveçse u mundëson fëmijëve të përgatiten më mirë dhe të shënojnë rezultate më të mira më vonë në shkollë, ndikon edhe në uljen e pabarazisë në shoqëri. Të vetëdijshëm për ndikimin e madh që ka edukimi i hershëm, investimin në këtë fushë e konsiderojmë thelbësor për zhvillim të gjithmbarshëm shoqëror dhe ekonomik.

Shtylla tjetër është ngritja e cilësisë së arsimit parauniversitar, ku fokusi ynë do të jetë ndërtimi dhe konsolidimi i mekanizmave për mësimdhënie cilësore dhe sigurim të cilësisë. Në këtë drejtim, do ta përmirësojmë performancën në menaxhimin e shkollës, do t'i vëmë në funksion sistemet për sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë në shkollë, do të sigurojmë zbatim efektiv të kurrikulës së re, duke i kushtuar kujdes të veçantë përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe vlerësimit.

Harmonizimi i arsimit dhe aftësisë profesionale me zhvillimet e teknologjisë dhe tregut të punës, paraqet një shtyllë bartëse për të siguruar fuqi punëtore të kualifikuar dhe të përgatitur mirë që është parakusht për zhvillimin e gjithmbarshëm të vendit. Përveç mësimin dual, i cili ofron mundësi për kombinim të mësimin teorik me mësimin në vendin e punës, Strategjia parashih përmirësimin e qeverisjes dhe të menaxhimit në fushën e arsimit dhe aftësisë profesionale, si dhe fuqizimin e sigurimit të cilësisë.

Shtylla e katërt është cilësia, integriteti dhe konkurrueshmëria e arsimit të lartë. Përmes ndryshimeve në legjisllacion, Qeveria do të sigurojë pavarësinë e Agjencisë së Kosovës për Akreditim, si bartës kryesor i sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Ndërkaq, përmes financimit në bazë të performancës synohet rritja e përgjegjësisë dhe llogaridhënies në institucionet publike të arsimit të lartë. Po ashtu, masat e parapara synojnë ta institucionalizojnë kontrollin anti-plagjiaturë, ta rrisin transparencën në arsimin e lartë, të sigurojnë qasje në literaturë bashkëkohore digjitale, t'i mbështesin studentët përmes skemave të ndryshme të bursave dhe të zhvillojnë programe ndërkombëtare të bashkëpunimit akademik dhe shkencor, me qëllim të përafrimit të mëtejshëm të sektorit të arsimit të lartë me standardet ndërkombëtare.

Në përputhje me trendet globale dhe duke reflektuar në përvojat e viteve të kaluara si pasojë e pandemisë COVID-19, përdorimit të teknologjisë digjitale me qëllim të përmirësimit e shërbimeve dhe të cilësisë në arsim i është kushtuar rëndësi e posaçme në shtyllën e pestë. Në këtë drejtim, do të ketë investime domethënëse në pajisjen e shkollave me teknologji. Synojmë që çdo shkollë të ketë rrjet lokal me qasje në internet të shpejtësisë së lartë, ndërsa secila dhomë mësimi të jetë e pajisur me teknologji të nevojshme për shfrytëzimin e burimeve digjitale. Përveç kësaj, do t'i kushtojmë rëndësi zhvillimit të kompetencës digjitale të gjeneratave të reja dhe të mësimit mësimdhënësve. Investimet në këtë fushë do ta lehtësojnë mësimit mësimdhënien e mësimit mësimdhënien, do të ofrojnë efikasitet në shërbime dhe mundësi të barabarta për nxënësit, studentët e mësimit mësimdhënien, si dhe do të mundësojnë më shumë bashkëpunim ndërmjet komuniteteve brenda sistemit të arsimit dhe më gjerë.

Strategjia e Arsimit 2022-2026, është rezultat i punës së palodhshme 9-mujore të rreth 150 specialistëve të profileve të ndryshme që përfaqësojnë të gjitha palët me interes: qeverinë, pushtetin lokal, punonjësit e arsimit, komunitetin akademik, shoqërinë civile, bizneset dhe partnerët zhvillimorë, të cilët kanë sjellë përvojat e tyre më të mira, njohuritë dhe idetë për avancimin e sistemit të arsimit. Procesi i planifikimit është mbështetur nga Qeveria Gjermane përmes GIZ Kosova.

I falënderoj të gjithë bashkëpunëtorët për kontributin e çmuar dhe përkushtimin gjatë procesit të hartimit të Strategjisë dhe shpresoj në angazhim e bashkëpunim të mëtejshëm drejt jetësisë së saj.

*Me dëshirat më të mira për suksese të përbashkëta,*

*Arbërie Nagavci  
Ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit*

Prishtinë, shtator 2022

## Falënderime

MASHTI dëshiron të shpreh mirënjohje dhe falënderim për të gjithë anëtarët e Ekipit Hartues të kësaj strategjie, anëtarët tjerë të përfshirë në grupe punuese tematike, si dhe partnerët zhvillimorë, të cilët me idetë, përvojën, energjitë, angazhimin dhe punën e tyre kanë kontribuar në hartimin sa më cilësor të kësaj strategjie.

MASHTI falënderon Ministrinë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) e cila përmes *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH* ka mbështetur hartimin e Strategjisë së Arsimit (SA) 2022-26, duke kontribuar me ekspertizë profesionale dhe mbështetje teknike gjatë gjithë procesit hartues. Gjithashtu, MASHTI falënderon Ministrinë Britanike për Punë të Jashtme dhe Zhvillim dhe organizatën DVV International për mbështetjen profesionale të ofruar përmes konsulencës vendore në procesin e planifikimit.

# PËRMBAJTJA

Fjala e Ministres.....	5
Falënderime.....	6
Përmbajtja.....	7
Lista e shkurtesave.....	9
Përmbledhje ekzekutive.....	11
1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit.....	14
2. Metodologjia.....	15
3. Analiza e gjendjes.....	18
3.1. Kuadri makro-ekonomik dhe fiskal.....	19
3.2. Tabloja demografike.....	20
3.3. Të dhëna të përgjithshme për sistemin e arsimit.....	21
3.4. Sfidat dhe mundësitë e mjedisit.....	24
3.4.1. Faktorët politikë.....	24
3.4.2. Faktorët ekonomikë.....	25
3.4.3. Faktorët socialë.....	25
3.4.4. Faktorët teknologjikë.....	27
3.5. Analiza e gjendjes për fushat e Strategjisë.....	29
3.5.1. Edukimi në fëmijërinë e hershme.....	29
3.5.2. Arsimi parauniversitar.....	31
3.5.3. Arsimi, aftësimi profesional dhe arsimi për të rritur.....	37
3.5.4. Arsimi i lartë.....	42
3.5.5. Digjitalizimi i arsimit.....	49
4. Vizioni i Strategjisë.....	53
5. Objektivat.....	54
5.1. Objektivi Strategjik 1 – Edukimi në fëmijërinë e hershme.....	56
5.2. Objektivi Strategjik 2 – Arsimi parauniversitar.....	60
5.3. Objektivi Strategjik 3 – Arsimi, aftësimi profesional dhe arsimi për të rritur.....	70
5.4. Objektivi Strategjik 4 – Arsimi i lartë.....	75
5.5. Objektivi Strategjik 5 – Digjitalizimi i arsimit.....	81
6. Zbatimi, monitorimi dhe raportimi.....	88
6.1. Mekanizmat për zbatim.....	88
6.2. Monitorimi dhe raportimi.....	89
6.3. Vlerësimi.....	91
7. Buxheti i Strategjisë.....	92
8. Shtojcat.....	97
8.1. Shtojca 1 – Plani i veprimit.....	97
8.2. Shtojca 2 – Dokumentet e politikave, legjislacioni dhe raporte hulumtuese.....	100
8.3. Shtojca 3 – Lista e kontribuesve.....	103



## Lista e shkurtesave

<b>ABGJ</b>	Agjencia për Barazi Gjinore
<b>AL</b>	Arsimi i Lartë
<b>APU</b>	Arsimi Parauniversitar
<b>AAP</b>	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
<b>AAPARr</b>	Arsimi, Aftësimi Profesional dhe Arsimi për të Rritur
<b>AAAPARR</b>	Agjencia për Arsim, Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur
<b>ABGJ</b>	Agjencia për Barazi Gjinore
<b>AKA</b>	Agjencia e Kosovës për Akreditim
<b>AKK</b>	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
<b>ASK</b>	Agjencia e Statistikave të Kosovës
<b>ASHI</b>	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>CEEPUS</b>	Programin e Evropës Qendrore për Shkëmbime në Studimet Universitare
<b>DKA</b>	Drejtoria Komunale e Arsimit
<b>ECTS</b>	Sistemi Evropian për Transferin dhe Akumulimin e Krediteve
<b>EFH</b>	Edukimi në Fëmijërinë e Hershme
<b>ENQA</b>	Rrjeti Evropian për Sigurimin e Cilësisë
<b>EQAR</b>	Regjistri Evropian për Sigurim të Cilësisë në Arsimin e Lartë
<b>ET</b>	Arsimi dhe Formimi
<b>GIZ</b>	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH
<b>IAL</b>	Institucion i Arsimit të Lartë
<b>IAAP</b>	Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional
<b>IEAA</b>	Institucionet Edukative Arsimore dhe Aftësuese
<b>IP</b>	Institucionet Parashkollore
<b>IPK</b>	Instituti Pedagogjik i Kosovës
<b>ISCED</b>	Klasifikimi Ndërkombëtar Standard i Arsimit
<b>KEPTSH</b>	Këshilli i Ekspertëve për Programe dhe Tekste Shkollore
<b>KKEFH</b>	Komiteti Këshillëdhënës për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme
<b>KPMS</b>	Kornizën për Planifikim dhe Menaxhim Strategjik
<b>KZHEFH</b>	Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në Fëmijërinë e Hershme
<b>LMS</b>	Sistemi për Menaxhimin e të Mësuarit
<b>MASHTI</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

<b>MCC</b>	Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit
<b>MSA</b>	Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit
<b>NARIC</b>	Qendrës Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik
<b>NjMP</b>	Njohja e Mësimit Paraprak
<b>OECD</b>	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<b>OZHQ</b>	Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm
<b>PIRLS</b>	Progresi në Studimin Ndërkombëtar të Lexim Kuptimit
<b>PISA</b>	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve
<b>PSAK</b>	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
<b>QPM</b>	Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie
<b>QRK</b>	Qeveria e Republikës së Kosovës
<b>QZHK</b>	Qendra për Zhvillim të Karrierës
<b>SA</b>	Strategjia e Arsimit
<b>SBASHK</b>	Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
<b>SDAK</b>	Strategjia për Digjitalizimin e Arsimit në Kosovë
<b>SEMS</b>	Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve
<b>SKZH</b>	Strategjia Kombëtare për Zhvillim
<b>SMIA</b>	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit në Arsim
<b>SMIAL</b>	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit në Arsim e Lartë
<b>SMU</b>	Sistemi i Menaxhimit Universitar
<b>SPH</b>	Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm
<b>TIK</b>	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
<b>TIMSS</b>	Trendet në Studimet Ndërkombëtare në Matematikë dhe Shkencë
<b>UA</b>	Udhëzim Administrativ
<b>UNESCO</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin Shkencën dhe Kulturën
<b>UNICEF</b>	Fondi Ndërkombëtar i Emergjencës për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
<b>VPM</b>	Vlerësimi i Performancës së Mësimdhënësve
<b>ZBGJ</b>	Zyra për Barazi Gjinore
<b>ZPS</b>	Zyra për Planifikim Strategjik
<b>ZHPM</b>	Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve

## Përmbledhje ekzekutive

Strategjia e Arsimit (SA) është dokumenti kryesor për zhvillimin e sektorit të arsimit në Kosovë në periudhën 2022-2026. SA, bazohet në Programin e Qeverisë së Kosovës 2021-2025 dhe analizën e gjendjes të fushave prioritare të sektorit të arsimit.

Përgatitja e Strategjisë së Arsimit ka filluar në muajin gusht 2021 kur është formuar Ekipi Hartues dhe janë formuar grupet punuese dhe nëngrupet tematike. Procesi i përgatitjes së SA 2022-2026, është udhëhequr nga Ekipi Hartues i MASHTI, ndërsa në nivel të fushave prioritare dhe objektivave strategjike janë themeluar grupet punuese dhe ato tematike.

Gjithashtu, Strategjia e Arsimit është hartuar në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2030, përkatësisht me objektivat strategjike dhe specifike si dhe treguesit e ndikimit dhe të produkteve të përcaktuar në kuadër të Shtyllës së Dytë “Zhvillimi i barabartë njerëzor”, objektivin e përgjithshëm “Arsim i qasshëm dhe cilësor”. Dokumenti i SA është organizuar në pesë fusha prioritare që mbulojnë nivelet e arsimit në Kosovë:

**Fusha 1:** Edukimi në fëmijërinë e hershme.

**Fusha 2:** Arsimi parauniversitar.

**Fusha 3:** Arsimi, aftësimi profesional dhe arsimi i të rriturve.

**Fusha 4:** Arsimi i lartë.

**Fusha 5:** Digjitalizimi i arsimit.

SA ka 5 objektiva strategjike, të përcaktuara për 5 fushat prioritare. Objektivat strategjike adresojnë problemet kyçe të fushave prioritare të MASHTI dhe janë zbërthyer në objektiva specifike të cilat korrespondojnë me shkaqet kryesore të problemeve kyçe përkatëse dhe synojnë rezultate më konkrete në perspektivën afatshkurtër. Për secilin objektiv specifik janë identifikuar aktivitetet që çojnë në arritjen e objektivit.

### Objektivi strategjik 1:

#### Rritje e përfshirjes dhe qasje e barabartë në edukimin në fëmijërinë e hershme

Edukimi në Fëmijërinë e Hershme (EFH) synon zhvillimin parësor të nevojave shoqërore, emocionale, njohëse dhe fizike të një fëmije, në mënyrë që të ndërtojë një bazë të fortë dhe të gjerë për të mësuarit dhe mirëqenien gjatë gjithë jetës, prandaj përfshirja dhe pjesëmarrja e barabartë për të gjithë fëmijët në edukimin cilësor të hershëm, nuk mund të realizohet pa krijimin e infrastrukturës adekuate. MASHTI fillimisht do të bëjë një analizë të mirëfilltë për këtë nivel të arsimit, ashtu që të planifikohet tejkalimi i sfidave me të cilat përballlet EFH, siç janë: rritja e numrit të institucioneve parashkollore (IP) dhe organizimi i shpërndarjes adekuate të tyre; zhvillimi i kornizës legjislative, kurrikulës për EFH dhe krijimi i ambientit edukativ cilësor; krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për moshën e fëmijëve; si dhe koordinimi ndërsektorial për ofrimin e shërbimeve cilësore në EFH.

**Objektivi strategjik 2:**

Ngritja e cilësisë së arsimit parauniversitar përmes konsolidimit të mekanizmave për sigurim të cilësisë dhe ofrimit të mësimdhënies cilësore

Për të ngritur cilësinë në arsimin parauniversitar, është e domosdoshme të kemi një sistem i cili ofron llogaridhënie në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit. Për këtë qëllim duhet të kemi një menaxhim efektiv dhe efikas përmes zbatimit dhe avancimit të politikave dhe kornizës ligjore në fushën e arsimit, ngritjes së kapaciteteve dhe forcimit të transparencës dhe llogaridhënies. Për më shumë duhet fuqizuar mekanizmat për zbatimin e sistemit për sigurimin e cilësisë, vlerësim të brendshëm dhe të jashtëm të institucioneve arsimore me fokus në ngritjen e cilësisë, rritjen e besueshmërisë së testeve kombëtare dhe shfrytëzimin e rezultateve për vendimmarrje të bazuar në të dhëna. Gjithashtu, avancimi i cilësisë së arsimit parauniversitar do të arrihet përmes zbatimit efektiv të kurrikulës si dhe fuqizimit të mekanizmit funksional për ta udhëhequr dhe zbatuar atë. Për ngritjen e rezultateve të nxënësve, krahas masave tjera, do të përgatiten tekste cilësore dhe në përputhje me kurrikulën si dhe do të sigurohen mjete, materiale dhe burime mësimore alternative.

**Objektivi strategjik 3:**

Harmonizimi i arsimit dhe aftësisë profesionale me zhvillimet dinamike të teknologjisë dhe tregut të punës, në funksion të mësimit gjatë gjithë jetës

Cilësia e pamjaftueshme e ofertës së arsimit dhe aftësisë profesionale ka rezultuar me shkallë të ulët të kënaqshmërisë së punëdhënësve me shkathtësitë/kompetencat e arritura nga kandidatët e diplomuar në IAAP, si dhe me shkallë të ulët të tranzicionit nga shkolla në punë. Mundësitë për mësim gjatë gjithë jetës dhe mobilitetet janë të kufizuara dhe nuk janë në hap me nevojën për riaftësim të vazhdueshëm të fuqisë punëtore. Rrjedhimisht, përqendrimi kryesor në kuadër të kësaj fushe strategjike është rishikimi i ofertës së arsimit dhe aftësisë profesionale si dhe përmirësimi i cilësisë, në funksion të zhvillimit të shkathtësive të transferueshme, shkathtësive digjitale, shkathtësive të ndërmarrësisë dhe shkathtësive teknike profesionale, në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me trendet e transformimit digjital dhe të gjelbër.

**Objektivi Strategjik 4:**

Përmirësimi i cilësisë, integritetit dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë

Ky objektivi është formuluar në përgjigje të mangësive strukturore në fushën e arsimit të lartë dhe synon të përmirësojë cilësinë dhe integritetin e arsimit të lartë, nëpërmjet zbatimit të procesit të akreditimit në pajtim me standardet ndërkombëtare të cilësisë, që ndër të tjera do të mundësojë rikthimin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim në ENQA dhe EQAR. Reformimi i arsimit të lartë synohet të arrihet nëpërmjet avancimit të kuadrit ligjor, zhvillimit të kapaciteteve të mekanizmave për sigurim të cilësisë, rritjes së pjesëmarrjes në programe ndërkombëtare dhe përmirësimi të infrastrukturës akademike dhe kërkimore. MASHTI, do të rregullojë bazën ligjore dhe rishikojë legjislacionin ekzistues lidhur me formulën e financimit dhe zhvillimin e një sistemi të avancuar të menaxhimit të informatave në arsimin e lartë.

**Objektivi strategjik 5:**

Përdorimi i teknologjisë digjitale për përmirësimin e shërbimeve dhe të cilësisë në arsim, në përputhje me trendet e transformimit digjital

Me qëllim që Kosova të lëvizë sa më shpejt në drejtim të digjitalizimit të të dhënave, ofrimit të shërbimeve digjitale dhe automatizimit të proceseve në fushën e arsimit, si dhe me qëllim të rritjes së përdorimit të teknologjisë digjitale për nevoja arsimore e në funksion të përmirësimit të cilësisë në arsim, Kosova gjatë pesë viteve të ardhshme do të punojë në pesë drejtime: (i) krijimin dhe funksionalizimin e një platforme digjitale gjithëpërfshirëse e të centralizuar për fushën e arsimit; (ii) përgatitjen dhe prodhimin e materialeve mësimore digjitale shumëdimensionale e cilësore për nivele, klasë, lëndë e lloje të ndryshme; (iii) furnizimin e IEAA-ve dhe IAL-ve me rrjete të internetit cilësor dhe me pajisje teknologjike të nevojshme; (iv) kultivimin e kompetencës digjitale të të gjitha palët e përfshira në fushën e arsimit të të gjitha institucionet arsimore të të gjitha llojeve dhe niveleve; dhe (v) krijimin e mekanizmave institucionalë që mundësojnë realizimin e digjitalizimit dhe përdorimin e teknologjisë në fushën e arsimit.

Për secilin objektiv strategjik të SA, është përgatitur plani i veprimit, me aktivitetet dhe treguesit përkatës, si dhe koston përkatëse. Plani i veprimit, buxheti i SA dhe treguesit për secilën objektivë, janë paraqitur në pjesën e shtojcave të këtij dokumenti. Buxheti i SA, 2022-2026, ka koston prej 322,847,640 euro.

# 1. Hyrja

Cikli i ri i planifikimit në arsim, fillon në periudhën kur Republika e Kosovës është duke u përballur me pasojat e pandemisë COVID-19, e cila ndikoi dukshëm në ngadalësimin e ritmit të zhvillimit të vendit. Periudha e pandemisë rezultoi me çrregullime domethënëse të procesit arsimor në të gjitha nivelet, duke prodhuar humbje të konsiderueshme mësimore tek nxënësit dhe studentët.

Normalizimi i shumëpritur i gjendjes në institucionet edukative-arsimore dhe aftësuese, si dhe në institucionet e arsimit të lartë, do të bëjë të mundur përqendrimin në zgjidhjen e problemeve tanimë të identifikuara të sistemit të arsimit në shumë dokumente të politikave në arsim, në raporte e analiza të ndryshme dhe në legjislacionin përkatës.


Në Programin e Qeverisë së Kosovës 2021-2025, arsimi është identifikuar si mundësi dhe burim i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të Kosovës. Në këtë kontekst, janë përcaktuar 5 fusha si orientime kryesore për intervenim dhe zhvillim në sektorin e arsimit:

- 1 Arsimi cilësor gjithëpërfshirës dhe i digjitalizuar,
- 2 Harmonizimi i arsimit dhe aftësimit profesional me kërkesat e tregut të punës,
- 3 Menaxhimi efektiv i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet,
- 4 Arsimi i lartë me cilësi dhe integritet, në harmoni me standardet ndërkombëtare,
- 5 Përmirësimi i mjedisit për kërkime dhe inovacion.

Këto fusha, nga programi qeveritar si dhe gjetjet e rekomandimet nga dokumentet tjera (strategjitë, politikat, ligjet, hulumtimet) kanë shërbyer si pikënisje për punën e Ekipit Hartues dhe grupeve punuese të SA që nga faza fillestare e identifikimit të fushave e temave prioritare për nivele dhe sektorë të caktuar të arsimit në Kosovë e deri në fazën e përgatitjes së planit të veprimit.

Qasja strategjike që është ndjekur për rregullimin e mirë të procesit të planifikimit është konkretizuar në Kornizën për Planifikim dhe Menaxhim Strategjik (KPMS). KPMS, përcakton elementet kryesore të reformës në procesin e planifikimit. Përcaktimi i hierarkisë së objektivave dhe treguesve të performancës dhe definimi i kufijve të sektorëve sipas klasifikimit të funksioneve të qeverisë (COFOG), përveç monitorimit dhe raportimit më të mirë, e mundëson lidhjen më të qëndrueshme të politikave publike me planifikimin buxhetor.

Për këtë qëllim, SKZH 2030 ofron bazën për përgatitjen e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), ku mundësohet ndërlidhja e sektorëve dhe formulimi i veprimeve të shoqëruara me kodifikim, nëpërmjet zbatimit të planeve të institucioneve nga ana e të gjitha organizatave buxhetore. Ndër të tjera, në KPMS përcaktohet dallimi ndërmjet objektivave afatgjate, afatmesme dhe afatshkurta, të cilat zërthehen nga dokumente tjera strategjike, të renditura dhe të shpjeguara në figurën e mëposhtme të përshtatur nga dokumenti i SKZH 2030.



**Figura 1:** Zbërthimi i dokumenteve strategjike sipas KPM-së

Është me rëndësi të theksohet se SA 2022-2026, është përgatitur në përputhje të plotë dhe paralelisht me dokumentin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2030, më saktësisht me qëllimin zhvillimor: Arsim i qasshëm dhe cilësor. Në kuadër të këtij qëllimi zhvillimor të SKZH-së, janë katër objektiva specifike që lidhen me objektivat strategjike të SA. Konsolidimi i hierarkisë së qëllimeve dhe objektivave për të siguruar konsistencë me SKZH-në përcjellë formën e kaskadimit të duhur të objektivave nga dokumenti i SKZH 2030 në planin e veprimit të SA 2022-2026.

**Tabela 1:** Ndërlidhja e objektivave në SKZH 2030 dhe SA 2022-2026

OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË SKZH 2030	OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË SA 2022-2026 -
Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në edukim dhe kujdes cilësor në fëmijërinë e hershme	Edukimi në fëmijërinë e hershme: Rritje e përfshirjes dhe qasje e barabartë në edukimin në fëmijërinë e hershme.
Përmirësimi i qasjes gjithëpërfshirëse dhe digjitalizimit në arsim	Arsimi parauniversitar: Ngritja e cilësisë së arsimit parauniversitar përmes konsolidimit të mekanizmave për sigurim të cilësisë dhe ofrimit të mësimdhënies cilësore.  Digjitalizimi i arsimit: Përdorimi i teknologjisë digjitale për përmirësimin e shërbimeve dhe të cilësisë në arsim, në përputhje me trendet e transformimit digjital.
Harmonizimi më i mirë i arsimit me nevojat e tregut të punës	Arsimi, aftësimi profesional dhe arsimi për të rritur: Harmonizimi i arsimit dhe aftësimin profesional me zhvillimet dinamike të teknologjisë dhe tregut të punës, në funksion të mësimin gjatë gjithë jetës.
Cilësi, integritet dhe konkurrueshmëri më e lartë në arsimin e lartë	Arsimi i lartë: Përmirësimi i cilësisë, integritetit dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë.

Strategjia e Arsimit (SA) 2022-2026, është vazhdimësi e planeve strategjike të përgatitura për periudhën 2011-2016 dhe 2017-2021 dhe është në linjë me dokumente ndërkombëtare që paraqesin bazë për ndërtimin e politikave arsimore në vend. Strategjia e Arsimit, mbështetet në legjislacionin ekzistues dhe rekomandimet e raporteve hulumtuese për arsimin në Kosovë që janë realizuar në vitet e fundit. Lista e dokumenteve kryesore të politikave, legjislacionit dhe raporteve hulumtuese në të cilat bazohet SA, gjendet në shtojcën e këtij dokumenti.



## 2. Metodologjia

Strategjia e Arsimit 2022-2026, është hartuar në përputhje me konceptin mbi kornizën e menaxhimit strategjik, i cili parashikon lidhjen dhe kaskadimin e objektivave nga lart-poshtë. Në këtë drejtim, SKZH 2030, është strategjia kryesore e të gjitha strategjive sektoriale dhe përcakton objektivat kryesore strategjike të cilat janë përkthyer në objektiva specifike në SA 2022-2026. Kështu, baza strategjike për SA 2022-2026 është SKZH 2030 – qëllimi zhvillimor “Arsim i qasshëm dhe cilësor” në kuadër të shtyllës së “Zhvillimit të barabartë njerëzor”.

Kjo ndërlidhje është paraqitur në figurën e mëposhtme dhe ilustron kaskadën e objektivave nga lart-poshtë (SKZH 2030 – SA 2022-2026).

**Figura 2:** Kaskada e objektivave nga lart-poshtë (SKZH 2030 - SA 2022-2026)



Burimi: SKZH 2030.

Sipas Kornizës së re të Planifikimit dhe Menaxhimit Strategjik, SKZH 2030 rregullon ndër të tjera të ashtuquajturat “Agjenda Horizontale”, të cilat përfaqësojnë një dimension shtesë, horizontal të planifikimit sektorial, që kërkon koordinim ndërsektorial në të gjithë Qeverinë. Objektivat kryesore të përfshira në agjendat horizontale do të arrihen njëkohësisht në disa sektorë, duke përfshirë procesin

e reformës së administratës publike, duke zbatuar një sërë veprimesh konkrete, të planifikuara dhe të kushtuara në strategji specifike sektoriale dhe të përfshira në kërkesat buxhetore nga organizata përgjegjëse për zbatimin. Agjendat horizontale duhet të përdoren vetëm për qëllime koordinimi dhe monitorimi.

Bazuar në këtë, SKZH-ja ka identifikuar objektivat dhe treguesit të cilët përcaktojnë katër agjenda horizontale: agjenda digjitale, gjithëpërfshirja, agjenda e gjelbër dhe diaspora dhe migrimi. Këto agjenda janë përfshirë në kuadër objektivave strategjike dhe specifike të SA 2022-2026 përmes planifikimit të aktiviteteve konkrete për realizimin e tyre.

Në përcaktimin e metodologjisë për hartimin e Strategjisë së Arsimit, janë marrë parasysh udhëzimet dhe rekomandimet nga dokumentet vijuese:

- 1 Udhëzim administrativ (QRK) nr. 07/2018 për Planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit<sup>1</sup>,
- 2 Manuali për planifikimin, hartimin dhe monitorimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të tyre të veprimit (QRK)<sup>2</sup>,
- 3 Shtojcat e Manualit për planifikimin, hartimin dhe monitorimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të tyre të veprimit.

MASHTI ka mundësuar pjesëmarrje të gjerë të palëve me interes në procesin e hartimit të SA, duke i kushtuar kujdesin e duhur cilësisë së produktit, si dhe të vet procesit. Hartimi i SA është realizuar përmes një procesi gjithëpërfshirës, në të cilin kanë kontribuar shumë institucione, organizata dhe individë të ndryshëm.

Fillimisht, MASHTI ka themeluar Ekipin Hartues<sup>3</sup>, si ekip përgjegjës për të drejtuar procesin e planifikimit strategjik. Pastaj, janë krijuar grupet punuese dhe grupet tematike me përbërje nga zyrtarë të MASHTI, ekspertë të fushave, përfaqësues të ministrive të linjës dhe të organizatave partnere<sup>4</sup>. Në aktivitete të caktuara gjatë hartimit të Strategjisë së Arsimit, janë përfshirë edhe shumë persona të tjerë, të cilët kanë kontribuar në kuadër të katër grupeve tematike duke përfaqësuar entitete të ndryshme dhe palë interesi. Ndërsa, procesi i planifikimit, hartimit dhe finalizimit të Strategjisë së Arsimit, përfshirë përgatitjet për punëtori, moderimin e punëtorive, mbledhjen e të dhënave, hartimin e drafteve dhe finalizimin e tyre, është përkrahur nga ekspertët/konsulentët e jashtëm<sup>5</sup> të angazhuar nga GIZ dhe partnerët tjerë të MASHTI.

Katër grupet punuese ishin: Grupi i Punës për Arsimin Parauniversitar, Grupi i Punës për Arsimin, Aftësimin Profesional dhe Arsimin për të Rritur, Grupi i Punës për Arsimin e Lartë dhe Grupi i

<sup>1</sup><https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18813>

<sup>2</sup> <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2019/02/MANUAL-PËR-PLANIFIKIMIN-HARTIMIN-DHE-MONITORIMIN-E-DOKUMENTEVE-STRATEGJIKE-DHE-PLANEVE-TË-TYRE-TË-VEPRIMIT.pdf>

<sup>3</sup> Lista me emrat e anëtarëve të Ekipit Hartues të SA gjendet në Shtojcën 3 të këtij dokumenti.

<sup>4</sup> Lista me emrat e këtyre personave që kanë kontribuar gjatë procesit të hartimit të SA gjendet në Shtojcën 3 të këtij dokumenti.

<sup>5</sup> Lista me emrat e ekspertëve/konsulentëve të jashtëm të angazhuar për përkrahje profesionale gjatë planifikimit, hartimit dhe finalizimit të SA gjendet në Shtojcën 3 të këtij dokumenti.

Punës për Digjitalizimin e Arsimit. Në kuadër të Grupit të Punës për Arsimin Parauniversitar, kanë vepruar 3 nëngrupe për të mbuluar më mirë fushat tematike me interes. I tërë procesi i përgatitjes së Strategjisë së Arsimit është mbështetur nga asistenca teknike e GIZ-it.

## **Përgatitja e Strategjisë së Arsimit 2022-2026, është planifikuar dhe realizuar në pesë faza:**

### **Faza 1** Faza përgatitore

Gjatë kësaj faze është krijuar Ekipi Hartues, janë themeluar Grupet punuese dhe ato tematike, janë zhvilluar konsultime për metodologjinë e punës dhe formatin e strategjisë, janë përcaktuar fushat tematike të Strategjisë si dhe është përgatitur plani për hartimin e Strategjisë së Arsimit.

### **Faza 2** Analiza e gjendjes

Në këtë fazë, janë analizuar dokumentet e politikave dhe legjislacionit, raporteve të ndryshme dhe studimet për sektorin e arsimit si dhe burime tjera me informata për gjendjen aktuale në arsimin në Kosovë. Gjithashtu, janë shqyrtuar raporte me të dhëna statistikore nga burime kombëtare dhe ndërkombëtare. Pastaj, janë analizuar faktorët që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimet në arsim, siç janë faktorët makroekonomikë, demografikë dhe politikë. Kujdes i veçantë i është kushtuar analizës së politikave ekzistuese shtetërore për arsimin, të shpenzimeve për arsim, si dhe të performancës aktuale dhe kapaciteteve të sistemit. Gjatë punës me Ekimin Hartues, grupet punuese dhe ato tematike, janë përcaktuar fushat prioritare të Strategjisë së Arsimit, është shqyrtuar dhe plotësuar analiza e gjendjes dhe janë plotësuar të dhënat, informatat dhe statistikat tjera shtesë të ofruara nga grupet punuese dhe tematike. Si rezultat i punës në këtë fazë janë përgatitur dy versione të analizës së gjendjes: një version i analizës së zgjeruar me të dhëna të detajuara për pesë fushat prioritare të SA6 dhe tjetri i reduktuar dhe i përfshirë në këtë dokument.

### **Faza 3** Përcaktimi i vizionit, objektivave strategjikë, objektivave specifikë, aktiviteteve dhe treguesve

Gjatë kësaj faze puna në grupet punuese mbështetet në analizën e gjendjes, duke dhënë përgjigje në problemet tashmë të identifikuara. Fillimisht, me Ekimin Hartues është përcaktuar vizioni i Strategjisë së Arsimit. Pastaj, janë përcaktuar pesë objektiva strategjikë duke prioritetizuar veprimet kryesore për përmirësimin dhe avancimin e sistemit të arsimit. Gjatë punës me grupet punuese, për secilin objektiv strategjik, janë përcaktuar objektivat specifikë, aktivitetet dhe treguesit. Produkti i fazës së tretë ka qenë draft i pjesshëm i Strategjisë së Arsimit, i cili është shqyrtuar dhe aprovuar nga Ekimi Hartues.

6 Versioni i zgjeruar i analizës së gjendjes është përgatitur si shtojcë e ndarë e këtij dokumenti, dhe gjendet në MASHTI.

**Faza 4** Kostoja e SA dhe plani i zbatimit

Në këtë fazë, në bashkëpunim me zyrtarët e MASHTI, me pjesëmarrjen e grupeve punuese, është hartuar plani i veprimit të Strategjisë së Arsimit. Gjithashtu, janë vlerësuar të gjitha aktivitetet e planifikuara. Plan i veprimit dhe vlerësimi janë realizuar sipas formatit të përcaktuar dhe me përfshirje aktive të Ekipit Hartues dhe grupeve punuese. Në këtë fazë janë bërë disa ndryshime dhe plotësime përfundimtare të dokumentit dhe si rezultat është finalizuar Plan i veprimit dhe buxheti final i Strategjisë së Arsimit.

**Faza 5** Konsultimi publik dhe finalizimi i dokumentit të Strategjisë së Arsimit

Në këtë fazë është organizuar diskutimi paraprak dhe publik me qëllim të marrjes së komenteve dhe të hyrave nga palët e interesit. Me të përfunduar të procesit të konsultimit publik hartohet dhe publikohet versioni final i dokumentit të Strategjisë së Arsimit, i cili procedohet për aprovim në Qeveri.

Gjatë katër fazave të para të procesit të planifikimit të Strategjisë së Arsimit janë mbajtur gjithsej 40 punëtori si dhe me dhjetëra takime konsultative me grupet punuese.

### 3. Analiza e gjendjes

Në ekonominë bashkëkohore, arsimit është parakusht themelor për rritje ekonomike dhe përmirësim të standardit të jetesës. Përpjekja e Kosovës në arritjen e këtyre qëllimeve është e lidhur me shkallën e produktivitetit të fuqisë punëtore. Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit (MCC), vlerësoi normat e kthimit në arsim në Kosovë dhe erdhi në përfundim se ato janë në përputhje me hipotezën që cilësia e ulët e arsimit është pengesa që kushtëzon rritjen ekonomike. Kjo tregon që problemi i hendekut të shkathtësive lidhet me nivelet e pjesëmarrjes në arsim, me kompetenca dhe shkathtësi specifike siç janë gjuhët e huaja, shkathtësitë kompjuterike ose të ashtuquajturat shkathtësitë e buta dhe me cilësinë e përgjithshme të arsimit. Cilësia, shkalla e përfshirjes dhe numri i viteve të shkollimit, jo vetëm që kanë ndikim të pashmangshëm në përmirësimin e kapitalit njerëzor dhe krijimit të parakushteve për zhvillim social dhe ekonomik, mirëpo paraqet edhe bazën për të përmirësuar shanset e punësimit.

Në vitin 2018, Kosova ka marrë pjesë për herë të dytë në Programin Ndërkombëtar të Vlerësimit të Nxënësve (PISA). Testi PISA vlerëson aftësitë e nxënësve të moshës 15 vjeç për t'i zbatuar njohuritë e tyre që kanë përfutur në fushën e leximit, matematikës dhe shkencës, në situata të jetës së përditshme. Nxënësit 15 vjeç vazhdojnë të kenë arritshmëri të ulët në matematikë, shkencë dhe lexim, krahasuar me mesataren e rajonit dhe janë ndjeshëm nën mesataren e vendeve të OECD-së. Në vitin 2018, rezultatet e arritshmërisë së nxënësve në matematikë dhe lexim ishin minimalisht më mirë sesa në vitin 2015, ndërsa rezultatet në fushën e shkencave janë përkeqësuar. Arritshmëria mesatare në shkenca në Kosovë është 365 pikë, që është 124 pikë nën mesataren e OECD-së, ku 40 pikë janë të barasvlershme me një vit shkollimi. Arritshmëria mesatare në lexim në Kosovë është 353 pikë, që është 134 pikë nën mesataren e OECD-së, ndërsa arritshmëria mesatare në matematikë në Kosovë është 366 pikë, që është 123 pikë nën mesataren e OECD-së.<sup>7</sup>

Rezultati i testit PISA 2018, konfirmoi edhe një herë se gjendja e arsimit në Kosovë nuk është aspak e kënaqshme. Përveç rangut jo të mirë të Kosovës në raport me vendet tjera, brengë të madhe paraqet përqindja enorme e nxënësve që nuk e kanë arritur nivelin minimal të aftësive për t'i shfrytëzuar njohuritë në jetë – në Lexim: 78.7% (mesatarja e OECD: 22.7%, Shqipëria: 52.2%, Maqedonia e Veriut: 55.1%, Mali i Zi: 44.4%); në Matematikë: 76.6% (mesatarja e OECD: 23.9%, Shqipëria: 42.4%, Maqedonia e Veriut: 61%, Mali i Zi: 46.2%); në Shkenca të natyrës: 76.6% (mesatarja e OECD: 21.9%, Shqipëria: 46.9%, Maqedonia e Veriut: 49.4%, Mali i Zi: 48.2%).<sup>8</sup> Ky nivel konsiderohet niveli bazë i shkathtësive të nevojshme për pjesëmarrje të suksesshme në jetën ekonomike dhe sociale. Brengë e veçantë është arritshmëria e ulët në lexim, pasi aftësia e leximit, të kuptuarit dhe interpretimi i drejtë i asaj që lexon janë baza për arritje në fusha të tjera.

<sup>7</sup> <https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/5f07c754-en.pdf?expires=1620417488&id=id&accname=quest&checksum=-2362B92E5C68479B14087D185FABAAE3>

<sup>8</sup> Po aty.

### 3.1. Kuadri makro-ekonomik dhe fiskal

Gjatë periudhës 2008-2019, Kosova kishte një rritje të vazhdueshme të aktiviteteve ekonomike, me vlerë nominale të brutoproduktit vendor (BPV) me rreth 5.501 milion euro dhe me një normë reale të rritjes prej 6.0 për qind (2014), ndërsa në vitin 2019, vlera nominale e BPV-së ishte rreth 7.066 milion euro, me një normë reale të rritjes prej 4.9 për qind.<sup>9</sup>

Gjatë këtyre viteve rritja ekonomike ishte brenda parametrave që pasqyrojnë një situatë stabile makroekonomike si në sektorin fiskal ashtu edhe në atë financiar. Pavarësisht që Kosova në vazhdimësi kishte rritje të ekonomisë dhe rritje të të ardhurave për kokë banori, megjithatë, ajo mbetet larg BPV-së për kokë banori me vendet e Ballkanit,<sup>10</sup> siç tregon Figura 1.

Nga viti 2008, të hyrat buxhetore në Kosovë u rritën me normën vjetore prej 2-4 për qind, duke e ruajtur disiplinën fiskale dhe stabilitetin makroekonomik. Kështu, të hyrat e përgjithshme të Qeverisë së Kosovës në vitin 2017 ishin rreth 1.8 miliard euro, për vitin 2019 arritën vlerën 2.3 miliard euro, ndërsa për vitin 2020 ishin 2.6 miliard euro.<sup>11</sup>

Në përgjithësi remitencat kanë ndikim të shumëfishtë në aspektet kryesore të zhvillimit në Kosovë. Të hyrat nga remitencat janë në rritje si rezultat i trendit të rritjes së emigrimit të rregullt për qëllime të punësimit. Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës<sup>12</sup> vetëm gjatë vitit 2018 në Kosovë janë dërguar mbi 800 milion euro nga diaspora, që paraqet rritje prej 5.3 për qind në raport me vitin paraprak.<sup>13</sup>

Pavarësisht treguesve të tjerë ekonomikë, krijimi i bizneseve të vogla dhe të mesme konsiderohet faktor shtytës i dinamikës zhvillimore dhe ato vazhdojnë të jenë bartëse kryesore të krijimit të vendeve të reja të punës, megjithëse larg dinamikës së dëshiruar. Arsyeja kryesore për këtë qëndron në faktin se mbi 90 për qind të bizneseve të regjistruara janë mikrobiznese, me më pak se 10 të punësuar,<sup>14</sup> e që nuk pritet të jenë bartës të zhvillimit të një ekonomie moderne. Me gjithë përmirësimin e kushteve të të bërit biznes në Kosovë,<sup>15</sup> mungesa e shkathhtësive të kërkuara nga tregu i punës është identifikuar si pengesë e vazhdueshme për rritjen e sektorit privat.<sup>16</sup> Nëse shohim problemet në perspektivë gjinore/ kontekst gjinor, gratë në Kosovë, përfitojnë dukshëm më pak nga fondet publike. Në vitin 2017, gratë morën 17 për qind të granteve të Agjencisë Kosovare për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve (KIESA) për ndërmarrjet e tyre dhe burrat 83 për qind. Ndërmarrjet e zotëruara nga gratë, morën 25 herë më

9 Agjencia e Statistikave e Kosovës: Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2020. <https://ask.rks-gov.net/media/5492/vjetari-final-2020-per-web.pdf>

10 CIA: The World Fact book 2016 – Central Intelligence Agency. <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/kv.html>

11 Ministria Financave: Buxheti i Republikës së Kosovës 2020. <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/9D16BECD-DDF8-4144-BCBB-4CE9945F5CDD.pdf>

12 Banka Qendrore e Kosovës: Buletini mujor statistikor nr. 225, 2020. [https://bqk-kos.org/repository/docs/2018/BQK\\_BMS\\_225\\_al.pdf](https://bqk-kos.org/repository/docs/2018/BQK_BMS_225_al.pdf)

13 Autoriteti Qeveritar për Migrim: Profili i lehtë i migrimit 2017.

14 Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), MTI.

15 World Bank Group: Doing Business 2019 – Training for reform. [https://www.doingbusiness.org/content/dam/doingBusiness/media/Annual-Reports/English/DB2019-report\\_web-version.pdf](https://www.doingbusiness.org/content/dam/doingBusiness/media/Annual-Reports/English/DB2019-report_web-version.pdf)


16 B. Krasniqi, IESB Institute: Labour Market and Skills Needs Analysis; Perspective for the future. Kosovo: Publication of "Aligning Education and Training with Labour Market Needs 2" project. ISBN: 978-9951-8990-0-0. [http://alleged.eu/wp-content/uploads/2019/10/Report-Draft-215x215mm\\_print30092019.pdf](http://alleged.eu/wp-content/uploads/2019/10/Report-Draft-215x215mm_print30092019.pdf)

pak fonde si subvencione, ndonëse raporti i ndërmarrjeve në pronësi të grave ndaj atyre në pronësi të burrave është një me gjashtë, gjë që sugjeron se ndarja e fondeve është jo proporcionale.<sup>17</sup>

### 3.2. Tabloja demografike

Sipas rezultateve të regjistrimit të vitit 2011, numri i popullsisë rezidente në Kosovë ishte 1.739.825 banorë,<sup>18</sup> mirëpo në këtë regjistrim nuk janë përfshirë banorët e komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zvečan dhe Mitrovicë e Veriut. Popullsia në Kosovë për vitin 2019, vlerësohet që ishte 1.782.115 banorë, sipas këtij vlerësimi prej 0 – 14-vjeçar janë 28 për qind, 15 - 64 vjet janë 65 për qind dhe 65+ vjet janë 7 për qind.<sup>19</sup>

**Figura 3.** Projektioni i grup-moshave të popullsisë së Kosovës sipas viteve në përqindje (varianti i mesëm)<sup>20</sup>



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Varianti i mesëm

<sup>17</sup> <https://abgj.rks-gov.net/publikimet/107/programi-kosoves-per-barazi-gjinore>, faqe 23,

<sup>18</sup> Agjencia e Statistikave e Kosovës: Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë 2011, Rezultatet përfundimtare.

<sup>19</sup> Agjencia e Statistikave e Kosovës: Vlerësimi i popullsisë së Kosovës 2019, 2020. <https://ask.rks-gov.net/media/5536/vleresimi-i-popullsise-2019.pdf>

<sup>20</sup> Varianti i mesëm është një nga tri opsionet (varianti i lartë, varianti i mesëm dhe varianti i ulët) e trendëve demografike për periudhën e caktuar. Për shfrytëzimin e të dhënave rekomandohet që varianti i mesëm të shfrytëzohet gjatë planifikimit dhe analizave të ndryshme dhe konsiderohet më realiste nga Agjencia e Statistikave të Kosovës

Parashikimi i Popullsisë së Kosovës për periudhën 2017 – 2061, varianti i mesëm,<sup>21</sup> flet për një rritje të lehtë të popullsisë deri në vitin 2031, ndërsa që nga ky vit e më pastaj për të vazhduar me trendin e zvogëlimit të saj deri në vitin 2061. Sipas këtij parashikimi, popullsia në Kosovë do të jetë 1.809.458 banorë në vitin 2021; 1.818.674 (2031); 1.759.492 (2041); 1.652.090 (2051) dhe 1.492.192 (2061). Arsyeja e zvogëlimit qëndron te trendi i qartë i zvogëlimit të lindjeve dhe rritjes së emigrimit për shkak të kushteve ekonomike.

Popullsia e Kosovës do të pësojë një ndryshim drastik në strukturën e saj të moshës që manifestohet përmes zvogëlimit të popullsisë së re (nga 0-14 vjet) nga 24 për qind (2021), në 20 për qind (2031) dhe 13 për qind (2061). Njëkohësisht do të rritet pjesëmarrja e grup-moshës 65+ vjet në strukturën e popullsisë nga 9 për qind (2021) në 13 për qind (2031) dhe 27 për qind (2061), siç është paraqitur te Figura 1.

### 3.3. Të dhëna të përgjithshme për sistemin e arsimit

Sistemi arsimor në Kosovë është i organizuar në këto nivele kryesore:

- Edukimi Parashkollor (ISCED 0 - mosha < 6 vjeç).
- Arsimi Fillor (ISCED 1 - klasat 1-5).
- Arsimi i Mesëm i Ulët (ISCED 2 - klasat 6-9).
- Arsimi i Mesëm i Lartë (ISCED 3 - klasat 10-12).
- Arsimi i Lartë (ISCED 5-8, përfshirë ciklin e shkurtër të arsimit të lartë (5), nivelin Bachelor (6), nivelin Master (7) dhe nivelin Doktoratë (8).


Përveç niveleve të arsimit, kualifikimet lidhen edhe me programet dhe kurrikulën e tyre. **Korniza e vlerësimit të nxënësve në arsimin parauniversitar në Kosovë** i përshkruan veçoritë kryesore të sistemit arsimor dhe ka ndihmuar edhe në përsosjen e mëtejshme të hartëzimit në mes të niveleve të programeve të arsimit dhe Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve të Kosovës (shih Figurën 4 në vijim).

21 Agjencia e Statistikave e Kosovës: Parashikimi i popullsisë së Kosovës 2017 – 2061, dhjetor 2017. <https://ask.rks-gov.net/media/3742/parashikimi-i-popullsisë-se-kosoves-2017-2061.pdf>



Figura 4. Struktura e përgjithshme e sistemit arsimor në Kosovë

STRUKTURA E PËRGJITHSHME E SISTEMIT ARSIMOR NË KOSOVË



Ligjet themelore në fuqi në Kosovë që rregullojnë aspektet dhe nivelet kryesore të arsimit janë:

- Ligji mbi Edukimin Parashkollor (Nr. 02/L-52).
- Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-032).
- Ligji për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës (Nr. 03/L-068).
- Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (Nr. 04/L-138).
- Ligji për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-143).
- Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037).
- Ligji për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës (Nr. 06/L-046).
- Ligji për Barazi Gjinore (Nr. 05/L-020).
- Ligji për Kualifikime Kombëtare (Nr. 03/L-060).

Përveç këtyre ligjeve themelore, aspekte të ndryshme të fushës së arsimit rregullohen edhe me ligjet e përgjithshme që nuk janë të fushës së arsimit si dhe me ligje të veçanta të fushës së arsimit (profesionet e rregulluara, matura shtetërore, tekstet shkollore, inspektorati i arsimit, veprimtaria kërkimore-shkencore, etj.).

Institucionet kryesore përgjegjëse për organizimin dhe menaxhimin e të gjitha niveleve të arsimit në Kosovë në përputhje me legjislacionin dhe rregullativën në fuqi janë:

- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI).
- Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA).
- Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK).
- Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAPARR).
- Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK).
- Komunitet dhe Drejtoritë Komunitet të Arsimit (DKA).
- Institucionet Edukativo-Arsimore e Aftësuese (IEAA) – kopshtet/çerdhet, shkollat fillore, shkollat e mesme të ulëta, shkollat e mesme të larta të përgjithshme (gjimnazet), shkollat e mesme të larta profesionale, institucionet që ofrojnë arsim dhe aftësim për të rritur, etj.
- Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL).

Bazuar në Statistikat e Arsimit në Kosovë 2020/21<sup>22</sup>, rezultojnë që në arsimin parauniversitar në Kosovë janë të përfshirë rreth 320 mijë fëmijë/nxënës, prej të cilëve mbi 95% vijnë në edukimin/shkollimin në 1,052 Institucione Edukativo-Arsimore e Aftësuese (IEAA) publike, ku janë të punësuar mbi 28 mijë persona si personel i kategorive të ndryshme; ndërsa, 16,424 fëmijë/nxënës vijnë në edukimin/shkollimin në IEAA private të licencuara.

Në vitin akademik 2020/21, në institucionet e akredituara të arsimit të lartë në Kosovë, kanë vijuar studimet 95,335 studentë (57.4% në sektorin publik, 42.6% në sektorin privat), prej të cilëve 58.5% vajza/gra. Rreth 56.3% bruto e studentëve të grup-moshave 18-22 vjeç, ndjekin arsimin e lartë në Kosovë. Pjesëmarrja e femrës në arsimin e lartë është në nivel të kënaqshëm. Vajzat/gratë përbëjnë 59.5% të studentëve në sektorin publik dhe 57.1% të studentëve në sektorin privat. Indeksi i paritetit gjinor në arsimin e lartë në Kosovë është 1.41.

### 3.4. Sfidat dhe mundësitë e mjedisit

Analiza e situatës u zhvillua në nivelin e makro-mjedisit që përfshin faktorët e jashtëm me ndikim në sektorin e arsimit si dhe të mikro-mjedisit ku përfshihen faktorët e brendshëm. Metoda PEST u shfrytëzua për një analizë më të përgjithshme të makro-mjedisit duke identifikuar faktorët politikë, ekonomikë, socialë dhe teknologjikë. Ndërkaq, për një analizë të thelluar të mikro dhe makro-mjedisit, u zbatua një qasje e kombinuar e analizës së dokumentacionit (raporteve e studimeve të viteve të fundit në sektorin e arsimit) si dhe metoda SWOT për të identifikuar sukseset (përparësitë) dhe dobësitë (mangësitë) si faktorë të brendshëm, si dhe mundësitë dhe rreziqet si faktorë të jashtëm. Shqyrtimi i dokumenteve dhe analiza SWOT, u realizuan nga ekspertët dhe grupet punues/tematike të SA 2022-2026.

#### 3.4.1. Faktorët politikë

Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit (MSA), përcakton kornizën e bashkëpunimit të Kosovës me BE-në për ngritjen e cilësisë së arsimit në të gjitha nivelet, me qëllim të përmirësimit të shkathësive, punësueshmërisë, përfshirjes sociale dhe nxitjes së zhvillimit ekonomik. Pritet që bashkëpunimi në mes të BE-së dhe Kosovës të merr formën e asistencës teknike për jetësimin e masave të caktuara të SA. Prandaj, Strategjia për arsim do të jetë temë e konsultimeve të rregullta me BE-në dhe temë shqyrtimi i raporteve të progresit. Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Kosovës, para më shumë se një dekade, arsimit në Kosovë ka pësuar një decentralizim të madh, me ç' rast shumë kompetenca dhe përgjegjësi kanë kaluar nga niveli qendror në nivelin komunal, me synimin që disa prej tyre të barten tutje deri në nivel shkolle. Zbatimi i Strategjisë së Arsimit, në masë të madhe, varet nga kapaciteti zbatues i komunave, më saktësisht i drejtorive komunale të arsimit (DKA-ve). Niveli komunal, përkatësisht DKA-të në Kosovë nuk kanë qenë të përgatitura dhe nuk kanë pasur dhe ende nuk kanë, burime të mjaftueshme njerëzore dhe profesionale, por edhe financiare, për ta bartur gjithë barrën e kompetencave dhe përgjegjësi që decentralizimi ua ka deleguar DKA-ve. Përveç kësaj, decentralizimi i arsimit ka paraparë që shumë kompetenca dhe përgjegjësi të barten deri në nivel shkolle, por edhe në këtë rast mund të thuhet se shumica e shkollave kanë mungesë të burimeve njerëzore dhe profesionale brenda shkollave për të realizuar këto kompetenca dhe përgjegjësi. Kjo ndikon në jetësimin e masave të Strategjisë së Arsimit, pasi nuk është e mundur që të gjitha masat të zbatohen drejtpërdrejt nga MASHTI, pa një mbështetje solide nga niveli komunal. Për më tepër, është me rëndësi të madhe të nxitet të kuptuarit e gjerë të faktit se kjo autonomi e rritur e nivelit lokal duhet të shoqërohet me rritjen e përgjegjshmërisë dhe me menaxhim të cilësisë. Për këtë arsye, Strategjia e Arsimit përmban masa për ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve në komuna.

Shkollat me mësim në gjuhën serbe në Kosovë vazhdojnë të operojnë jashtë sistemit kosovar të arsimit, përkundër faktit se legjislacioni aktual ofron mundësi të mëdha për akomodimin e nevojave specifike të komunitetit serb. Republika e Kosovës do t'i vazhdojë përpjekjet aktuale për integrimin e komunitetit serb me ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë. Masat e Strategjisë së Arsimit u përshtaten të gjitha komuniteteve, por nëse, në një fazë të mëvonshme, paraqitet nevoja për adresimin e çështjeve specifike që kanë të bëjnë me integrimin e komunitetit serb, MASHTI do të bëjë përpjekje t'i akomodojë ato në planet vjetore të veprimit. Lëvizja e lirë brenda kufijve të Evropës është një mundësi për të rinjtë që kanë përfunduar shkollimin që të kërkojnë punë edhe jashtë kufijve të Kosovës. Meqë pritet që një lëvizje e tillë të mundësohet në të ardhmen e afërt, sistemi i arsimit duhet t'u përshtatet edhe kërkesave të tregut evropian të punës, duke u përqendruar në ngritjen e cilësisë, në mënyrë që të diplomuarit t'i përmbushin standardet e punëdhënësve nga vendet e BE-së.

### 3.4.2. Faktorët ekonomikë

Sipas Anketës së Fuqisë Punëtore, në tremujorin e parë të vitit 2021, dy të tretat e popullsisë së Kosovës është në moshë pune (15-64 vjeç), ndërsa nga popullsia në moshë pune, 60.5% është joaktive (djemtë/burrat – 43.5%, vajzat/gratë 77.3%). Shkalla e punësimit është 29.3% (djemtë/burrat - 42.8%, vajzat/gratë - 15.9%). Kosova ende përballet me nivele të larta të papunësisë – 25.8% (djemtë/burrat – 24.2%, vajzat/gratë – 29.7%). Papunësia tek të rinjtë është shumë e lartë në Kosovë. Në mesin e personave të moshës 15-24 vjeçar dhe në fuqinë punëtore, 48.6% janë të papunë (djemtë/burrat – 46.1%, vajzat/gratë 53.5%). Numri i të rinjve të moshës 15 – 24 vjeç që nuk ndjekin shkollim, nuk janë të punësuar dhe nuk ndjekin ndonjë trajnim (NEET) është 29.8% (djemtë/burrat - 29.9%, vajzat/gratë - 26.6%). Të dhënat tregojnë se niveli i ulët i arsimit zbeh shanset e punësimit. Shkalla e papunësisë është e ndërlidhur ngushtë me nivelin arsimor. Shkalla më e ulët e papunësisë është tek të arsimuarit me nivelin terciar (19.2%) dhe ata me arsim profesional (26.5%).<sup>23</sup>

Edhe pse në vitet e fundit, pjesëmarrja e vajzave në arsim është pothuajse e njëjtë me atë të djemve, shkalla e arsimit tek gratë e moshës së punës 15-64 vjeçare është dukshëm më e ulët sesa e djemve/burrave, duke ndikuar negativisht në gjasat e tyre për punësim. Të dhënat për Kosovën, por edhe ato të fundit për vendet e Bashkimit Evropian, tregojnë se shkalla e punësimit është më e lartë tek të diplomuarit në shkollat profesionale sesa të atyre të përgjithshme (gjimnazet). Shkollimi profesional do të mundësonte që vajzat qysh në moshën 18 vjeçare, të posedojnë shkathtësi në një profesion, duke iu mundësuar atyre tranzicion të hershëm nga shkolla në punësim, për të ndihmuar fuqizimin e tyre ekonomik.<sup>24</sup>

Kushtet e vështira ekonomike-sociale në të cilat jeton një numër i konsiderueshëm i qytetarëve të Kosovës, implikojnë disa shpenzime për adresimin e problemeve siç është furnizimi i të gjithë nxënësve me tekste shkollore falas për arsimin e obligueshëm që i kushton buxhetit të shtetit rreth 7 mil. EUR në vit; pastaj, subvencionimi i arsimit të lartë dhe banimit në konvikte përmes pagesave të ulëta që aplikohen. Nëse nuk ka përmirësim domethënës të gjendjes ekonomike, trendi i shpenzimeve të kësaj natyre, domosdo, do të vazhdojë, që do të thotë se do të ketë më pak mjete në dispozicion për zbatimin e Strategjisë së Arsimit.


### 3.4.3. Faktorët socialë

Kosova është duke kaluar në një fazë të ndryshimeve të konsiderueshme demografike. Efektet e zvogëlimit të popullsisë së moshës shkollore tashmë kanë filluar të vërehen në rënien e numrit të përgjithshëm të nxënësve në arsimin parauniversitar. Në vitin shkollor 2010/11, numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të lartë ka qenë 410.756, ndërsa në vitin shkollor 2019/20 ka rënë në 312.498, që paraqet zvogëlim prej 23.9 për qind brenda më pak se një dekade. Në bazë të projeksioneve të ASK 2022-2026, Kosova pritet të ketë rënie të theksuar të grup-moshave 0-4 (parashkollor) për shkak të rënies së lindjeve dhe shkallës së migrimit të grup-moshave riprodhuese. Një trend i ngjashëm parashihet edhe për grup-moshat 5-9 vjeç të edukimit parafillor dhe fillor.

23 Statistikat Sociale: Anкета e Fuqisë Punëtore TM1 2021, ASK <https://ask.rks-gov.net/media/6354/afp-tm1-2021.pdf>

24 PKBGJ 2020-2024 <https://abgj.rks-gov.net/publikimet/107/programi-kosoves-per-barazi-gjinore>

**Figura 5.** Projektionet e popullsisë sipas grup-moshave 2022-2026



Numri i nxënësve në arsimin e mesëm të ulët parashihet të rritet deri në vitin 2026, ndërsa, në arsimin e mesëm të lartë parashihet rënia më e madhe e numrit të nxënësve. Ndërkaq, numri i grup-moshave që korrespondojnë me arsimin e lartë parashihet të rritet. Këto zhvillime do të ndikojnë ndjeshëm në arsimin parauniversitar dhe në arsimin e lartë në Kosovë. Rënia e numrit të nxënësve do të ndikojë në uljen e numrit të paraleleve në shkolla, zvogëlim të nevojës për mësimdhënës dhe potencialisht, edhe në zvogëlimin e numrit të shkollave. Në anën tjetër, lëvizja e popullsisë nga fshati në qytet do të shkaktojë ngarkesë më të madhe në shkollat urbane dhe numër të vogël të nxënësve sidomos në zona të largëta rurale. Këto ndryshime demografike duhet të reflektohen në një racionalizim domethënës të rrjetit të shkollave dhe në rishikim të planifikimit gjatë periudhës së zbatimit të planit strategjik.

Virusi COVID-19, u përshkallëzua në pandemi globale në mars të vitit 2020 dhe si rezultat, qeveritë në mbarë botën ndërmoren masa të ndryshme për parandalimin e përhapjes së virusit dhe mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve. Në këtë kuptim, krahas masave të izolimit dhe distancimit shoqëror, qeveritë mbyllën shkollat dhe kaluan në mësimin në distancë, kryesisht duke shfrytëzuar teknologjinë informative (teknologjinë digjitale të kombinuar me teknologjinë më tradicionale si radio dhe TV) por edhe qasje të tjera të cilat mbështesin mësimin në distancë. Kjo mënyrë e organizimit të procesit mësimor kërkoi organizim të shpejtë, pa planifikime paraprake dhe si rrjedhojë, cilësia e organizimit të procesit mësimor dhe të nxënësve u ndikua nga faktorë të ndryshëm, varësisht nga vendi dhe zhvillimet e tyre të mëhershme.

Me mbylljen e shkollave dhe më pastaj organizimin e mësimin në kushte pandemie, mësimdhënësit në Kosovë janë përballur me sfidën e kalimit në mësimin në distancë, e cila kërkonte njohuri dhe shkathësi të mira të shfrytëzimit të teknologjisë informative për mësimdhënie cilësore dhe efektive. Në këtë drejtim, ndonëse mungojnë të dhëna të sakta, një numër i konsiderueshëm i mësimdhënësve vlerësohet se nuk kishin përvojë të mëhershme në organizimin e mësimin në distancë apo atij të kombinuar, ndërkaq, shfrytëzimi i teknologjisë gjatë procesit mësimor ishte tejet i ulët dhe përbënte sfidë për sistemin arsimor në Kosovë edhe para shfaqjes së virusit COVID-19. Po ashtu, duke marrë parasysh se mësimi në distancë varet nga qasja në pajisje të ndryshme teknologjike, internet dhe Wi-fi, mungesa e tyre ka rritur edhe me tej pabarazitë në arsim, duke zgjeruar hendekun e njohurive midis fëmijëve në avantazh dhe atyre nga grupet e cenushme, përfshirë këtu fëmijët me status të ulët socio-ekonomik, fëmijët me nevoja të veçanta arsimore si dhe fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, të cilët për shkaqe të ndryshme (mungesës së pajisjeve teknologjike dhe qasjes në internet, angazhimit dhe arsimimit të prindërve, mjedisit të përshtatshëm të të nxënësve etj.) nuk arritën të përfshihen në arsimin në distancë.

### 3.4.4. Faktorët teknologjikë

Bazuar në Rezultatet e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë Informative dhe Komunikimit 2020<sup>25</sup>, 96.4 % e ekonomive familjare në Kosovë, në vitin 2020 kanë pasur qasje në internet në shtëpi apo banesa nga çfarëdo pajisje. Kjo e bën Kosovën ndër vendet me penetrimin më të madh të internetit në botë. Të dhënat e këtij raporti tregojnë për përdoruesit e internetit sipas grup-moshave, të cilat prijnë me 19.5% janë moshë 35-44 vjeç, për t'u pasuar nga moshë 45-54 vjeç (18.9%), moshë 16-24 vjeç (17.4%), moshë 25-34 vjeç (16.1%), moshë 55-64 vjeç (15.5%) dhe moshë 65+ (10.1%). Ndërsa, sa

25 <https://ask.rks-gov.net/media/5804/anketa-e-p%C3%ABrdorimit-t%C3%AB-teknologjis%C3%AB-informative-komunikimit2020.pdf>

i përket përdorimit të internetit sipas gjinisë, prijnë djemtë/burrat me 57.4%, ndërsa vajzat/gratë me 40.2%. Gjithashtu, këto të dhëna tregojnë për përdorimin intensiv të internetit në Kosovë, ku nga 95.6% e individëve që e përdorin internetin, 92.9% e tyre e përdorin internetin çdo ditë ose pothuajse çdo ditë, madje shumica prej tyre (91.4%) e përdorin internetin disa herë gjatë ditës.

Ndërsa, bazuar në të dhënat e Raportit të Shtrirjes dhe Përdorimit të Internetit në Kosovë 2019<sup>26</sup>, përveç internetit në shtëpi, mbi 40% e qytetarëve të Kosovës, kanë të parapaguar edhe qasje në internet përmes shërbimeve telefonike (3G, 4G, LTE). Sipas këtij raporti, sa i përket vëllimit të përdorimit të internetit, por edhe cilësisë së internetit, duket se nuk ka dallime të mëdha në mes zonave urbane dhe atyre rurale, megjithëse gjendja është pak më e mirë në zonat urbane. Ajo që vlen të përmendet është fakti se të dhënat e këtij raporti tregojnë se përdorimi i internetit dhe i kompjuterit është në proporcion të drejtë me nivelin e shkollimit, sa më i shkolluar një individ aq më shumë është përdorues i internetit dhe i kompjuterit. Në ndërkohë, kompjuteri është pajisja digjitale që më së shumti përdoret për nevoja të punës, kur të punësuarit dhe studentët rezultojnë të jenë përdoruesit më të rregullt të kompjuterit.

Sa i përket posedimit të pajisjeve të ndryshme digjitale, bazuar në të gjeturat e Anketës së Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë në Republikën e Kosovës – MICS (Multiple Indicator Cluster Survey) dhe MICS për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës 2019-2020<sup>27</sup>, del se të gati të gjitha ekonomitë familjare në Kosovë kanë televizor (98.9%) dhe telefon mobil (99.2%), ndërsa vetëm 53.4% e tyre kanë kompjuter. Kur jemi te posedimi i kompjuterit duhet theksuar se studimi MICS tregon se ka dallime të mëdha ndërmjet komuniteteve dhe ndërmjet familjeve me status të ndryshëm ekonomik. Përderisa në nivel të Kosovës, 53.4% e ekonomive familjare kanë kompjuter, kjo përqindje te komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian është vetëm 23.8%. Po ashtu, te familjet më të varfra kjo përqindje është 13.9%, përderisa te familjet më të pasura është 88.9%.

Sa i përket qëllimeve të përdorimit të internetit, hulumtimi i STIKK-ut tregon se 93% e qytetarëve të Kosovës e përdorin internetin për nevoja të komunikimit, 37% për të dëgjuar muzikë, 35% për të lexuar informata e për kureshtje në Google search, Wikipedia, etj., 22% për të lexuar lajme, 19% për leximin/shkrimin e e-mail-ëve, 18% për gjetjen e materialeve për hulumtimet dhe studimet e tyre, ndërsa përqindje edhe më e vogël e përdorin internetin për qëllime të tjera. Shqetësues është fakti që interneti dhe këto pajisje digjitale në Kosovë përdoren jo mjaftueshëm për nevoja edukative, arsimore, shkencore e akademike, megjithëse kanë potencial të madh dhe përdorimi i tyre për këto qëllime do të mund të sillte efekte të shumta pozitive në fushën e arsimit dhe shkencës në Kosovë.

MASHTI, në vitin 2021, ka përgatitur Strategjinë për Digjitalizimin e Arsimit në Kosovë 2021-2026, me qëllim të vënies së teknologjisë në funksion të përmirësimit të mësimdhënies dhe të nxënies, si dhe zhvillimin e kompetencës digjitale tek brezat e rinj. Strategjia ka përcaktuar katër objektiva strategjike dhe për zbatimin e aktiviteteve të parapara është hartuar një plan veprimi i hollësishëm.

26 [https://stikk.org/wp-content/uploads/2019/11/STIKK\\_IK\\_Report\\_Internet\\_Penetration\\_V3-final-1.pdf](https://stikk.org/wp-content/uploads/2019/11/STIKK_IK_Report_Internet_Penetration_V3-final-1.pdf)

27 [https://ask.rks-gov.net/media/5765/republic-of-kosovo-national-and-roma-ashkali-and-egyptian-communities-2019-20-mics-sfr\\_albanian.pdf](https://ask.rks-gov.net/media/5765/republic-of-kosovo-national-and-roma-ashkali-and-egyptian-communities-2019-20-mics-sfr_albanian.pdf)

## 3.5. Analiza e gjendjes për fushat e Strategjisë

Në kuadër të kësaj pjese të dokumentit përfshihet një përshkrim dhe analizë e gjendjes ekzistuese sa i përket pesë fushave të Strategjisë së Arsimit 2022-2026 (SA), përkatësisht:

- Fusha 1. Edukimi në fëmijërinë e hershme.
- Fusha 2. Arsimi parauniversitar.
- Fusha 3. Arsimi, aftësimi profesional dhe arsimi për të rritur.
- Fusha 4. Arsimi i lartë.
- Fusha 5. Digjitalizimi i arsimit.

Analiza e zgjeruar e gjendjes për secilën fushë prioritare të Strategjisë së Arsimit 2022-2026, është përgatitur në një dokument të veçantë përcjellës të këtij dokumenti. Në kuadër të versionit të zgjeruar janë përfshirë edhe të dhënat për një numër të madh të projekteve, të cilat janë zbatuar apo janë duke u zbatuar nga institucione, organizata dhe donatorë të ndryshëm, të cilat drejtpërdrejt a tërthorazi janë të ndërlidhura me mbështetjen për nivelet dhe fushat e ndryshme të arsimit në Kosovë.

### 3.5.1. Edukimi në fëmijërinë e hershme

#### Edukimi në fëmijërinë e hershme

Përkundër që Edukimi në fëmijërinë e hershme forcon ekonominë e vendit, e duke ditur se kjo fazë vlerësohet të jetë baza që përcakton suksesin e nxënësve në shkollimin e mëtutjeshëm, ky nivel është përcjellë me shumë sfida në vitet e fundit. Kjo më së miri dëshmohet me vështirësitë me të cilat përballet EFH në Kosovë, përfshirë: shpërndarjen jo adekuate të institucioneve parashkollore në vend, numrin e vogël të institucioneve parashkollore publike (vetëm 49 në mbarë vendin), mungesën e infrastrukturës së mjaftueshme për përfshirjen e fëmijëve, mungesën e resurseve njerëzore për ofrimin e shërbimeve të integruara të mirëqenies, shëndetit dhe edukimit për zhvillimin e gjithanshëm të fëmijëve.

Përfshirja e fëmijëve në edukimin parashkollor, veçanërisht mosha 0-4 vjeç është tejet e ulët dhe si e tillë përbën sfidë në nivel vendi. Kjo sfidë përkethehet direkt edhe në nivel të ulët të pjesëmarrjes së grave në tregun e punës, për shkak që përgjegjësitë e kujdesit, në mungesë të institucioneve parashkollore, bien në mënyrë dërrmuese mbi gratë<sup>28</sup>. Në këtë drejtim, Kosova vazhdon të mbetet vendi në rajon me shkallën më të ulët të pjesëmarrjes së fëmijëve në edukimin parashkollor. Shkalla bruto e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor 0-4 është 6.7%, ndërsa në nivelin parafillor gjendja është dukshëm më e mirë ku shkalla bruto e regjistrimit të fëmijëve është 88.1%. Në përgjithësi në të gjitha format e edukimit parashkollor janë 19.5%<sup>29</sup> e fëmijëve të përfshirë. Për fëmijët 0-2 vjeç, përfshirja mbetet ende tejet e ulët, me një total prej 3.9% të përfshirë. Ndërsa, për fëmijët e moshës 3-4 vjeç përfshirja është 15%.<sup>30</sup>

Fëmijët nën 5 vjeç në zonat rurale janë të përfshirë në EFH tre herë më pak se bashkëmoshatarët e

28 Rrjeti i Grave të Kosovës, "Pandemia nuk njih gjini", 2020, fq. 78

29 Statistika e Arsimit në Kosovë 2020-2021

30 A Situation Analysis of ECD Services in Kosovo, World Bank, 2021



tyre në zonat urbane, për shkak se këto shërbime në zonat rurale pothuajse nuk ekzistojnë. Në zonat urbane janë të përfshirë 25.5% të fëmijëve në programe të EFH, ndërsa në ato rurale vetëm 7.9% janë të përfshirë në EFH.<sup>31</sup> Ndër arsyt kryesore për këtë përfshirje të ulët është shpërndarja jo e duhur e institucioneve të EFH në zonat rurale, element i cili është i ndërlidhur me faktorët social dhe ekonomik, sidomos punësimi i nënave, duke ditur se shërbimet e EFH ofrohen me pagesë.

IP private në përgjithësi, e sidomos ato të licencuara, vlerësohen si një mundësi shumë e madhe e ofrimit të shërbimeve për fëmijë për moshën 0-5. Nga të dhënat e SMIA, 6983 fëmijë të kësaj moshe përfitojnë shërbime në institucione private<sup>32</sup>. Duhet të theksohet se ekziston një hendek i madh i të dhënave pasi numri i fëmijëve që ndjekin institucionet parashkollore/parafillore private të pa licencuara mbetet i panjohur. Deri në qershor të vitit 2021 janë të licencuara gjithsej 177 IP private.

Programet parafillore në shkollat publike kanë një kohëzgjatje deri në 2.5 orë në ditë, që arrijnë në maksimum deri në 12.5 orë në javë, ndërsa në IP kohëzgjatja është deri në 8 orë apo deri në 40 orë në javë. Këto programe realizohen dhe mbështeten në Kurrikulën Bërthamë për Nivelin 1 dhe Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme. Shkollat fillore të cilat ofrojnë edukimin parafillor (klasa 0) për fëmijët 5 vjeç janë ofruesit më të mëdhenj të këtyre programeve. Në vitin shkollor 2020/21, 88.1% e fëmijëve janë të përfshirë në programet parafillore në të gjitha format e organizimit të EFH.

Edukimi parashkollor është i rregulluar me legjislacion përkatës që nga viti 2006. MASHTI, gjatë vitit 2021-2022 ka rishikuar këtë legjislacion dhe në muajin qershor 2022, projektligji për edukimin në fëmijërinë e hershme është miratuar në Qeveri. Gjithashtu, MASHTI është në fazën fillestare të zhvillimit të kurrikulës bërthamë për EFH me synim të miratimit të saj në vitin 2023.

Duke pasur parasysh se sektori i EFH është i ndërlidhur ngushtë me shërbimet e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, ende mbetet sfidë integrimi dhe koordinimi i këtyre sektorëve.

Për shkak të situatës pandemike të shkaktuar nga COVID-19, me mbylljen e të gjitha institucioneve edukativo-arsimore në Kosovë, u afektua edhe edukimin parashkollor dhe parafillor. Për EFH u organizua edukimi në distancë, përmes lansimit të platformës së parë online “Edukimi në distancë – kujdesi, zhvillimi dhe edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0-6 vjeç”. Përmes kësaj platforme, të gjithë fëmijëve të moshës 0-5 vjeç, me ndihmën e prindërve dhe edukatorëve u është mundësuar qasja në shërbimet e edukimit të hershëm e cila lehtësisht mund të realizohej edhe në ambiente të familjes për fëmijët e pa përfshirë në IP. Bazuar në të dhënat e UNICEF në Kosovë, janë mbi 2.5 milion klikime/vizitorë të kësaj platforme dhe janë krijuar mbi 223000 profile unike të përdoruesve. Për përdorimin e kësaj platforme janë trajnuar mbi 1600 edukatore. Platforma ofron mbi 1000 aktivitete ditore të përditësuara dhe të shpërndara për grup-mosha (0-2, 3-5), në gjuhën shqipe, serbe, turke dhe rome.

31 Po aty

32 Statistika e Arsimit në Kosovë 2020-2021

### 3.5.2. Arsimi parauniversitar


Analiza e gjendjes në fushën e Arsimit Parauniversitar (APU) është e bazuar në raportet e vlerësimit të PSAK 2017-2021, në raportet hulumtuese në dispozicion që mbulonin tematikat e APU si dhe në analizën e realizuar në kuadër të dy grupeve punuese për APU. Analiza është përqendruar në katër fusha tematike:

- Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja në arsimin parauniversitar.
- Menaxhimi, sigurimi i cilësisë dhe llogaridhënia.
- Mësimdhënësit.
- Zbatimi i kurrikulës së bazuar në kompetenca.

#### Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja në arsimin parauniversitar

Në përgjithësi, shkalla e përfshirjes bruto të fëmijëve/nxënësve, në krahasim me vitet paraprake ka shënuar rënie në gati të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Sipas raportit statistikor 2020/21, në krahasim me vitin paraprak, shkalla e përfshirjes së fëmijëve në arsimin parafillor është 88.1% me një rënie prej 5% nga viti paraprak, në arsimin e mesëm 91.2%, me një rënie prej 0.1% dhe në arsimin e mesëm të lartë është 81.1% me një rënie prej 4.3%. Vetëm në arsimin fillor, shkalla e përfshirjes është 101.2% me një rritje prej 0.6% nga viti paraprak.<sup>33</sup> Në dy dekadat e fundit është punuar mjaft, kryesisht duke ndërtuar objekte shkollore dhe duke bërë rinovimin e objekteve ekzistuese. Mirëpo, ka dallime të mëdha në numrin e nxënësve në zonat rurale dhe urbane. Aktualisht, rreth 60% të shkollave kanë nën 250 nxënës dhe mbi 200 shkolla (paralele të ndara) funksionojnë me nën 50 nxënës apo rreth 4 nxënës për klasë.<sup>34</sup> Gjithashtu, Kosova është duke kaluar në një fazë të ndryshimeve të konsiderueshme demografike. Në bazë të projeksioneve të popullsisë, ka dhe do të ketë në vazhdimësi rënie të numrit të nxënësve në nivelin fillor dhe të mesëm siç shihet në Figurën 6 më poshtë.

**Figura 6:** Projeksionet e popullsisë për moshat 0-4, 5-9 dhe 10-14 vjeç (2022-2031)- variant i mesëm



33 MASHTI (2021) <https://masht.rks-gov.net/uploads/2021/12/raport-vjetor-statistikor-me-tregues-arsimore-2020-21.pdf>

34 Kushtrim Bajrami: Vlerësimi i realizimit të planit strategjik të arsimit në Kosovë 2017-2021 – Arritje e pamjaftueshme (2021). <http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2021/06/Vleresimi-i-Realizimit-te-PSAK-2017-2021.pdf>

Këto ndryshime demografike rezultojnë me nevojën për një racionalizim domethënës të rrjetit të shkollave dhe imponojnë nevojën për rishikim të planifikimit gjatë periudhës së zbatimit të planit të ri strategjik.

Komunitetet si boshnjak, turk, rom, ashkali dhe egjiptian janë të integruar në sistemin e arsimit të Kosovës, pra edhe mësimi në Kosovë zhvillohet në katër gjuhë (gjuhë shqipe, serbe, boshnjake dhe turke). Të dhënat për numrin e nxënësve të etnisë serbe mbeten të pa raportuara me rregull nga komunat me shumicë serbe në Kosovë. Fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian vazhdojnë të përballen me sfida të ndryshme sa i përket qasjes së tyre në arsim. Përkundër që është shënuar progres në rritjen e përfshirjes së tyre në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, krahasuar me mesataren e vendit, kjo pjesëmarrje mbetet ende në nivele të ulëta. Më së shumti vërehet ky dallim në edukimin parashkollor, ku 7.6% e fëmijëve të këtyre komuniteteve marrin shërbime në krahasim me popullatën e përgjithshme, e që janë 15%, si edhe në nivelin e mesëm të lartë, ku vetëm 31% të nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian janë të përfshirë, në krahasim me 86.8% të popullatës së përgjithshme.<sup>35</sup>

Në komuna të ndryshme në Kosovë ku jetojnë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë themeluar Qendra Mësimore me qëllim të përfshirjes së fëmijëve të këtyre komuniteteve në sistemin arsimor. Nismat për themelimin e Qendrave Mësimore nga organizatat joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare kanë parasysh shkallën e ulët të vijimit dhe përfundimit të shkollimit nga fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian, nivelin e pakënaqshëm të performancës së tyre në shkollë dhe mungesën e përfshirjes sociale. Në vitin 2018 është miratuar UA 17/2018 për themelimin dhe funksionimin e qendrave mësimore, që ndihmon fëmijët në rritjen e performancës së të nxënësve dhe parandalimit të braktisjes.<sup>36</sup> Falë qendrave mësimore, shkalla e regjistrimit në arsimin e detyrueshëm u rrit ndërsa braktisja u zvogëluar në masë të madhe, edhe pse financimi i tyre nuk është i qëndrueshëm.<sup>37</sup> MASHTI, komunat dhe partnerët e zhvillimit kanë marrë masa në përmirësimin e përfshirjes së komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian në sistemin arsimor ku për vazhdimin e shkollimit të arsimit të mesëm të lartë, gjatë periudhës 2017 – 2021 janë ndarë 507 bursa për nxënësit e regjistruar në arsimin e mesëm të lartë.

Përfshirja e nxënësve me aftësi të kufizuara mbetet sfidë e madhe në nivel vendi, që konsiderohen të jenë shumë pak të përfaqësuar brenda sistemit arsimor, me përfshirje prej afërsisht 2.1% e nxënësve në shkollë, ndërkaq vlerësohen të jenë rreth 15% të popullsisë. Vlerësohet se 38,000 fëmijë me aftësi të kufizuara në Kosovë nuk vijojnë shkollën.<sup>38</sup> Të dhënat e fundit për vitin shkollor 2019/20, tregojnë se gjithsej 3,903 fëmijë me aftësi të kufizuara, janë të përfshirë në klasat e rregullta dhe 349 në qendrat burimore. Krahasuar me të dhënat me vitet paraprake, vërehet se ka rritje të numrit të nxënësve në shkolla gjithëpërfshirëse dhe zvogëlim të numrit në Qendrat Burimore.<sup>39</sup>

35 MICS (KAS dhe UNICEF, 2020)


36 Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2021-2025.

37 Po aty.

38 EU Kosovo Report.

39 GIZ-MASHTI -Raporti i vlerësimit të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021 për vitin 2019

Figura 7: Pjesëmarrja e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore



Burimi: Vlerësimi i PSAK 2017-2021

Mungesa e të dhënave është pengesa kryesore në adresimin e nevojave të kësaj kategorie të fëmijëve, si dhe mungesa e përcaktimit të aftësisë së kufizuar që ata kanë. Mbledhja e të dhënave bëhet edhe më e vështirë sepse nuk ka harmonizim të mekanizmave dhe sistemeve mes ministrive. Informatat që mblidhen në nivel shkolle dhe që mund të përdoret në të ardhmen për qëllime financimi, mund të mos jenë të besueshme pasi që i mungon dokumentacioni përkatës mbështetës.<sup>40</sup> Edhe pse me akte ligjore është përcaktuar që çdo komunë të ketë Ekipet komunale për vlerësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, shpesh, këta fëmijë identifikohen vetëm kur arrijnë moshën shkollore dhe përpiqen të regjistrohen në shkollë, e që ndërhyrja është tashmë shumë vonë për të pasur një ndikim të qëndrueshëm në zhvillimin e tyre. Për më tepër, shumë shpesh praktikat ekzistuese nuk çojnë në plane të individualizuara që i përgjigjen dëmtimit të çdo fëmije dhe pengesave mjedisore.

Një sfidë tjetër me të cilën përballen fëmijët, prindërit por edhe shkollat, është numri i ulët i mësimitdhënësve mbështetës dhe asistentëve të cilët punojnë me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore. Gjithashtu, është hartuar pako dhe është realizuar harmonizimi i dokumentacionit pedagogjik për të gjitha qendrat burimore si dhe janë hartuar parametrat e financimit për nxënësit me aftësi të kufizuara. Prandaj, për fëmijët me aftësi të kufizuara, sfidat mbeten në formë të qasjes së kufizuar në arsimin e përshtatshëm, në shërbime shëndetësore dhe riaftësuese dhe qasja pa barrierë në objekte dhe shërbime publike.<sup>41</sup>

40 Hunt P.F.; Belegu-Caka V.: Situation analysis: children with disabilities in Kosovo, Prishtina: Unicef, 2018. <https://www.unicef.org/kosovoprogramme/media/216/file/KOS-SITAN-ENG.pdf>

41 <https://www.unicef.org/kosovoprogramme/media/1141/file/SITAN.pdf>.

Sipas të dhënave zyrtare braktisja e shkollimit është e një shkalle të ulët dhe si fenomen konsiderohet më i pranishëm tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Sipas të dhënave zyrtare, braktisja e shkollimit ka një rënie të lehtë dhe si fenomen konsiderohet më i pranishëm tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Sipas SMIA-s për vitin shkollor 2020-21, janë gjithsej 67 nxënës braktisës nga këto komunitete (28 vajza dhe 39 djem). Megjithëkëtë, të dhënat lidhur me braktisjen e shkollimit mbesin mjaft të mangëta, meqenëse raportimi i rasteve të braktisjeve të shkollimit nga shkollat mbetet i mangët. Në përgjithësi vlerësohet se një nga sfidat kryesore të parandalimit të braktisjes së shkollës është mungesa e raportimit të bërë nga shkollat SPH (Sistem të Paralajmërimit të Hershëm). Për të zvogëluar dhe kontrolluar braktisjen është hartuar plani dyvjeçar i punës së Ekipit kombëtar kundër braktisjes së shkollimit si dhe i kornizës monitoruese dhe janë mbështetur mbi 80 shkolla në zbatim të detyrimeve ligjore në 10 komuna (Pejë, Prishtina, Prizren, Fushë Kosovë, Obiliq, Podujevë, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë dhe Vushtrri).<sup>42</sup>

Me qëllim të identifikimit dhe ofrimit të mbështetjes së fëmijëve me potencial të jashtëzakonshëm intelektual dhe me talente të veçanta, është miratuar UA 14/2019 për fëmijët/nxënësit me aftësi të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente si dhe udhëzuesi për zbatimin e tij.<sup>43</sup> Megjithatë, sfida vazhdon të mbetet zbatimi i këtij UA për shkak të mungesës së kapaciteteve për identifikim dhe vlerësim të nxënësve si dhe mungesës së institucioneve të specializuara publike për të mbështetur këtë fushë. Duke u bazuar në të dhënat nga Instituti ATOMI, gjatë viteve 2017-2020, në bazë të kritereve dhe rezultateve të testimit, janë identifikuar dhe mbështetur 116 nxënës me inteligjencë të jashtëzakonshme, me dhunti e talente.

Gjatë viteve të fundit, migrimi dhe kthimi i mëvonshëm i një numri të madh të qytetarëve të Kosovës ka shkaktuar sfida në integrimin e fëmijëve të kthyer në sistemin e arsimit. 240 nxënës të riatdhesuar janë përfshirë në mësimin plotësues në 16 komuna. Për të rregulluar integrimin e fëmijëve të kthyer, MASHTI ka hartuar edhe UA nr. 86/200.<sup>44</sup> Po ashtu, në bashkëpunim me MPB dhe GIZ janë siguruar tekste mësimore të posaçme për nxënësit e riatdhesuar.

Lidhur me mësimin plotësues në diasporë të dhënat tregojnë se ka përfunduar unifikimi i Kurrikulës së mësimin të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe janë përgatitur standardet për mësuesit e Diasporës të cilat do të shërbejnë si model referimi për regjistrin e mësuesve të Diasporës. MASHTI ka përgatitur 3 tekste shkollore dhe 19 fletore pune për mësimin e gjuhës shqipe.

### **Menaxhimi, sigurimi i cilësisë dhe llogaridhënia**

Menaxhimi i arsimit parauniversitar ndahet midis nivelit qendror (MASHTI-t), niveli lokal (komunës – DKA-s) dhe IEAA. Procesi i decentralizimit të përgjegjësive në arsim, si dhe reforma kurrikulare kanë shtuar mundësitë e rritjes së përgjegjësive dhe shkallën e llogaridhënies në të gjitha nivelet e arsimit. Megjithatë, këto mundësi nuk janë shfrytëzuar sa dhe si duhet për shkak të kapaciteteve njerëzore dhe ndryshimeve të shpeshta si në organikën e APU në MASHTI dhe strukturën e funksionimit të komunave - DKA.

Përkundër rregullimit ligjor, procesi i rekrutimit të drejtorëve të IEAA ende përcillet me sfida të shumta, si për shkak të ndikimeve të qeverisjes komunale, nga ndikimi politik, ashtu edhe për shkak

42 GIZ-MASHTI -Raporti i vlerësimit të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021 për vitin 2019

43 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/09/udhzimi-administrativ-me-nr-14-2019-per-fnxajdht-rotated.pdf>

44 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/10/udhzimi-administrativ-me-nr-86-2020-per-sistemimin-e-nxensve-ne-shkolla-te-cilete-jane-kthyer-pas-migrimi-dhe-u-mungojn-dokumentacioni-perkates-arsimor-rotated.pdf>

të mos zhvillimit të politikave arsimore për drejtorë të karrierës. Kjo ka bërë që udhëheqja e IEAA të jetë e përqendruar në kryerjen e detyrave administrative dhe më pak në udhëheqjen e proceseve të mësimin që zhvillohen në shkollë. Në anën tjetër, fillimi i politikës së re arsimore për vlerësimin e performancës së drejtuesve të shkollës, nuk është përcjellë sa duhet me zhvillim të kapaciteteve për vlerësim të standardizuara.

Si pjesë e menaxhmentit të mesëm të shkollave, në shumicën e shkollave, ekzistojnë aktivitetet profesionale, të organizuara sipas fushave lëndore ose klasave, megjithatë, në shumë raste, funksionimi i tyre është relativisht joformal dhe pa ndonjë ndikim të madh në cilësinë e mësimdhënies në shkollë. Kjo sidomos ndikohet nga fakti që orët e angazhimit për udhëheqje të këtij mekanizmi nuk përfshihen në normën për mësimdhënësit dhe nuk parashihet asnjë kompensim për udhëheqësit e aktiveve.

Përkundër faktit se shpenzimet janë rritur vazhdimisht gjatë viteve të fundit, Kosova vazhdon të mbetet në listën e vendeve me shpenzime të ulëta për kokë nxënësi. Dy kategoritë ku përqendrohen shpenzimet janë kryesisht në paga dhe mëditje dhe shpenzime kapitale dhe si rezultat mungojnë investimet për projekte të lidhura me cilësinë në arsim dhe zbatimin e reformës kurrikulare.

Edhe pse korniza legjislativë siguron autonomi të shkollës në lidhje me menaxhimin e financave, shkollat ende nuk kanë kod buxhetor dhe as nuk janë në gjendje të menaxhojnë buxhetin. Komunitatet përmes DKA-ve menaxhojnë kodet buxhetore duke i detyruar shkollat të realizojnë kërkesat buxhetore në komunë edhe për riparime të vogla. Në një situatë të tillë, DKA-të shpesh shërbejnë si qendra të prokurimit për rrjetin e shkollave nën mbikëqyrjen e tyre, duke e devijuar kështu vëmendjen nga çështjet strategjike të sektorit të arsimit në nivel lokal, siç është planifikimi i politikave dhe monitorimi.

Korniza ligjore për sigurimin e cilësisë në institucionet arsimore në masë të madhe është e kompletuar. Mirëpo, mos kompletimi i kuadrit të inspektorëve pedagogjik, siç parashihet me Ligjin për Inspektoratin e Arsimit, mosemërimi i koordinatorit të cilësisë në MASHTI, emërimi formal i koordinatorëve të cilësisë në DKA dhe në IEAA, pa i kuptuar plotësisht rolet dhe përgjegjësitë e koordinatorit, ka bërë që sistemi për sigurimin e cilësisë në APU të mos jetë funksional. Kjo ka ndikuar që vlerësimi i performancës së IEAA (i brendshëm dhe i jashtëm) dhe planifikimi zhvillimor të kenë ngecje, të jenë procese që karakterizohen me formalizëm dhe pa ndërlidhje të qartë midis tyre dhe pa ndikim në performancën e IEAA, përkatësisht në arritjet e nxënësve.

Bazuar në kuadrin e politikave arsimore, çdo vit organizohen dhe administrohen dy vlerësime kombëtare, Testi i Arritshmërisë dhe Provimi i Maturës Shtetërore. Besueshmëria e palëve në rezultatet e këtyre testeve kombëtare, ka shënuar një progres të ndjeshëm. Përveç masave për një administrim më të mirë të vlerësimeve kombëtare, janë bërë ndryshime edhe në strukturë dhe përmbajtje të testeve. Po ashtu është realizuar trajnimi i stafit të DSCSVL (Divizionit për sigurimin e cilësisë, standarde, vlerësim dhe licencim) dhe bashkëpunëtorëve të tyre, në parimet e analizës dhe raportimit statistikor me theks të veçantë në kalibrimin e pyetjeve. Mirëpo, sfida kryesore është administrimi i testeve dhe parandalimi i kopjimit që ndodh në shkollë, gjatë procesit dhe administrimit të testimit. Mungesa e një Qendre për Vlerësim dhe Standarde, ka rezultuar me kapacitete të pamjaftueshme dhe sfida në mbarëvajtjen e proceseve të mirëfillta të vlerësimeve kombëtare dhe analizës së rezultateve nga vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Sigurimi dhe menaxhimi i të dhënave për APU ka progres të ndjeshëm. Korniza e treguesve tani bëhet sipas kërkesave të UNESCO, EUROSTAT dhe OECD dhe është hartuar udhëzuesi për llogaritjen e treguesve të shpenzimeve publike për arsimin parauniversitar në Kosovë. SMIA mbulon aktivitete të rëndësishme në shkolla, por ka sfida në mbledhjen e të dhënave të besueshme për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, fëmijët jashtë shkollës dhe ata që kanë braktisur sistemin arsimor si dhe të dhëna të kufizuara për veprimtarinë e mësimdhënësve, veçanërisht në lidhje me zhvillimin profesional.

### Mësimdhënësit

Përgatitja e mësimdhënësve para shërbimit, pavarësisht përpjekjeve, vazhdon të sfidohet në masë të madhe nga kualitetet e hyrjes/regjistrimit në profesionin e mësimdhënësit, kapacitetet e fakulteteve që përgatisin mësimdhënësit në përafrimin e programeve dhe praktikave institucionale që çojnë në zhvillimin e profesionalizmit të kërkuar të mësimdhënësve dhe qasjet aktuale për sigurimin e cilësisë së përgatitjes e mësimdhënësve. Stereotipat gjinorë profesionalë dhe pagat më të ulëta duket se frenojnë gatishmërinë e burrave që të studiojnë në universitet për mësimdhënësit të ciklit të arsimin parauniversitar. Perceptimet kulturore të roleve zakonisht mashkullore dhe femërore (p.sh. burrat si profesorë, gratë si ofruese të kujdesit) përforcohen nga brezi në brez, duke u konfirmuar nga mungesa e shëmbëlltyrave mashkullore në arsimin e hershëm dhe mësimdhënëset femra në shkollat e mesme<sup>45</sup>. Përgatitja e mësimdhënësve të ardhshëm në Fakultetin e Edukimit, pritet të marrë dimension të ri me zhvillimin e dokumentit *Politika për përmirësimin dhe sigurimin e cilësisë në përgatitjen e mësimdhënësve në Kosovë*.<sup>46</sup>

Përkundër rregullimit ligjor, niveli aktual i zbatimit të sistemit të licencimit nuk mundëson avancim profesional, nuk siguron lidhjen e licencimit me sistemin e pagave të mësimdhënësve dhe nuk siguron gradim të mësimdhënësve në sistemin e karrierës. Komponenti i ZHPM vazhdon të sfidohet në koordinim dhe në marrjen e rolit udhëheqës në të tri nivelet e menaxhimit të APU si dhe në mbikëqyrjen dhe vlerësimin e zbatimit të programeve për ZHPM, etj. Në anën tjetër, vlerësimi i performancës së mësimdhënësve (VPM), si komponentë e sistemit të licencimit të mësimdhënësve, nuk ka arritur të zbatohet në dinamikën e paraparë dhe ta kryej funksionin e paraparë, përfshirë funksionin e gradimit të mësimdhënësve si dhe kategorizimin e avancimin e mësimdhënësve. Sipas raporteve, deri në marsin e vitit 2020, janë vlerësuar vetëm 755 mësimdhënësit.

Bazuar në të dhënat e raportuara për përfshirjen e mësimdhënësve në trajnime, shkalla e përfshirjes së mësimdhënësve në ZHP ka rënë në mënyrë të vazhdueshme viteve të fundit, për shkak të mungesës së financimit, por edhe për shkak të moszbatimit të sistemit të licencimit të mësimdhënësve. Shkalla e përfshirjes së mësimdhënësve në zhvillim profesional në vitin 2019 ishte 24.70 % e numrit të përgjithshëm të mësimdhënësve. Kjo shkallë është dukshëm më e ulët sesa në vitin 2015 (54%). MASHTI ka investuar në softuerin për sistemin e licencimit të mësimdhënësve, mirëpo sistemi nuk mirëmbahet rregullisht dhe popullimi i bazës së të dhënave nuk azhurnohet në raport me ZHPM.

45 Rrjeti i Grave të Kosovës,

46 Fakulteti i Edukimit (2021) <https://edukimi.uni-pr.edu/desk/inc/media/84FF287A-D6AB-4ACC-85CF-11F278D41156.pdf>

### Zbatimi i kurrikulës së bazuar në kompetenca

Reforma kurrikulare në APU në Kosovë është e bazuar në kompetenca, në linjë të përafërt me rekomandimet e Parlamentit dhe të Këshillit të Evropës për kompetencat themelore për të nxënit gjatë gjithë jetës. Cikli i zhvillimit të kurrikulave lëndore është përmbyllur në gusht të vitit 2021, me fillimin e zbatimit të kurrikulës në klasën e 5-të. Vlen të theksohet se në kuadër të zhvillimit të kurrikulave, ka përfunduar edhe unifikimi i Kurrikulës së mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë, si dhe janë përgatitur standardet për mësuesit e Diasporës.

Procesi i zbatimit të kurrikulës është shoqëruar me trajnimin e mësimeve për zbatimin e kurrikulës, proces të cilin e ka udhëhequr MASHTI në bashkëpunim me DKA. Sipas raporteve të Divizionit për ZHPM në MASHTI, numri i mësimeve të përfshirë në trajnimet për zbatimin e kurrikulës së re në periudhën 2016-2020 është mbi 24,000. Forma tjera të mbështetjes së mësimeve për zbatimin e kurrikulës kanë filluar në disa komuna duke themeluar ekipe profesionale mbështetëse për mësimeve, të cilat nuk kanë qëndrueshmëri për shkak të mosrregullimit ligjor.

Referuar raporteve që lidhen me zbatimin e kurrikulës, disa nga sfidat kryesore në zbatimin e reformës kurrikulare, të identifikuar, janë: qasja e fragmentuar dhe jo koherente e zbatimit të elementeve të reformës kurrikulare, moskonsolidimi i mekanizmave të mbikëqyrjes, përkrahjes dhe llogaridhënies në procesin e zbatimit të kurrikulës, orientimi dhe përkrahja e pamjaftueshme e mësimeve dhe shkollave në planifikimin dhe realizimin e proceseve mësimore bazuar në parimet e Kornizës Kurrikulare dhe për vlerësimin e nxënësve bazuar në kompetenca, shfrytëzimi i pamjaftueshëm i autonomisë së shkollave për zbatimin e kurrikulës, në përputhje me kushtet specifike dhe nevojat e nxënësve, etj.

Procesi i zbatimit të kurrikulës është shoqëruar edhe me angazhimet institucionale për sigurimin e teksteve të reja shkollore. Janë hartuar dhe miratuar tekste të reja shkollore, por jo me dinamikën e shtrirjes së zbatimit të kurrikulës në shkallë vendi. Cilësia e teksteve shkollore mbetet sfidë më vete. Edhe pse me vonesë janë zhvilluar tekste të reja, ato përshkruhen të jenë me probleme e të meta të shumta të natyrave të ndryshme, si në qasje, në qëllime, në formë e në përmbajtje. KEPTSH, si një mekanizëm i brendshëm i MASHTI-t, me gjithë përpjekjet, nuk ka arritur ta mbikëqyrë dhe mbështesë procesin e hartimit/rishkrimit të teksteve sipas së shtrirjes së zbatimit të kurrikulës. Në anën tjetër, mungesa e zyrarëve për tekste shkollore në MASHTI, ka rezultuar me mungesë koordinimi dhe vonesa në përgatitjen e teksteve shkollore sipas dinamikës së përcaktuar me udhërrëfyesin për zbatimin e kurrikulës 2016-2021. Sfidë mbetet procedura e përzgjedhjes dhe puna e recensentëve si dhe mungesa e përgjegjësisë dhe llogaridhënies për cilësinë e teksteve shkollore. Në anën tjetër, në tekste të mëhershme përveç problemeve tjera të cilësisë ka pasur probleme të theksuara me stereotipet gjinore dhe krahas dokumenteve kurrikulare gjithëpërfshirëse dhe standardeve për tekste shkollore ku barazia gjinore është standard i përgjithshëm, Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) në bashkëpunim Divizionin e kurrikulave dhe Zyra për Barazi Gjinore (ZBGJ) në MASHTI (me financim të Qeverisë Suedeze), kanë hartuar Manualin për Prandalimin e Stereotipeve Gjinore në tekste shkollore.<sup>47</sup> Në këtë linjë tekste të reja nuk përmbajnë stereotipizime por si tërësi janë të dominuara nga autorë burra, ndërsa ekspertet gra, të fushave të ndryshme, rrallë herë konsultohen.<sup>48</sup>

<sup>47</sup> [https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/ALB-Manual%20SteriotipetGjinore-ALB\(1\).pdf](https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/ALB-Manual%20SteriotipetGjinore-ALB(1).pdf)

<sup>48</sup> <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Programi%20i%20Kosov%C3%ABs%20p%C3%ABr%20Barazi%20Gjinore%202024%20-%20SHQIP%20-%20FINAL.pdf>



### 3.5.3 Arsimi, aftësimi profesional dhe arsimi për të rritur

Në fushën e arsimit, aftësimit profesional dhe arsimit për të rritur, analiza e gjendjes trajton tri fusha tematike me interes për këtë sektor të arsimit:

- Qeverisja dhe sigurimi i cilësisë në Arsim dhe Aftësim Profesional (AAP).
- Ndërlidhja e arsimit dhe aftësimit profesional me tregun e punës.
- Arsimi për të rritur.

#### Qeverisja dhe sigurimi i cilësisë në AAP

Interesimi i të rinjve për shkollat e arsimit dhe aftësimit profesional është rritur viteve të fundit dhe shkalla e orientimit të nxënësve në shkollat e mesme profesionale dhe gjimnazeve është baraspeshuar. Statistikat e vitit 2020/21 tregojnë se 53% e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë vijnë në mësimin në shkollat e arsimit dhe aftësimit profesional. Të ndara sipas gjinisë, të dhënat tregojnë se krahasuar me vajzat, djemtë kanë më shumë prirje të regjistrohen në shkollat e arsimit dhe aftësimit profesional. Rreth 42.3% e nxënësve në arsim profesional janë vajza. Nga analiza gjinore e orientimit në arsim profesional vërehet tendenca e orientimit të vajzave në profilet e shëndetësisë dhe mirëqenies, biznesit, administrimit dhe drejtësisë. Djemtë kanë tendencë të orientimit në profilet e inxhinierisë, prodhimit dhe ndërtimit, teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Shkalla e orientimit të vajzave në profilet teknike (fusha e inxhinierisë, prodhimit dhe ndërtimit) rezulton 22.5%.

**Tabela 2.** Regjistrimi në arsimin e mesëm profesional sipas fushave të ISCED-F dhe gjinisë

Fushat e ISCED-F	2016/17		2017/18		2018/19		2019/20		2020/21	
	Gjithsej	Vajza	Gjithsej	Vajza	Gjithsej	Vajza	Gjithsej	Vajza	Gjithsej	Vajza
Artet dhe shkencat humane	1,323	832	1,558	1,024	1,448	1,023	1,568	1,067	1,546	1,059
Biznesi, administrata & drejtësia/juridiku	13,550	6,346	13,817	6,609	12,381	5,762	10,920	5,023	10,005	4,616
TIK	5,460	1,729	5,299	1,602	4,772	1,388	4,148	1,132	3,857	929
Inxhinieria, prodhimitaria & ndërtimtaria	15,342	3,595	15,288	3,578	14,534	3,391	13,179	2,960	12,389	2,638
Bujqësia, pylltaria, peshkataria dhe veterinarja	1,301	404	1,824	656	1,541	536	1,333	442	1,227	466
Shëndeti dhe mirëqenia	7,152	4,822	7,591	5,161	8,022	5,495	8,839	6,123	8,912	6,330
Shërbimet	1,258	363	1,306	338	1,087	319	830	212	842	256
Të tjera	0	0	83	24	18	2	0	0	72	33
<b>Gjithsej</b>	<b>45,386</b>	<b>18,091</b>	<b>46,766</b>	<b>18,992</b>	<b>43,803</b>	<b>17,916</b>	<b>40,817</b>	<b>16,959</b>	<b>38,850</b>	<b>16,327</b>

Burimi: SMIA/MASHTI

Përkundër që të dhënat e fundit tregojnë një rritje të numrit të regjistrimeve në shkollat e arsimit dhe aftësimin profesional dhe e pozicionojnë Kosovën afër mesatares së vendeve të zhvilluara të BE-së, shkollat profesionale vazhdojnë që përgjithësisht të mbesin si zgjedhje e dytë, veçanërisht për nxënësit që nuk kanë mundur të regjistrohen në gjimnaze. Regjistrimi në shkollat profesionale nuk ka ndonjë kriter specifik për pranim, dhe kjo ndikon që të tërheqë nxënësit me arritshmëri të ulët ose nxënësit që nuk mund të regjistrohen në gjimnaze.

Institucionet arsimore publike të arsimit dhe aftësimin profesional, me përjashtim të Qendrave të Kompetencës, janë nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të komunave të cilat këtë rol e ushtrojnë përmes drejtorive komunale të arsimit. Pushteti qendror është përgjegjës për bërjen e politikave të arsimit, financimin dhe inspektimin. Brenda këtij sistemi, institucionet arsimore kanë shumë pak autonomi menaxhuese dhe financiare.

Autoriteti i komunave, si përgjegjës për udhëheqjen dhe menaxhimin e gjimnazeve dhe shkollave profesionale, e ka bërë shumë të vështirë mundësinë e lëvizjes së nxënësve nga një komunë në tjetrën. Prandaj, kjo është bërë shkas që disa komuna të vogla të formojnë gjimnaze ose profile të caktuara të arsimit profesional edhe atëherë kur nuk kanë kushte infrastrukturore dhe profesionale për diç të tillë. Po ashtu, komunat nuk tregojnë fleksibilitet në ndryshimin e profileve në shkolla profesionale, për të adresuar, mes tjerave, edhe problemin e tepercave të personelit mësimor. Nga ana tjetër, kapacitetet e drejtorive komunale të arsimit për të mbikëqyrur institucionet edukative-arsimore janë më se të kufizuara dhe DKA-të nuk kanë ndonjë strukturë organizative konform funksionit që kanë. Për më tepër, linja e autoritetit nga drejtoritë komunale të arsimit drejt MASHTI-t mungon.

AAAPARr menaxhon gjashtë IAAP (Qendra të Kompetencës), edhe pse kuadri ligjor dhe buxheti i nevojshëm nuk janë miratuar që t'i mundësojnë AAAPARR-së menaxhimin e të gjitha shkollave profesionale ndërsa kapaciteti i saj për të përmbushur këtë funksion mbetet një sfidë. Nga ana tjetër, edhe kapacitetet e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve janë të kufizuara për t'iu përgjigjur dinamikës së nevojshme për validimin dhe akreditimin e kualifikimeve të reja dhe për miratimin e standardeve të profesionit.

Në nivel të shkollave profesionale, përveç autonomisë së kufizuar menaxheriale dhe financiare, as struktura organizative nuk është përcaktuar. Rrjedhimisht, mekanizmat për sigurim të cilësisë, për orientim në karrierë, për bashkëpunim me bizneset dhe për ZHPM me bazë në shkollë dallojnë ndërmjet shkollave.

Sa i përket financimit të AAP-së, niveli aktual nuk i përmbush nevojat e shkollave profesionale. Financimi i AAP-së nuk ka shënuar ndonjë rritje të ndjeshme në vitet e fundit, ndërsa formula aktuale e financimi është e përgjithësuar sipas orientimit për kokë nxënësi dhe jo me ndonjë diferencim të shpenzimeve sipas nevojave specifike të profileve. Ekzekutimi i buxhetit në pjesën më të madhe realizohet nga komunat, përfshirë menaxhimin e prokurimit dhe pagesave. Kjo shkakton shumë probleme praktike për shkollat, sidomos kur përballen me nevoja emergjente, si dhe ngarkon zyrtarët e arsimit në komunë me përmbushjen e nevojave të përditshme të institucioneve arsimore, duke filluar nga riparimet e vogla e deri tek investimet më të mëdha. Situata është e njëjtë edhe me shkollat të cilat janë nën autoritetin e AAAPARr. Edhe pse ekziston një rregullore për planifikimin dhe shpenzimin e të hyrave vetjake të realizuara nga institucionet e arsimit dhe aftësimin profesional dhe arsimit për të rritur, në aspektin praktik, ato përballen me vështirësi në menaxhimin e të hyrave vetjake. Së fundi, MASHTI ka nisur punën në përgatitjen e formulës së financimit të arsimit dhe aftësimin profesional.

Kuadri ligjor për AAP rezulton të jetë kompleks, i fragmentuar dhe i mangët në adresimin e disa çështjeve, duke shpie në një qasje të fragmentuar midis institucioneve përgjegjëse për proceset e jashtme të SC në sistemin e AAP dhe duke pamundësuar një qasje sistemore dhe gjithëpërfshirëse. Në këtë kontekst, përderisa Korniza Kombëtare e Kualifikimeve njih një sistem më të gjerë të SC në AAP (përfshirë rolin e Inspektoratit të Arsimit për vlerësimin e jashtëm të IAAP), aktet nënligjore që rregullojnë proceset e SC në arsimin e përgjithshëm nuk mbulojnë shkollat profesionale, duke kufizuar përgjegjësinë për sigurim të jashtëm të cilësisë në shkollat profesionale vetëm në AKK. Autoriteti për validimin e programeve mësimore ndërmjet MASHTI dhe AKK nuk është i qartë, ndërsa ndërlidhja midis të drejtës për të ofruar AAP dhe akreditimit nuk është rregulluar për institucionet publike të AAP. Mekanizmat për SC në nivelin e sistemit nuk janë të definuar. Si rrjedhojë, mungon monitorimi sistematik i sistemit të AAP-së dhe raportimi i rregullt mbi cilësinë dhe zhvillimin e AAP-së në nivel të sistemit, që do të informonte dhe lehtësonte hartimin dhe planifikimin e politikave strategjike të AAP-së në nivel vendi. Procedurat për mbledhjen e rregullt të informatave kthyes nga ofruesit e AAP, si bazë për zhvillimin e vazhdueshëm të Kornizës Kombëtare për Sigurim të Cilësisë, nuk janë të definuara.

Mekanizmat e brendshëm për sigurimin e cilësisë ende nuk janë konsoliduar plotësisht dhe proceset e vet-vlerësimit realizohen në masë të madhe formalisht (për përmbushjen e një obligimi) por pa ndikim të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë. Në këtë mënyrë, interesimi i shkollave profesionale për realizimin e vlerësimit të brendshëm të shkollës ka shënuar rënie. Nga ana tjetër, mundësitë për zhvillim të vazhdueshëm profesional të koordinatorëve për Sigurim të Cilësisë janë të kufizuara, ndërsa udhëzuesit në dispozicion për proceset e brendshme të sigurimit të cilësisë nuk i adresojnë mjaftueshëm nevojat e shkollave për zbatim adekuat të ciklit të cilësisë. Në këtë kontekst, menaxhimi i cilësisë në nivel të shkollave profesionale dhe në nivel të sistemit nuk është funksional dhe efikas në monitorimin e cilësisë, identifikimin e prioriteteve të intervenimit për përmirësim të cilësisë dhe në realizimin e tyre.

### **Ndërlidhja e arsimit dhe aftësimin profesional me tregun e punës**

Arsimi i mesëm profesional supozohet që duhet t'i aftësojë dhe t'i përgatisë nxënësit në shumë profesione dhe zanate të ndryshme për të hyrë në tregun e punës me rastin e përfundimit të shkollimit të mesëm profesional. Por, shumë vlerësime tregojnë se shkollat e mesme profesionale në Kosovë nuk e përmbushin kënaqshëm këtë qëllim të tyre. Në përgjithësi gjendja dhe cilësia në këto shkolla nuk është në nivelin e duhur, për shkak se këto shkolla ballafaqohen me sfida të shumta, si mosbashkëpunimi i duhur me bizneset, mospërshtatja e mjaftueshme me tregun e punës, infrastrukturë dhe pajisje jo të mjaftueshme, mungesë të laboratorëve e punëtorëve, të mësimin praktik dhe mësimin në vendin e punës, mungesë të materialeve mësimore, si dhe mungesë të shërbimeve të orientimit dhe këshillimit në karrierë në ciklin paraprak të shkollimit.

Aktualisht, një numër i konsiderueshëm i kualifikimeve që ofrohen në shkollat profesionale nuk janë të bazuara mbi nevojat e tregut të punës, standardet e profesionit mungojnë për shumë profile, kurrikula për lëndët e përgjithshme nuk është e përditësuar ndërsa vendimet për hapjen e profileve të caktuara merren pa ndonjë analizë të mirëfilltë të nevojave të tregut të punës. Miratimi dhe fillimi i zbatimit të kurrikulave të reja është shtyrë me idenë që fillimisht të finalizohet dhe miratohet Kurrikula Bërthamë për AAP, të intensifikohet procesi i hartimit të standardeve të profesionit dhe mbi atë bazë të unifikohet qasja dhe struktura e kurrikulave të hartuara për profilet profesionale si dhe të sigurohet ndërlidhja me nevojat e tregut të punës.

Hulumtimeve të tregut të punës nuk i kontribuon as sistemi informativ për tregun e punës i cili nuk ofron të dhëna të përditësuara dhe relevante për nevojat dhe kërkesat e tregut të punës (respektivisht punëdhënësve). Nga ana tjetër mungon edhe një metodologji e standardizuar për hulumtimin e tregut të punës dhe për parashikimin e nevojave të tregut të punës.

Këshillimi dhe orientimi në karrierë mbetet sfidë dhe shërbimet e ofruara janë ende të kufizuara në disa komuna. Në disa komuna ekzistojnë qendrat e këshillimit dhe orientimit në karrierë në nivel komunal apo zyrat e këshillimit dhe orientimit në karrierë janë të vendosura brenda shkollave. Në vitet e fundit janë zbatuar disa programe trajnuese për mësimdhënësit e shkollave profesionale për këshillim në karrierë dhe për bashkëpunim me punëdhënës si dhe janë realizuar investime në qendra të karrierës në disa shkolla profesionale. Megjithatë, ende nuk është shënuar progres i mjaftueshëm në caktim të këshilltarëve për këshillim dhe orientim në karrierë.

Mësimdhënia është kryesisht teorike ndërsa mundësitë për zhvillim profesional të mësimdhënësve në ngritjen e shkathtësive pedagogjike dhe realizimin e mësimi praktik janë të kufizuara. Edhe rruga e përgatitjes profesionale të mësimdhënësve për AAP (para shërbimit) nuk është e qartë. Një sfidë tjetër e AAP-së mbetet realizimi i mësimi praktik (në shkollë dhe në vendin e punës). Punëtoritë për shumë profile mungojnë, ndërsa edhe kur ekzistojnë nuk mund të shfrytëzohen plotësisht për shkak të pajisjeve të vjetruara (apo mungesës së tyre), mungesës së lëndës së parë (materialit shpenzues) të nevojshme për mësim praktik si dhe përgatitjes së pamjaftueshme të instruktorëve për realizimin e mësimi praktik. Nga ana tjetër, pilotimi i mësimi dual nuk ka filluar ende. Sfidat në realizimin e mësimi në vendin e punës janë të ndryshme, si nga ana e shkollave ashtu edhe nga ana e punëdhënësve. Përkundër gatishmërisë së punëdhënësve për të pranuar nxënësit për mësim në vendin e punës, në përgjithësi ata nuk kanë kapacitete për të akomoduar një numër të madh të nxënësve. Shumica e ndërmarrjeve kosovare janë mikro dhe të vogla dhe vizioni i tyre për zhvillim është më afatshkurtër. Për më shumë, edhe në rastet kur nxënësit realizojnë mësimin në vendin e punës te punëdhënësi, ajo rrallë bëhet me planifikimin e duhur që bazohet në kërkesat e kurrikulës. Sfidat e tjera që pengojnë realizimin e mësimi në vendin e punës janë mungesa e planeve zhvillimore afatgjata në shumicën e ndërmarrjeve, mungesa e koordinatorëve në shkolla të cilët do të shërbenin si lehtësues midis shkollave dhe punëdhënësve.

Në vitin 2020, MASHTI ka aprovuar UA 137/2020 të Mësuarit në Vendin e Punës në institucionet e arsimit dhe aftësimi profesional<sup>49</sup>, i cili rregullon mënyrën e organizimit, zbatimit dhe vlerësimit të nxënësve gjatë realizimit të mësimi në vendin e punës. Po ashtu, është aprovuar Rregullorja 135/2020 për mbrojtjen dhe ruajtjen e shëndetit të nxënësve gjatë mësimi praktik në shkollë dhe në vendin e punës<sup>50</sup>. Megjithatë, ende nuk ka asnjë instrument për stimulimin e ndërmarrjeve për të bashkëpunuar me shkollat në realizimin e mësimi praktik.

MASHTI, ka aprovuar UA 136/2020 për krijimin e strukturës stimuluese për mbështetjen e shkollimit të nxënësve në drejtimet deficitare dhe për vajzat/gratë në drejtimet teknike në institucionet e arsimit dhe aftësimi profesional. Në këtë drejtim, ofrohen bursa për vajzat që vijojnë shkollimin në shkollat profesionale në profilet teknologji ushqimore dhe agrobiznes, si dhe për vajzat që regjistrohen në drejtime teknike në shkollat profesionale.

49 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/12/udhzimi-administrative-me-nr-137-2020-te-mesurit-ne-vendin-e-punese-ne-iaap.pdf>

50 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/12/udhzimi-administrativ-me-nr-135-2020-per-mbrojtjen-dhe-ruajtjen-e-shendetit-te-nx-ensve-gjate-mesimit-praktike-ne-shkollat-dhe-ne-vendin-e-punes.pdf>

Korniza ligjore për gjurmimin e të diplomuarve nga sistemi i AAP-së në nivel kombëtar mungon dhe rrjedhimisht mungojnë edhe të dhënat e punësimit të të diplomuarve dhe përputhshmërisë së aftësive të tyre me kërkesat e tregut të punës.

### **Arsimi për të rritur**

Mësimi gjatë gjithë jetës, si qasje, kompetencë e veçantë dhe parim themelor për reformimin dhe riorganizimin e sistemit arsimor ende nuk e ka gjetur zbatimin e duhur. Dispozitat për arsimin e të rriturve priren të përqendrohen vetëm në arsimin formal të përshtetshëm kompensues, duke mos rregulluar modalitetet tjera të arsimit për të rritur që mund të ofrohen nga shkollat profesionale (p.sh. kurse afatshkurtra bazuar në NjMP ose bazuar në kërkesat specifike të kandidatëve të interesuar). Ndërlidhja e ngushtë që i bëhet ARr me arsimin formal nuk reflekton kuptimin ndërkombëtar të të mësuarit gjatë gjithë jetës që shkon përtej perspektivës ekonomike ose të punësimit dhe përfshin aspekte të mësimin personal, qytetar dhe social. Për më tepër, ende nuk ka një saktësim/rregullim se cilat profile kanë të drejtë të ofrohen si programe formale për ARr.

Mundësitë për progres dhe lëvizshmëri brenda sistemit të arsimit për të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe arsim të të rriturve si dhe mundësitë/ofertat për kualifikim, ngritje të kualifikimit dhe rikualifikim janë të kufizuara. Përkundër disa zhvillimeve pozitive gjatë periudhës së fundit në aspektin e rregullimit të Njohjes së Mësimin Paraprak (NjMP), deri më tani vetëm 4 institucione janë akredituar për NjMP nga AKK. Kapacitetet e kufizuara u pamundësojnë shkollave profesionale të zhvillojnë/ofrojnë profile të reja për ARr, ndërsa kapacitetet e pamjaftueshme të AKK-së për procesin e validimit dhe akreditimit (përfshirë edhe verifikimin dhe aprovimin e standardeve të profesionit) janë pengesë për t'ju përgjigjur shpejt ndryshimeve dinamike që ndodhin në tregun e punës.

Sa i përket zhvillimit profesional të mësimitdhënësve për ARr oferta për programe të aftësimin të mësimitdhënësve ARr është e pamjaftueshme. Gjithashtu, mundësia e mësimitdhënësve për të marrë pjesë në programe të ndryshme të mobilitetit dhe për të mësuar nga praktikatat e mira në vendet tjera është shumë e vogël, për shkak se IAAP-të në masë shumë të vogël janë pjesë e projekteve që mbështesin mobilitetin. Sfidë tjetër paraqet edhe mungesa e standardit të profesionit dhe një kurrikule të mirëfilltë për kualifikimin e kuadrin për ARr.

Mbledhja e të dhënave për arsimin e të rriturve dhe arsimin gjatë gjithë jetës, ende mbetet një nga sfidat kryesore pasi që kapaciteti për të mbledhur dhe përpunuar zhvillimet në sektorin joformal është i kufizuar. Barometri i tregut të punës ofron të dhëna vetëm për numrin e personave që ndjekin arsim për të rritur formal në shkollat e AAP-së në Kosovë, por jo edhe të institucioneve tjera të AAP-së. Po ashtu mungojnë edhe të dhëna mbi gjurmimin e personave që kanë përfunduar programe të ARr.

Sa i përket financimit publik për ARr mungon një linjë e veçantë buxhetore për ARr; në shkollat publike të AAP-së, fondet shpërndahen si pjesë e buxhetit të përgjithshëm të AAP-së. Në përgjithësi, planifikimi dhe zbatimi i masave për avancimin e ARr pengohet nga kufizimet financiare dhe varet nga financimi i vazhdueshëm i donatorëve.

### 3.5.4. Arsimi i lartë


Lidhur me arsimin e lartë, analiza e gjendjes është përqendruar në tri tema gjithëpërfshirëse:

- Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë.
- Inovacioni, ndërlidhja me tregun e punës dhe ndërkombëtarizimi.
- Qeverisja, financimi, integriteti dhe transparenca.

#### Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë

Në vitin akademik 2020/21, sistemi i arsimit të lartë në Kosovë përbëhet nga 24 institucione të akredituara të arsimit të lartë, prej të cilave 9 institucione publike dhe 15 institucione private. Këtij numri duhet shtuar edhe Universitetin e Mitrovicës së Veriut, i cili ofron programe në gjuhën serbe, por vazhdon të zhvillojë veprimtarinë në kuadër të sistemit arsimor të Serbisë. Me këtë numër të institucioneve të arsimit të lartë, Kosova vazhdon të mbetet një ndër vendet me numrin më të madh të institucioneve të arsimit të lartë për 1 milion banorë. Institucionet e akredituara të arsimit të lartë në Kosovë, në vitin akademik 2020/2021, ofrojnë 400 programe të studimit, prej të cilave 236 programe të studimit janë të nivelit baçelor, 156 programe të studimit janë të nivelit master dhe 8 programe të studimit të nivelit të doktoratës.

Në vitet e fundit numri i studentëve në arsimin e lartë është në rënie dhe kjo rënie është më e madhe tek institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë. Në vitin akademik 2020/21, në institucionet e akredituara të arsimit të lartë në Kosovë, kanë vijuar studimet 95,335 studentë (57.4% në sektorin publik, 42.6% në sektorin privat), prej të cilëve 58.5% vajza/gra. Bazuar në të dhënat e fundit në vitin 2020/21, rreth 56.3% bruto e studentëve të grup-moshave 18-22 vjeç, ndjekin arsimin e lartë në Kosovë. Pjesëmarrja e femrës në arsimin e lartë është në nivel të kënaqshëm. Vajzat/gratë përbëjnë 59.5% të studentëve në sektorin publik dhe 57.1% të studentëve në sektorin privat. Indeksi i paritetit gjinor në arsimin e lartë në Kosovë është 1.41.

**Figura 8.** Studentët në institucionet e arsimit të lartë në gjashtë vitet e fundit

Burimi: Statistikat e arsimit 2015/16, 2016/17, 2017/18, 2018/19 dhe 2019/2020, MASHTI

Gjatë vitit 2019/20, kanë diplomuar rreth 13,792 studentë në nivelin baçelor dhe master në programe të ndryshme të studimit në sektorin publik dhe privat. Sektori privat kontribuon me rreth 44.2% të të diplomuarve. Të dhënat tregojnë se vajzat/gratë u përgjigjen më mirë obligimeve të tyre sesa djemtë/burrat, ku 66.2% e të diplomuarve në vitin akademik 2019/20 janë vajza/gra. Shkalla e diplomimit me kohë e studentëve kosovarë, nuk është e kënaqshme.

Sipas të dhënave në vitin 2020/21, në institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë në marrëdhënie të rregullt pune janë 1,369 anëtarë të personelit akademik dhe 722 bashkëpunëtor të jashtëm, ndërsa në institucionet private të arsimit të lartë në marrëdhënie të rregullt pune janë 1,906 anëtarë të personelit akademik dhe 701 bashkëpunëtor të jashtëm. Raporti profesor-student në institucionet publike është 1:42 ku në një situatë më të vështirë është Universiteti i Pejës. Raporti profesor-studentë në institucionet publike, përkundër përmirësimit, vazhdon të mbetet i lartë, krahasuar me universitetet në vendet e rajonit. Ky raport përmirësohet deri në një masë kur llogariten edhe stafi akademik i angazhuar me honorar, edhe pse nuk duhet anashkalluar faktin se një pjesë e mirë e tyre mund të jenë personat e njëjtë, që punojnë në disa institucione të arsimit të lartë njëkohësisht. Numri i pamjaftueshëm i personelit akademik të kualifikuar ndikon drejtpërdrejtë në cilësinë e arsimit të lartë. Në këtë drejtim, rreziku tjetër që bartë numri i pamjaftueshëm i personelit akademik të kualifikuar janë grupet e mëdha të studentëve, ku mësimdhënësit nuk arrijnë t'u kushtojnë kujdesin e duhur nevojave individuale të studentëve, ndërkohë që procesi i vlerësimit të njohurive mund të kalojë në mënyrë sipërfaqësore.

Sistemi i sigurimit të cilësisë në Kosovë karakterizohet me specifika të njëjta sikurse në shtetet evropiane të cilat kanë kaluar në procesin e tranzicionit, sikurse rritja e pakontrolluar e institucioneve të arsimit të lartë, mungesa e mekanizmave të sigurimit të brendshëm të cilësisë si dhe politika jo të qarta për zhvillimin e kuadrove akademike dhe shkencore.

Në Kosovë aplikohet procesi i akreditimit i bazuar në qasjen e sigurimit të cilësisë, apo përmbushjes së kritereve minimale të cilësisë të përcaktuara në legjislacionin vendor. Procesi i akreditimit është proces i obligueshëm ligjor dhe institucionet e arsimit të lartë kanë pasojë juridike nëse nuk arrijnë të marrin akreditimin. Përkundër që procesi i akreditimit ka ndikuar ndjeshëm në përmirësimin e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, sistemi i sigurimit të cilësisë ende nuk është pjekur në masën e duhur që të zbatohet një sistem i bazuar në qasjen e plotësimit/zgjerimit të cilësisë (quality enhancement) apo kulturës së cilësisë ashtu siç ndodh në shtetet e zhvilluara të Evropës. Në përgjithësi, institucionet e arsimit të lartë ende nuk e kuptojnë sigurimin e brendshëm të cilësisë si një proces të rregullt të institucionit të tyre i cili duhet t'ju shërbejë atyre si udhërrëfyes për vendimmarrje dhe planifikim strategjik, por e kuptojnë atë më tepër si një instrument të marrjes së vendimit për akreditim.

Përpos procesit të akreditimit i cili përcillet me sfida të shumta, në Kosovë nuk aplikohet sistemi i monitorimit, si një proces i vazhdueshëm i sigurimit të cilësisë i cili kontrollon nëse institucioni vazhdon të mirëmbajë standardet e cilësisë me të cilat fillimisht është akredituar. Në mungesë të burimeve njerëzore, AKA nuk arrin të sigurojë nëse rekomandimet apo kërkesat specifike të ekspertëve të akreditimit adresohen nga institucionet e arsimit të lartë për të siguruar se kriteret e cilësisë dhe kushtet e akreditimit mirëmbahen në vazhdimësi nga ta. Procesi i licencimit si mekanizëm i kontrollit dhe i monitorimit për institucionet e arsimit të lartë konsiderohet si një proces teknik dhe pa ndonjë vlerësim përmbajtësor. Mekanizmi i procesit të akreditimit, monitorimit, zhvillimit, inspektimit edhe procesi i licencimit në planin afatgjatë duhet të shihet si proces i ndërlidhur dhe duhet të harmonizohen me njëra-tjetrën në kontekstin e afateve kohore, shqyrtimit të kërkesave, monitorimit dhe vendimmarrjes.

Sistemi i brendshëm për sigurimin e cilësisë vazhdon të mbetet një prej pikave të dobëta të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë që reflektohet edhe në cilësinë e mësimdhënies. Institucionet e arsimit të lartë nuk i kanë të funksionalizuara plotësisht zyrat për sigurimin e cilësisë, ato sfidohen për shkak të kapaciteteve të kufizuara të stafit që merret me aspekte të sigurimit të cilësisë, proceset e vetëvlerësimeve kryesisht realizohen vetëm për qëllim të akreditimit dhe jo për qëllim të përmirësimit të brendshëm të institucionit, ndërsa, instrumentet e sigurimit të cilësisë në të shumtën e rasteve, kufizohen vetëm në vlerësimin e stafit akademik nga studentët. Për më shumë, këto institucione kanë mungesë të stafit akademik, të kapaciteteve hulumtuese dhe shkencore, mungesë të autonomisë financiare, si dhe mangësi të ndërkombëtarizimit dhe shkëmbimit të studentëve dhe stafit akademik

AKA-ja ka rishikuar Standardet e Akreditimit, proces i cili ka ndodhur si përgjigje ndaj kërkesave dhe nevojave në ndryshim të institucioneve të arsimit të lartë por edhe tërë sistemit në përgjithësi. Tashmë, Standardet e Akreditimit kanë për qëllim të konsolidojnë sistemin e brendshëm të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë si dhe të mbështesin institucionet e arsimit të lartë në zgjerimin e cilësisë dhe zhvillimin e vazhdueshëm të operacioneve të tyre.<sup>51</sup> AKA, po ashtu ka funksionalizuar platformën elektronike “E-Akreditimi”, përmes së cilës tashmë shumë nga proceset që ndërlidhen me vlerësimin dhe akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, siç janë deklarimi i stafit akademik të angazhuar në institucione realizohet përmes mënyrës elektronike. Përfundimi i AKA-së nga

51 Plani Strategjik i Agjencisë së Kosovës për Akreditim 2021-2024.



dy mekanizmat kryesor të sigurimit të cilësisë në Evropë, ENQA dhe EQAR ka krijuar pasoja të pariparueshme për sistemin e arsimit të lartë. Ndërhyrjet politike në të kaluarën, në institucionet e pavarura të sigurimit të cilësisë dëshmojnë për brishtësinë e sistemit të arsimit të lartë në Kosovë.

Nga shumë anketa me studentë, rezulton se shumë profesorë përdorin ende teknika klasike të ligjërimit pa ndonjë përfshirje interaktive të studentëve. Përveç mangësive evidente në mësimdhënie, angazhimi i studentëve në punë praktike është sipërfaqësor dhe pa ndonjë nxitje domethënëse të mendimit kritik dhe kreativ. Numri i madh i studentëve brenda klasave dhe grupeve pamundëson një proces efektiv të mësimdhënies, nuk nxit aftësitë kritike dhe kreative dhe nuk rrit interaktivitetin me studentë.

Aktualisht, vetëm Universiteti i Prishtinës dhe Universiteti i Gjakovës kanë të themeluara dhe të funksionalizuara Zyrat për Përsosmëri të Mësimdhënies, të cilat kanë strategji zhvillimore. Asnjë nga institucionet tjera publike të arsimit të lartë në Kosovë nuk i kanë themeluar/funksionalizuar zyrat e tilla për t'i ofruar stafit akademik shërbime të zhvillimit akademik, përkatësisht programe të ndryshme të trajnimit lidhur me metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Në shumicën e rasteve, zhvillimi i stafit akademik është proces krejtësisht vullnetar i individëve se sa një qasje institucionale e cila zbatohet në bazën e një plani të publikuar dhe të aplikuar në mënyrë konsistente. Aktivitetet tjera që ndërlidhen me vlerësimin e nevojave të stafit akademik për zhvillim profesional, hartimin e planeve për zhvillim profesional, të stafit akademik dhe zhvillimin e mekanizmave për monitorim dhe vlerësim të punës së stafit akademik, janë realizuar formalisht në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, mirëpo ende mbeten në nivel të kufizuar të zbatimit.

Përkundër asaj që puna kërkimore-shkencore është aspekt i rëndësishëm i zhvillimit të arsimit të lartë, ajo ende nuk është e integruar mjaftueshëm në aktivitetet e institucioneve të arsimit të lartë. Mësimdhënia përbën aktivitetin kryesor të stafit akademik, ndërsa puna kërkimore zhvillohet në baza ad-hoc, pa ndonjë platformë diskutimi për kërkimin shkencor.

Sfidat kryesore për punë kërkimore-shkencore në Kosovë lidhen me burimet njerëzore, infrastrukturën dhe pajisjet jofunksionale. Institucionet e arsimit të lartë përballen me mungesën e hapësirave fizike si dhe pajisjeve dhe instrumenteve laboratorike. Mungesa e infrastrukturës adekuate për punë kërkimore paraqet një sfidë dhe mangësi edhe për pjesëmarrjen në programin “Horizon 2020”, meqenëse ndërtimi i konzorciumeve të bashkëpunimit merr për bazë edhe kushtet për punë kërkimore në institucionet e arsimit të lartë. Institucionet e arsimit të lartë nuk kanë strategji adekuate për kërkim shkencor, ndërsa kanë fonde dhe kapacitete të kufizuara për t'u angazhuar në projekte të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në përputhje me mundësitë aktuale për punë hulumtuese shkencore, janë realizuar publikime në shumë revista dhe simpoziume me karakter vendor dhe ndërkombëtar. Viteve të fundit, si rezultat i angazhimit individual dhe ekipor të hulumtueseve, janë evidentuar një numër i konsiderueshëm i publikimeve shkencore në revista ndërkombëtare. Në bazë të të dhënave të Bankës Botërore lidhur me numrin e publikimeve shkencore (2018), numri i publikimeve shkencore nga Kosova në revista të indeksuara ndërkombëtare është rritur gradualisht nga viti 2009.<sup>52</sup> Numri i publikimeve shkencore/teknike në revista të indeksuara ndërkombëtare është dyfishuar, krahasuar me vitin 2015. Megjithatë, në shume raste, ato mbesin në margjinat e publikimeve sipas dëshirës dhe kryesisht për marrjen e titujve akademikë, por jo edhe si një pjesë e kulturës akademike për të hulumtuar dhe gjeneruar një dije të re që ndihmon zhvillimin e vendit, apo institucionet në veçanti.

52 <https://data.worldbank.org/indicator/IP.JRN.ARTC.SC?end=2018&locations=XK&start=2000&view=chart>

### **Inovacioni, ndërlidhja me tregun e punës dhe ndërkombëtarizimi**

Ofrimi i programeve të studimit të cilat nuk reflektojnë nevojat reale të tregut të punës mbetet mangësi strukturore e arsimit të lartë. Njëkohësisht, këtyre programeve iu mungon edhe ndërdisiplinarteti, pjesa e mësimit praktik si dhe ndërlidhja me kërkimin shkencor. Rreth 60% të programeve studimore që ofrohen janë nga fusha e edukimit, arteve dhe shkencave humane, shkencave shoqërore dhe shërbimeve. Numri më i madh i studentëve dhe programeve arsimore janë në kategorinë e shkencave shoqërore dhe studimit të së drejtës. Orientimi i studentëve në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë mbetet i ulët. Vërehet një dallim i theksuar në orientim në fusha të caktuara të studimit në arsimin e lartë sipas gjinisë. Vajzat janë të prirura të jenë të orientuara (mbi 90%) në programet e edukimit, shkencave natyrore, shkencave shoqërore, mjekësisë, komunikimit dhe gjuhësisë. Djemtë dominojnë në fusha të studimit të informatikës, humanistikë, gjeografi/gjeologji dhe inxhinieri/teknologji. Një orientim i baraspeshuar gjinor vërehet në fushat e arkitekturës, biznesit dhe drejtësisë. Shkalla e orientimit të studentëve në fushat e studimit në shkencë shoqërore, humane, biznes dhe juridik është shumë e lartë në krahasim me dinamikën e tregut.

Pothuajse në të gjitha njësitë akademike të institucioneve publike të arsimit të lartë ekzistojnë bordet industriale këshillëdhënëse. Në bazë të raporteve të vlerësimit të akreditimit, ekspertët kanë vërejtur se në shumicën e rasteve bordet janë themeluar formalisht, takimet e tyre nuk janë të rregullta, dhe se nuk ka ndonjë komunikim sistematik në mes të universiteteve dhe punëdhënësve. Përpos kësaj, nuk ekziston një bashkëpunim në kuptimin e përfshirjes së akterëve relevant në proceset e tjera të planifikimit dhe vendimmarrjes strategjike të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë. P.sh. mungojnë rastet kur ekspertët e fushës apo të profesionit marrin pjesë në proceset e hartimit të planeve strategjike, të programeve të studimit, apo të komisioneve të tjera profesionale të institucioneve të arsimit të lartë të cilat do të mundësonin që universiteti t'ju përgjigjet më mirë nevojave lokale dhe vendore të tregut të punës.

Puna praktike e studentëve mbetet një aspekt i pazhvilluar. Programet e studimit nuk e parashohin zyrtarisht punën praktike të studentëve si pjesë të kurrikulës dhe angazhimi në punë praktike bëhet individualisht nga ana e studentëve dhe jo në mënyrë të kontrolluar nga institucioni. Përveç programeve specifike të studimit ku praktika është e pashmangshme, në shumicën e programeve të tjera të studimit, institucionet e arsimit të lartë nuk sigurojnë punën praktike. Për më shumë, shërbimet e orientimit dhe këshillimit në karrierë të studentëve mbeten mjaft të kufizuara.

Kosova merr pjesë në skema të mobilitetit akademik siç janë: CEEPUS, Erasmus+ dhe përfiton mbështetje nga forma të ndryshme të përkrahjes bilaterale dhe multilaterale në arsimin e lartë. Mundësitë e mobilitetit për stafin dhe studentët janë të shumta, por që mosnjohja e mjaftueshme e gjuhës angleze nga stafi dhe studentët kufizon mundësitë për shfrytëzimin e këtyre skemave. Në programin Erasmus+, Kosova merr pjesë në veprimet e “Key 1 – Shkëmbimet dhe programet e diplomave të përbashkëta” dhe në veprimet “Key 2 – në veprimin për ngritjen e kapaciteteve në arsimin e lartë” dhe në periudhën kohore 2015-2019, 2,763 pjesëtarë të stafit akademik dhe studentë nga Kosova kanë përfituar bursa mobiliteti, përdërisa Kosova ka qenë nikoqire në 1,414 mobilitete.<sup>53</sup> Kosova nga viti 2008 merr pjesë në Programin e Evropës Qendrore për Shkëmbime në Studimet Universitare (CEEPUS), i cili mbështet partneritetin e bashkëpunimit ndërmjet universiteteve të Evropës Qendrore dhe Juglindore dhe nxit bashkëpunimin ndëruniversitar përmes shkëmbimit të stafit akademik, studiuesve dhe studentëve. Përmes programit CEEPUS, janë realizuar 220 mobilitete të studentëve dhe 196 mobilitete të stafit akademik.

<sup>53</sup> <http://erasmuspluskosovo.org/en/erasmus/projects/>

Kosova merr pjesë me një numër të vogël të projekteve në programin e BE-së për financimin e kërkimeve dhe inovacionit “Horizon 2020”. Në periudhën 2014-2021, janë 113 aplikime nga Kosova, prej të cilave 104 kanë qenë aplikime të pranueshme. Në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Përendimor, pjesëmarrja e Kosovës në këtë program mbetet mjaft e ulët. Kapacitetet e pamjafueshme për kërkime shkencore dhe për rrjetëzim ndërkombëtar janë faktorët që ndikojnë në nivelin e ulët të pjesëmarrjes. Kosova ka aplikimet më të ulëta në rajon (113), si dhe aplikimet më të ulëta të mbështetura (19). Gjatë analizës së kontributeve të kërkuara sipas llojit të organizatës, vërehet që aplikimet nga Kosova janë kryesisht nga OJQ-të, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, apo nga individë/grupe hulumtuesish. Deri më sot, vetëm Universiteti i Prishtinës dhe Universiteti i Prizrenit kanë fituar nga një grant në kuadër të programit “Horizon 2020”.

Institucionet e arsimit të lartë në Kosovë tradicionalisht kanë marrëveshje të ndryshme dypalëshe me partnerë universitarë në tërë Evropën. Marrëveshjet dypalëshe janë hapi i parë drejt bashkimit të përpjekjeve për aplikim në fondet shtetërore, evropiane ose të tjera. Shembull, Universiteti i Prishtinës ka pothuajse 400 marrëveshje të tilla dypalëshe me institucione të arsimit të lartë dhe institutet në Evropë dhe SHBA. Megjithatë, shumica e marrëveshjeve dypalëshe mbeten si shfaqje e një vullneti të mirë bashkëpunimi, por të pa përcjellura me një buxhet për zbatim.

### **Qeverisja, financimi, integriteti dhe transparenca**

Procesi i rishikimit të Ligjit për Arsimin e Lartë, është stërzgatur ndër vite dhe kjo ka ndikuar mjaft shumë në dinamikën e hartimit të akteve tjera ligjore në nivel të institucioneve të arsimit të lartë. Ligji për Inovacion Shkencor, Transfer të Dijes dhe Teknologjisë, është miratuar në nëntor të 2018, ndërsa projektligji për Agjencinë e Kosovës për Akreditim është në fazën përfundimtare të aprovimit. Për më shumë, MASHTI ka filluar procedurat për themelimin e Këshillit Kombëtar të Shkencës, i cili do të jetë përgjegjës për përgatitjen e Programit Kombëtar të Shkencës.

Ligji për Profesionet e Rregulluara, përkundër mangësive të identifikuara dhe aprovimit të disa akteve të ndërlidhura nënligjore, ende nuk ka filluar të zbatohet. Këshilli Shtetëror për Profesionet e Rregulluara është në proces të përcaktimit të profesioneve të rregulluara. Stafi i vogël në numër dhe kapacitetet e kufizuara mbeten ndër sfidat kryesore të Divizionit për Profesionet e Rregulluara në kuadër të MASHTI-t.

Stafi i vogël në numër, mungesa e digjitalizimit të plotë të shërbimeve, diplomat e fituara në shtete të huaja të cilat për arsye të ndryshme mbesin në proces apo nuk arrihet t’u jepet njohje, diplomat e fituara në Kosovë të cilat për arsye të ndryshme nuk mund të validohen, janë vetëm disa prej problemeve të cilat e vështirësojnë funksionimin efikas të Qendrës Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (NARIC), e cila ofron informacione në procedurat për njohjen e diplomave dhe kualifikimeve të huaja si dhe ofron informata për sistemin e arsimit parauniversitar dhe të lartë dhe kualifikimet në Kosovë me kërkesë të shteteve të tjera. Mungesa e kapaciteteve njerëzore, i’a vështirëson NARIC-ut dhënien e informatave dhe trajtimin e kërkesave në kohë reale, për shkak të vëllimit të madh të lëndëve.

Në periudhën 2015-2017, është zhvilluar Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsimin e Lartë (SMIAL), i cili bën të mundur përcjelljen e trendeve të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë. Megjithatë, SMIAL ka mungesë të mbështetjes së vazhdueshme teknike për të adresuar pengesat

në futje të të dhënave dhe nuk bën të mundur gjenerimin e të dhënave të nevojshme për analizën e gjendjes në këtë sektor dhe vendimmarrje të informuar.

Shumica e institucioneve të arsimit të lartë formalisht kanë krijuar procedurat dhe mekanizmat për zbatimin e parimeve të etikës në procesin e mësimdhënies dhe hulumtimit shkencor. Megjithatë, ekzistenca e këtyre trupave nuk është e njohur për gjithë komunitetin akademik, komisionet e etikës nuk janë të gjitha funksionale, dhe aplikimi i procedurave të Kodeve të Etikës nuk bëhet në mënyrë transparente dhe publike.<sup>54</sup> Ekzistojnë raporte të ndryshme nga ana e shoqërisë civile në lidhje me dyshimet për autenticitetin e punimeve shkencore të stafit akademik.

Kosova ende nuk e ka të zhvilluar një metodologji për financimin e institucioneve të arsimit të lartë që nxitë efektivitetin dhe llogaridhënien, përkundër faktit që korniza ligjore e arsimit të lartë përcakton zhvillimin e mekanizmave efektiv për financim të bazuar në performancë. Financimi i institucioneve të arsimit të lartë nuk bëhet mbi bazën e një plani të performancës i cili do të mundësonte monitorimin e punës së tyre dhe do të nxiste ndërtimin e kulturës së përgjegjësive dhe llogaridhënies.

Universiteti i Prishtinës vazhdon të jetë kategori e veçantë buxhetore ndërsa universitetet tjera publike janë si nën-programe financiare të arsimit të lartë të MASHTI. Buxhetet e këtyre universiteteve përgatiten mbi baza historike ku si pikënisje përdoret shuma e ndarë fillimisht. Për më tepër, kostoja adekuatë e nënprogrameve përkatëse nuk ka qenë e mundur të bëhet deri më tani për shkak të mungesës së marrëveshjes se si të strukturohen degët dhe fakultetet e universiteteve dhe si të kufizohet numri i përgjithshëm i studentëve në këto universitete (e nevojshme për shkak të burimeve të kufizuara financiare që janë alokuar për arsimin e lartë). Universitetet iu mungojnë të dhënat bazike të nevojshme për zhvillimin e një sistemi të bazuar në formulën për financimin e tyre. Kjo është një nga pengesat kryesore për zbatimin e financimit të bazuar në formulë dhe decentralizimin e ekzekutimit të buxhetit.

### 3.5.5. Digjitalizimi i arsimit

Digjitalizimi i arsimit është proces shumëdimensional i adoptimit sistematik të teknologjisë digjitale për qëllime të avancimit të arsimit. Në kontekstin kosovar, digjitalizimi nënkupton investime domethënëse në infrastrukturë si dhe në krijimin e shërbimeve digjitale dhe materialeve digjitale. Po ashtu, duhet kushtuar kujdes zhvillimit të kompetencës digjitale tek të gjitha kategoritë e shfrytëzuesve të teknologjisë digjitale, përfshirë: fëmijët/nxënësit/studentët, mësimdhënësit, administratorët e arsimit, prindërit, etj. Lidhur me digjitalizimin, analiza e gjendjes është përqendruar në pesë tema gjithëpërfshirëse:

#### **Të dhënat dhe shërbimet digjitale**

Megjithëse në Kosovë është punuar në drejtim të digjitalizimit të të dhënave dhe shërbimeve në fushën e arsimit, veçanërisht në arsimin e lartë, sërish mbetet shumë punë për digjitalizimin e tërësishëm të të dhënave dhe integrimin e tyre në një platformë digjitale gjithëpërfshirëse, në mënyrë që pastaj të mundësohet automatizimi i proceseve dhe ofrimi i shërbimeve digjitale për të gjitha palët e interesuara për të gjitha nevojat në fushën e arsimit, duke përfshirë të gjitha nivelet e arsimit, prej nivelit parashkollor e deri te niveli universitar, përfshirë sektorin publik, jo-publik dhe privat të arsimit në Kosovë.

54 ASHAK (2021). Platformë për Rimëkëmbjen e Arsimit në Kosovë

Digjitalizimi i të dhënave në fushën e arsimit në Kosovë, kryesisht është reduktuar në mbledhjen dhe përpunimin elektronik të të dhënave për institucionet edukative dhe arsimore, përfshirë të dhënat për vijuesit, personelin dhe deri në një masë, për infrastrukturën e institucioneve. Për momentin, këto të dhëna menaxhohen nga dy sisteme që veprojnë në kuadër të MASHTI-it: Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA) dhe Sistemi i Menaxhimit të Informatave të Arsimit të Lartë (SMIAL). Veç këtyre, MASHTI ka edhe platforma të tjera për shërbime të ndryshme, si: Naric-ks.Online<sup>55</sup>, aplikacionin GIS, etj..

Përveç MASHTI-t, edhe AKA i ka të digjitalizuara disa të dhëna dhe ofron disa shërbime digjitale përmes uebfaqes së vet<sup>56</sup> si dhe përmes uebplatformës E-akreditimi<sup>57</sup>. Ndërkaq, Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve (SEMS) dhe Sistemi i Menaxhimit Universitar (SMU) janë sisteme elektronike që përdoren nga IAL-të publike në Kosovë, përmes të cilave ofrohen shërbime të ndryshme online për studentët dhe për personelin.

[Shkollat.org](https://shkollat.org) është një uebfaqe zbarkuese (Landing Page) në pronësi të MASHTI nga viti 2018. Në kuadër të saj ndërveprojnë dy platforma të fuqishme:

- 1 Pasaporta e të nxënit (The Learning Passport), e themeluar në nivel global nga një partneritet mes UNICEF-it, Microsoft-it dhe Universitetit Cambridge. dhe
- 2 Microsoft 365 për Edukim (Microsoft 365 for Education).

Ndërveprimi i këtyre dy platformave të fuqishme në kuadër të shkollat.org, ofron mundësi bashkëpunimi dhe komunikimi dhe një eksperiencë të jashtëzakonshme për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Gjithashtu, ofrohet material e përmbajte digjitale në hapësirë mega terrabitëshe, përmes më shumë se 30 aplikacioneve të integruara të cilat ndërveprojnë mes tyre, e ku më së shumti ka gjetur përdorim aplikacioni Microsoft Teams for Education si dhe pasaporta e të nxënit. Deri më tani kemi mbi 200 000 përdorues dhe mbi 14 000 video ligjërata, kuize, pyetësorë e gamification dhe ky numër është duke u rritur në vazhdimësi. Implementimi i këtyre platformave është mbështetur nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI) dhe UNICEF Kosova.

Përveç këtyre që u përmendën më sipër, ka edhe platforma, aplikacione e projekte të tjera në këtë drejtim, mirëpo të gjitha këto janë vetëm disa hallka të vogla të procesit të digjitalizimit, të cilat nuk janë të integruara me njëra tjetrën, e me një sistem/platformë qendrore. Kjo e pamundëson automatizimin e proceseve<sup>58</sup> dhe ofrimin e shumë shërbimeve digjitale për palët. Prandaj kanë nevojë për avancime dhe plotësime me pjesë të tjera si dhe për integrim në një sistem/softuer qendror. Veç kësaj, këtu duhet të kemi parasysh faktin që IEAA-të publike të Kosovës dhe DKA-të kanë fare pak të dhëna të digjitale dhe nuk ofrojnë pothuajse asnjë shërbim digjital deri më tani.

55 <https://narc-ks.online/>

56 <https://akreditimi.rks-gov.net/>

57 <https://e-akreditimi.rks-gov.net/>

58 Automatizimi i proceseve digjitale (Digital Process Automation - DPA) nënkupton përdorimin e teknologjisë (softverit) për të realizuar shumë procese e detyra në mënyrë automatike (të cilat rëndom kryhen në mënyrë manuale nga njerëzit).

### **Materialet mësimore digjitale**

Në Kosovë ende nuk ekzistojnë materiale mësimore digjitale shumëdimensionale, të cilat në varësi dhe në përputhje me specifikat e lëndës mësimore, fushës kurrikulare, nivelit e klasës, përmbajtjet do t'i kenë në disa formate të ndryshme, përfshirë pjesët tekstuale dhe audio-vizuale të niveleve të ndryshme (mësimi i diferencuar), aparaturë didaktike interaktive, laborator virtual, animacione, ushtrime e detyra shtëpie të niveleve të ndryshme (mësimi i diferencuar), si dhe lojëra edukative për nxënësit. Këto materiale do të ofronin mundësi vlerësimi nga mësimdhënësit dhe mundësi vetëvlerësimi për nxënësit, mundësi që mësimdhënësi të shtojë materiale shitesë, mundësi lidhjeje me burime të ndryshme të platformave online, mundësi lidhjeje me pajisjet teknologjike të mësimdhënësit dhe me pajisjet teknologjike të nxënësve në klasë e në shtëpi, etj. Këto materiale mësimore do duhej të kalonin nëpër filtrat e vlerësimit të mekanizmave të ministrisë, në mënyrë që të mund të përdoren në nivel vendi. Materialet e tilla mësimore digjitale do të duhej të ishin të zhvilluara në mënyrë institucionale, në përputhje me kurrikulat shtetërore, me programet lëndore e me planet mësimore, të cilat të kenë kaluar nëpër filtrat përkatës të kontrollit të MASHTI-t dhe të jenë miratuar për përdorim për institucionet e arsimit parauniversitar në Kosovë.

Të vetmet materiale mësimore janë ato që janë prodhuar gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, me qëllim të ofrimit të mësimi në distancë për fëmijë/nxënës të niveleve e kategorive të ndryshme të arsimit parauniversitar, mirëpo shikuar në planin afatgjatë dhe nga këndvështrimi i cilësisë dhe multidimensionalitetit të materialeve mësimore digjitale të mirëfillta, mund të thuhet se këto materiale janë relativisht të varfra, njëdimensionale dhe me cilësi jo të kënaqshme.

Është me rëndësi të përmendet se zhvillimi dhe prodhimi i materialeve mësimore digjitale nuk është i rregulluar mirë as me legjislacion dhe kjo duhet t'i paraprijë zhvillimit të këtyre materialeve.

### **Shërbimet dhe mjetet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK)**

Kosova ka shkallë të lartë të penetrimit të internetit në shtëpi, ndërsa qytetarët e saj kanë qasje në pajisje dhe teknologji digjitale, të cilat i shfrytëzojnë për nevojat e jetës së përditshme. Për dallim prej gjendjes në nivel të përgjithshëm, gjendja me këto aspekte në institucionet edukative, arsimore, aftësuese, shkencore e akademike nuk duket të jetë kaq e mirë, veçanërisht në ato të arsimit parauniversitar.

Sipas të dhënave të ofruara nga MASHTI – SMIA për nevoja të kësaj analize (shtator 2021), del se 118 ose 15.1 % e IEAA-ve<sup>59</sup> amë publike të Kosovës nuk kanë qasje në internet (prej 786 sa janë gjithsej). Po sipas SMIA-s, 235 ose 83.33 % e paraleleve të ndara të IEAA-ve publike të Kosovës nuk kanë qasje në internet (prej 282 sa janë gjithsej). Thënë përmbljedhtazi, nga totali i objekteve të IEAA-ve publike në Kosovë që është 1,058 (amë dhe paralele të ndara), 705 prej tyre ose rreth 66.64% kanë qasje në internet, ndërsa 353 prej tyre ose rreth 33.36% nuk kanë qasje në internet. Veç kësaj, edhe IEAA-të që kanë qasje në internet, në shumicën e rasteve nuk ofrojnë internet në tërë hapësirën shkollore, por vetëm në zyrat e caktuara të personelit dhe eventualisht në kabinetet e TIK-ut.

59 Në kuadër të IEAA-ve publike përfshihen të gjitha institucionet publike edukative, arsimore e aftësuese parauniversitare, përfshirë institucionet parashkollore, shkollat fillore e të mesme të ulëta, shkollat e mesme të larta (gjimnazet, shkollat profesionale dhe qendrat e kompetencës) dhe qendrat burimore/shkollat speciale.

Ndërsa sa i përket numrit të kompjuterëve (desktopë dhe laptopë), sipas të dhënave të ofruara nga SMIA për nevoja të kësaj analize (shtator 2021), numri total i kompjuterëve<sup>60</sup> në të gjitha IEAA-të publike të Kosovës është 9,138 ose 1 kompjuter për rreth 35 nxënës në IEAA-të publike të Kosovës<sup>61</sup>. Këto përpjesëtime nuk janë të krahasueshme me ato në vendet e BE-së ku një kompjuter në shkollë është në dispozicion për 3 deri në 7 nxënës. Përveç kompjuterëve, sipas të dhënave të pjeshme të SMIA-s të ofruara për nevoja të kësaj analize (shtator 2021), në të gjitha IEAA-të publike janë 1753 projektorë, 191 Smart Board, 502 Smart TV, 727 makina fotokopjuese, 851 printerë, 247 tabletë, 11 skanerë, etj<sup>62</sup>.

Sipas të dhënave të mbledhura nga shtatë IAL-të publike<sup>63</sup> (nëntor 2020), pothuajse të gjitha IAL publike ofrojnë qasje në internet për personelin dhe për studentët në gjithë hapësirat universitare. IAL-të publike kryesisht ofrojnë internet kabllor në zyra dhe kabinete, ndërsa në hapësirat tjera (salla të ligjëratave, biblioteka, korridore, etj.) ofrojnë internet wireless.

### Kompetenca digjitale

“Kompetenca digjitale”, është një nga tetë kompetencat e përfshira në Kuadrin Evropian të kompetencave kyçe për mësimin gjatë gjithë jetës<sup>64</sup>. Kompetenca digjitale është aftësi për shfrytëzimin dhe ndërveprimin konfident, kritik dhe të përgjegjshëm me teknologji digjitale me qëllim të të nxënës, të kryerjes së detyrave të punës dhe të pjesëmarrjes në shoqëri. Ajo përfshin të kuptuarit e informacionit dhe të dhënave, komunikimin dhe bashkëpunimin, të kuptuarit e medias, krijimin e përmbajtjes digjitale (përfshirë kodimin), sigurinë (përfshirë mirëqenien digjitale dhe sigurinë në internet), çështjet që kanë të bëjnë me pronën intelektuale, si dhe zgjidhjen e problemeve dhe të menduarit kritik e krijues. Së këndejmi, kultivimi i kompetencës digjitale tek të gjithë qytetarët është e një rëndësie të madhe dhe barrën kryesore për këtë e bartë sistemi i arsimit dhe institucionet arsimore të të gjitha niveleve.

Sa i përket nivelit të zotërimit të kompetencës digjitale të kategorive të ndryshme që prekë sistemi i arsimit, është e pamundur të nxirret një konstatim i bazuar, sepse deri më tani në Kosovë nuk ka vlerësime të tilla. Megjithatë, nëse merren për referencë zhvillimet në nivel evropian e global, vlerësohet se Kosova duhet të investojë në funksion të rritjes së kompetencës digjitale të të gjitha kategoritë: fëmijët/nxënësit/studentët, edukatorët dhe mësimdhënësit e të gjitha niveleve, si dhe te i gjithë personeli i institucioneve arsimore të të gjitha llojeve dhe niveleve të arsimit. Gjithsesi duhet theksohet se para çfarëdo ndërhyrjeje në këtë drejtim që bazohet në këtë supozim, fillimisht duhet të bëhen analiza, hulumtime ose vlerësime të mirëfillta dhe vetëm pas këtyre të ndërmerren masat e nevojshme apo të bëhen ndërhyrjet e duhura.

60 Nuk ka të dhëna se sa prej këtyre pajisjeve janë funksionale apo se në çfarë gjendjeje teknike janë këto pajisje.

61 Gjithsej 319,153 fëmijë/nxënës në të gjitha IEAA-të publike të Kosovës në vitin shkollor 2020-2021 (sipas të dhënave të SMIA-s për vitin shkollor 2020-2021).

62 Nuk ka të dhëna se sa prej këtyre pajisjeve janë funksionale apo se në çfarë gjendjeje teknike janë këto pajisje.

63 Të dhënat janë raportuar nga Sekretarët e Përgjithshëm të shtatë universiteteve publike: 1) Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, 2) Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”, 3) Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka”, 4) Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”, 5) Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”, 6) Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj dhe 7) Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka”.

64 Council Recommendation of 22 May 2018 on key competences for lifelong learning (2018/C 189/01). [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:32018H0604\(01\)&from=EN](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:32018H0604(01)&from=EN)

Për të gjitha këto ndërhyrje duhet të merren për referencë tri dokumentet evropiane: Korniza Evropiane për Kompetencën Digjitale për Qytetarët (DigComp), Korniza Evropiane e Kompetencës Digjitale për Mësimdhënësit (DigCompEdu) dhe Korniza Evropiane e Kompetencës Digjitale për Organizatat Arsimore (DigCompOrg).

### **Mekanizmat institucionalë për realizimin e digjitalizimit**

Gjendjes jo të mirë sa i përket digjitalizimit dhe përdorimit të teknologjisë digjitale në fushën e arsimit në Kosovë, i kontribuon edhe fakti se deri më tani në Kosovë ka mungesë të theksuar të mekanizmave institucionalë dhe personelit të nevojshëm për planifikimin dhe realizimin e digjitalizimit në fushën e arsimit dhe për nxitjen e aftësimin e palëve për përdorimin e teknologjisë digjitale për nevoja arsimore. Aktualisht MASHTI nuk ka as Departament, as Divizion, madje as zyrtar përgjegjës për digjitalizimi dhe përdorimin e teknologjisë digjitale në fushën e arsimit. Situatë e ngjashme është edhe në DKA, në IEAA, në IAL, në Agjenci, etj.. Veç kësaj, në nivel të DKA-ve, përkatësisht IEAA-ve mungojnë edhe specialistët e IT-së, të cilët do të kujdeseshin për mirëmbajtjen e pajisjeve teknologjike që gjenden nëpër IEAA.

Prandaj, me qëllim që vendi të ecë sa më shpejt e sa më mirë në drejtim të digjitalizimit dhe përdorimit të teknologjisë digjitale në fushën e arsimit, vlerësohet se Kosova ka nevojë për krijimin e mekanizmave institucionalë që mundësojnë realizimin e digjitalizimit dhe përdorimin e teknologjisë në fushën e arsimit në mënyrë efektive dhe efikase.



## 4. Vizioni i Strategjisë

### Vizioni i SA:

Arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës, që zhvillon potencialin dhe kompetencat e individëve, si dhe inkurajon mësimin gjatë gjithë jetës, në përputhje me trendet e transformimit global

Arsimi është identifikuar si mundësi dhe burim i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të Kosovës. Arsimi është sektor kyç në SKZH 2030, ku synohet përmirësimi i qasjes dhe cilësisë në arsim. Ndërlidhja e SA me SKZH 2030 është reflektuar edhe në vizionin e SA, si dhe përgjatë dokumentit.

Vizioni i Strategjisë së Arsimit, vë në pah zhvillimin e një sistemi arsimor cilësor dhe gjithëpërfshirës duke siguruar qasje dhe pjesëmarrje të barabartë në arsim për të gjithë fëmijët, nxënësit dhe studentët. Sigurimi i cilësisë në institucionet edukative dhe arsimore, përmirësimi i mësimdhënies, mësimnxënies dhe punës edukative-arsimore, janë pjesë përbërëse e SA. Prandaj, përmirësimi i performancës organizative, përmirësimi i formave të menaxhimit në arsim dhe ndërtimi i një sistemi të përgjegjësive dhe llogaridhënies në të gjitha nivelet e arsimit, janë parakusht për cilësi në arsim.

Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror i vendit, bazohet në mundësitë e krijuara për zhvillimin e potencialit të plotë dhe kompetencave të nevojshme të individëve. Këto mundësi ofrohen përmes një sistemi arsimor i cili inkurajon të mësuarit gjatë gjithë jetës, duke filluar nga edukimi në fëmijërinë e hershme, e duke mbuluar të gjitha format e të mësuarit: formal, joformal dhe informal. Krijimi i mundësive për mësim gjatë gjithë jetës përfshihet edhe në objektivin për zhvillim të qëndrueshëm 4 (OZHQ4) të Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Përshtatja dhe zhvillimi i arsimit për të përgatitur individ të gatshëm për përfshirje në tregun e punës, në përputhje me trendet e transformimit global, kontribuon në përmirësimin e mirëqenies individuale dhe asaj kolektive. Prandaj, SA parashihet përmirësimin e infrastrukturës dhe shfrytëzimit efektiv të teknologjive digjitale në funksion të zhvillimit të kompetencës digjitale tek të gjitha kategoritë e shfrytëzuesve të teknologjisë digjitale, përfshirë: fëmijët, nxënësit, studentët, mësimdhënësit, administratorët e arsimit dhe prindërit.

Ngritja e cilësisë dhe integritet në arsimin e lartë, në pajtim me standardet ndërkombëtare të cilësisë, duke ndërlidhur programet e arsimit të lartë me tregun e punës dhe përmirësimin e mjedisit për kërkime shkencore do të kontribuon në integrimin e Kosovës në hapësirën kërkimore evropiane.

Gjithashtu, duhet theksuar se edhe ndërlidhja e sportit me edukim dhe jetë të shëndetshme është vlerësuar si çështje shumë e rëndësishme. Kjo ndërlidhje do të bëhet me dokumentet tjera strategjike të ministrive përkatëse të këtyre fushave, ashtu siç është paraparë edhe në Qëllimin Strategjik 7 'Shoqëri aktive dhe krijuese'.

## 5. Objektivat

Strategjia e Arsimit 2022-2026, ka 5 objektiva strategjike, të përcaktuara për 5 fushat prioritare. Secili objektiv strategjik adreson problemin kyç të fushës prioritare përkatëse. Objektivat strategjike të SA janë të ndërlidhura me objektivat specifike të SKZH 2030 sipas Kornizës për Planifikim dhe Menaxhim Strategjik (KPMS) për të krijuar hierarki të zbatimit dhe raportimit.

Objektivat strategjike janë zbërthyer në objektiva specifike të cilat korrespondojnë me shkaqet kryesore të problemeve kyçe përkatëse dhe synojnë rezultate më konkrete në perspektivën afatshkurtër.

Për secilin objektiv specifik janë përcaktuar aktivitetet që çojnë në arritjen e objektivit.

Secili objektiv strategjik dhe specifik shoqërohet me të paktën një tregues që shërben për përcjellje të procesit dhe të suksesit. Treguesit e përzgjedhur për të monitoruar zbatimin e SA janë të ndërlidhur me treguesit për monitorimin e SKZH 2030. Për më tepër, synimet përfundimtare (2026) në SA janë të ndërlidhura me synimet e ndërmjetme në SKZH 2030, për të siguruar ndërlidhje të zbatimit dhe arritjes së objektivave.

Treguesit e ndërlidhur me aktivitete identifikojnë produktet e drejtpërdrejta të atyre aktiviteteve.

Treguesit e rezultateve korrespondojnë me objektiva specifike dhe paraqesin efektet afatshkurtra të grupit të aktiviteteve të ndërlidhura me objektivin përkatës.

Ndërkaq, treguesit e ndikimit (impaktit) kanë të bëjnë me efektet e përgjithshme dhe afatgjatë të arritjes së rezultateve specifike.

Në pjesën vijuese është prezentuar ndërlidhja në mes të problemeve kyçe dhe objektivave strategjike, ndërkaq, elementet tjera janë trajtuar në seksionin vijues ku objektivat strategjike, specifike dhe aktivitetet janë paraqitur në formë narrative.

**Skema 1:** Problemet kyçe dhe objektivat strategjike

<b>Fusha 1: Edukimi në fëmijërinë e hershme</b>	
<b>Problemi kyç:</b>	<b>Objektivi i përgjithshëm:</b>
Përfshirje dhe pjesëmarrje e ulët e të gjithë fëmijëve në EFH dhe shërbime jo adekuate për të siguruar qasje dhe mundësi të barabarta.	Rritje e përfshirjes dhe qasje e barabartë në edukimin në fëmijërinë e hershme.
<b>Fusha 2: Arsimi parauniversitar</b>	
<b>Problemi kyç:</b>	<b>Objektivi i përgjithshëm:</b>
Cilësi e ulët e arsimit parauniversitar për shkak të moskonsolidimit të mekanizmave për sigurim të cilësisë dhe mësimdhënie efektive.	Ngritja e cilësisë së arsimit parauniversitar përmes konsolidimit të mekanizmave për sigurim të cilësisë dhe ofrimit të mësimdhënies cilësore.
<b>Fusha 3: Arsimi, Aftësimi Profesional dhe Arsimi për të Rritur</b>	
<b>Problemi kyç:</b>	<b>Objektivi i përgjithshëm:</b>
Mospërputhja e shkathtësive ndërmjet ofertës arsimore me ndryshimet e tregut të punës dhe mundësitë e pamjaftueshme për mësim gjatë gjithë jetës.	Harmonizimi i arsimit dhe aftësimin profesional me zhvillimet dinamike të teknologjisë dhe tregut të punës, në funksion të mësimin gjatë gjithë jetës.
<b>Fusha 4: Arsimi i Lartë</b>	
<b>Problemi kyç:</b>	<b>Objektivi i përgjithshëm:</b>
Cilësi e pamjaftueshme në arsimin e lartë, kapacitete të kufizuara për trajtim të aspekteve të etikës dhe integritetit akademik, mungesë e të dhënave për arsimin e lartë dhe kërkime-shkencore, ndërlikime të ulët e programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës, mundësi të kufizuara për punë praktike të studentëve, mobilitet i kufizuar i stafit akademik dhe studentëve, si dhe pjesëmarrje e ulët në programet ndërkombëtare për arsim të lartë dhe kërkime shkencore.	Përmirësimi i cilësisë, integritetit dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë.
<b>Fusha 5: Digjitalizimi i arsimit</b>	
<b>Problemi kyç:</b>	<b>Objektivi i përgjithshëm:</b>
Shërbime të pakta digjitale dhe nivel i ulët i përdorimit të teknologjisë digjitale për arsim cilësor.	Përdorimi i teknologjisë digjitale për përmirësimin e shërbimeve dhe të cilësisë në arsim, në përputhje me trendet e transformimit digjital.

## 5.1. Objektivi strategjik 1 – Edukimi në fëmijërinë e hershme

### Objektivi strategjik 1:

#### Rritje e përfshirjes dhe qasje e barabartë në edukimin në fëmijërinë e hershme

Edukimi në Fëmijërinë e Hershme, synon zhvillimin parësor të nevojave shoqërore, emocionale, njohëse dhe fizike të një fëmije, në mënyrë që të ndërtojë një bazë të fortë dhe të gjerë për të mësuarit dhe mirëqenien gjatë gjithë jetës, prandaj përfshirja dhe pjesëmarrja e barabartë për të gjithë fëmijët në edukimin parashkollor nuk mund të realizohet pa krijimin e infrastrukturës adekuate. Nevojitet që MASHTI të bëjë një analizë të mirëfilltë të shërbimeve dhe investimeve në EFH, ashtu që të planifikoj tejkalimin e sfidave me të cilat përballlet edukimi parashkollor, siç janë: rritja e numrit të institucioneve parashkollore (IP) dhe organizimi i shpërndarjes adekuate të tyre; zhvillimi i kornizës legjislative, kurrikulës për EFH dhe krijimi i ambientit edukativ cilësor; krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për moshën e fëmijëve; si dhe koordinimi ndërsektorial për ofrimin e shërbimeve cilësore në EFH.

Cilësia në EFH, synohet të arrihet përmes kompletimit të legjislacionit, krijimit të një sistemi të qëndrueshëm të vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm si dhe ngritjes/zhvillimit të kapaciteteve njerëzore në këtë nivel.

Spektori i EFH është i ndërlidhur ngushtë me shërbimet e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, integrimi i këtyre shërbimeve mundëson sigurimin e shfrytëzimit efikas të resurseve si dhe mbledhjen, analizën dhe vlerësimin e të dhënave për të mundësuar zhvillim dhe arritje të potencialit të plotë të fëmijëve. Për të arritur të gjitha këto synime, vetëdija shoqërore për rëndësinë e EFH, duhet të jetë shumë më e lartë.

### Objektivi specifik 1.1:

#### Krijimi i mjediseve të shëndetshme me kushte adekuate për EFH dhe sigurimi i resurseve njerëzore

Për të rritur qasjen dhe përfshirjen në edukim parashkollor nevojitet një analizë e situatës për përshtatjen e hapësirave ekzistuese të shkollave në kopshte dhe ndërtimin e objekteve të reja për shërbime të EFH, të cilat do të shpërndahen në lokacionet e përcaktuara me prioritet.

Kjo organizohet përmes një plani kombëtar për investime kapitale, i cili po ashtu do të mundësonte edhe angazhimin e stafit të ri për institucionet e reja apo të adaptuara, si dhe angazhimin e edukatorëve mbështetës dhe asistentëve për fëmijët me aftësi të kufizuara, e që mungesa e tyre e vështirëson përfshirjen e kësaj kategorie në EFH.

Është planifikuar një analizë e mirëfilltë e kostos të formave aktuale të shërbimeve të EFH. Kjo analizë ka për qëllim identifikimin e qasjes relevante në zhvillimin e politikave për format e përkrahjes më të përshtatshme të shërbimeve jopublike të IP, Për IP private, si ofruarit më të mëdhenj të shërbimeve parashkollore, është e domosdoshme të parashihen forma të përkrahjes si në procesin e licencimit, po ashtu edhe në përkrahjen e zhvillimit të kapaciteteve profesionale. Një formë tjetër që ndikon në rritjen dhe përfshirjen e fëmijëve parashkollor është modaliteti i kopshteve me bazë në komunitet, të cilat mund të shihen si forma alternative që do të kontribuonin në përfshirjen e një numri të konsiderueshëm të fëmijëve.

Fëmijët e cenueshëm si kategori e ndjeshme e shoqërisë, është e domosdoshme të trajtohen me prioritet ashtu që të mundësohen forma lehtësime siç janë qasjet e përshtatshme fizike apo sigurimi i pajisjeve të përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuara. Po ashtu, monitorimi i vazhdueshëm i politikave lehtësuese për regjistrimin e fëmijëve nga grupet e cenueshme e sidomos të fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, të cilët janë gati të pa përfaqësuar në IP, është zgjidhje për t'u siguruar se këta fëmijë i kemi të integruar në sistemin edukativ.

### Objektivi specifik 1.2:

#### Përmirësimi i infrastrukturës ligjore dhe ofrimi i shërbimeve cilësore në EFH

MASHTI është në proces të rishikimit të legjislacionit primar dhe sekondar për EFH. Gjithashtu, Kurrikula Bërthamë për nivelin 0 është në fazën e zhvillimit. Përveç tjerash, me këtë legjislacion synohet zhvillimi i mekanizmave të nevojshëm për sigurimin e cilësisë së shërbimeve të EFH. Prioritet tjetër mbetet krijimi i një sistemi të qëndrueshëm të vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm, që kërkon profilizimin e inspektorëve dhe zyrtarëve për këtë nivel si dhe ngritjen e kapaciteteve udhëheqëse të IP përmes një programi të mirëfilltë të menaxhimit efektiv të procesit edukativ në IP si dhe angazhimi i bashkëpunëtorëve profesional.

Edukimi parashkollor duhet të plotësoj edhe normat ndërkombëtare për këtë moshë, sidomos në pajisjet me inventar, lodra dhe mjete tjera edukative të cilat nevojitet të standardizohen me një dokument i cili përcakton kriteret për to. Po ashtu, hapësirat të cilat ofrojnë shërbime të EFH duhen të pajisen rregullisht me inventar dhe pajisje të përshtatshme për moshat e vogla.

Një parakusht tjetër për zhvillim të cilësisë është edhe zhvillimi i kurrikulës dhe ngritja e kapaciteteve profesionale për realizimin e kërkesave të saj. Për këtë nevojiten trajnime adekuate, të cilat fillimisht duhet të pilotohen dhe vlerësohen, para se të prezantohet kurrikula e EFH në nivel vendi. Këtë duhet ta pasojë edhe harmonizimi i programeve ekzistuese për zhvillimin profesional të edukatorëve, të cilët nevojitet të përshtaten me elementet e kurrikulës së re për EFH. Procesi i vlerësimit të performancës së edukatorëve është më se i domosdoshëm për të siguruar cilësi në EFH. Prandaj, edukatorët duhet të kuptojnë dhe njihen mirë me kompetencat e tyre përmes një programi i cili do të ndihmonte zhvillimin e kapaciteteve të tyre. I domosdoshëm është edhe rishikimi i dokumentacionit pedagogjik, i cili për t'ju përshtatur kërkesave të kohës duhet të digjitalizohet dhe të zhvillohet një sistem mirë të organizuar.

Niveli i edukimit për moshat 0-2 mbetet segmenti më i pa zhvilluar në edukimin parafillor. Ende në IP janë të punësuara edukatore të cilat nuk kanë zhvillim akademik. Prandaj, hartimi dhe zbatimi i një programi për riaftësimin e tyre është i domosdoshëm për të zhvilluar kapacitetet e tyre profesionale.

I gjithë personeli i IP parashihet të avancohet me programe aktuale në mënyrë që të ndihmojnë në zhvillimin dhe mirëqenien tërësore të çdo fëmije si dhe të theksohet roli i tyre në këto procese. Aftësimi do të fokusohet në disa tema, siç janë: mbrojtja e fëmijëve, gjithëpërfshirja, reagimi ndaj emergjencave, barazia gjinore, të ushqyerit e shëndetshëm. Këto arrihen përmes hartimit dhe zbatimit të udhëzuesve dhe trajnimeve me përmbajtje të përshtatura për moshën e parashkollorëve.

Për t'u mundësuar fëmijëve një zhvillim dhe edukim sa më cilësor, të gjithë ofruesit e shërbimeve parashkollorë duhet rregullisht t'u ofrohet pajisa me libra dhe mjete didaktike adekuate për grupmosha të caktuara.

Edukimi në distancë e që u dëshmuua shumë i nevojshëm sidomos me paraqitjen e pandemisë Covid 19, krijoji mundësi për profesionistët dhe prindërit të informohen vazhdueshëm, andaj platformat e tilla mundësojnë marrjen e shërbimeve dhe ndër vite duhet të organizohet mirëmbajtja e tyre e rregullt në të gjitha gjuhët.

**Objektivi specifik 1.3:**

Ofrimi i mundësive të zhvillimit dhe arritjes së potencialit të plotë të fëmijëve, përmes shërbimeve të integruara ndërsektoriale

Zhvillimi i mirëfilltë i fëmijëve dhe arritja e potencialit të plotë të tyre kërkon edhe krijimin e mekanizmave bashkëpunues mes MASHTI, MSH, MFTP dhe Asociacionin e Komunave, prandaj është i domosdoshëm krijimi i grupeve ndërsektoriale si në nivel qendror, po ashtu edhe në nivel lokal, e që rregullohet me një plan të veprimit. Deri tani nuk ka ekzistuar ndonjë sistem i grumbullimit të të dhënave për fëmijë nga ministritë përkatëse, prandaj MASHTI duhet të inicioj rregullimin e këtij sistemi, përmes bashkëpunimit ndërministror si dhe aftësimin e personave përgjegjës në të gjitha ministritë përkatëse, për dokumentimin e të dhënave dhe integrimin e tyre në një sistem të unifikuar digjital. Po ashtu, kërkohet krijimi dhe vëzhgimi i zbatimit të politikave kombëtare për profesionistë të cilët janë të angazhuar në EFH për të gjitha sektorët, e që monitorohen përmes bashkëpunimit ndërsektorial dhe njohës të formave të zhvillimit profesional nga ministritë përkatëse.

Është e domosdoshme që bashkëpunimet të ndodhin në të gjitha nivelet, prandaj kërkohet fuqizimi i rrjetëzimeve në nivel institucionesh apo stafit përgjegjës, që do të mundësonte zhvillimin e kapaciteteve njerëzore si dhe synimin për ngritjen e cilësisë. Edhe Komiteti Këshillëdhënës për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme (KKEFH) i përbërë nga institucione, agjenci, organizata dhe profesionistë të ndryshëm si dhe Kolegjiumi i drejtorëve, synohet të fuqizohen dhe të jenë më aktiv, si mekanizma që shërbejnë për koordinim të investimeve të aktiviteteve dhe projekteve.

Një kategori e madhe e fëmijëve, sidomos në zonat urbane përkujdesjen ditore e marrin nga dadot, të cilat kryesisht janë të pakualifikuara. Prandaj, është më se e nevojshme që të krijohet politikë për përcaktimin e kritereve për dado si dhe aftësimi i tyre përmes programit të dedikuar për to, e i cili ngërthen në vete, shëndetin, mirëqenien dhe edukimin e fëmijëve.

**Objektivi specifik 1.4:**

Ngritja e vetëdijes shoqërore për zhvillimin në fëmijërinë e hershme

Me qëllim të rritjes së vetëdijes shoqërore për rëndësinë e zhvillimit në EFH, nevojitet organizimi i konferencave dhe fushatave që do të hapnin diskutime në nivel qendror dhe lokal e që lehtëson krijimin e mundësive për përfshirjen aktive të shoqërisë.

Derisa ende ka një numër tejet të madh të prindërve, fëmijët e të cilëve nuk janë të përfshirë në ndonjë formë të EFH, sidomos nga zonat rurale, është obligim të investohet në informimin e tyre përmes programeve të ndryshme vetëdijesuese të prindërimit dhe pakove të cilat lehtësojnë kujdesin dhe edukimin në ambiente të shtëpisë. Krijimi i mundësive të informimit përmes mediave, broshurave dhe formave tjera informative, ndihmon ndërgjegjësimin e komunitetit të gjerë rreth rëndësisë së zhvillimit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme. Po ashtu, prindërit e fëmijëve të cenueshëm, respektivisht fëmijëve nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, mbesin ende të painformuar për mundësitë që politikatat e MASHTI ua mundësojnë për regjistrimin e fëmijëve të tyre në IP, prandaj organizimi i ngjarjeve, vetëdijesimi për këtë kategori shihet si i domosdoshëm.

Një çështje me të cilën po përballlet EFH dhe në këtë drejtim ka të bëjë shumë edhe tradita shoqërore, është krijimi i bindjes se studimet e EFH janë vetëm për gratë, prandaj si shoqëri duhet të vetëdijesojmë burrat për rëndësinë dhe mundësitë e krijimit të karrierës në EFH.

**Treguesit e ndikimit:**

- Përqindja e përfshirjes së fëmijëve në EFH (grup-mosha 0 deri në 5), e ndarë në baza gjinore

**Treguesit e rezultateve:**

- Përqindja e përfshirjes së fëmijëve 0-4, e ndarë në baza gjinore
- Përqindja e përfshirjes së fëmijëve në nivelin parafillor, e ndarë në baza gjinore
- Përqindja e përfshirjes së fëmijëve 3-5, e ndarë në baza gjinore
- Përqindja e përfshirjes së fëmijëve 0-2, e ndarë në baza gjinore
- Infrastruktura ligjore e plotësuar (Ligji për EFH, aktet nënligjore, Kurrikula për EFH)
- Dokumenti i Kornizës për vlerësim, me dokumentacionin përcjellës i hartuar dhe i miratuar
- Mekanizmat ndërsektorial për EFH në nivel qendror dhe lokal janë funksionale
- Funksionalizimi i mekanizmave raportues në SMIA
- Mekanizmi për përfshirjen e palëve me interes në aktivitete vetëdijësuese për EFH është funksional.

## 5.2. Objektivi strategjik 2 – arsimit parauniversitar

**Objektivi strategjik 2:**

*Ngritja e cilësisë së arsimit parauniversitar përmes konsolidimit të mekanizmave për sigurim të cilësisë dhe ofrimit të mësimdhënies cilësore*

Cilësia në arsimin parauniversitar në Kosovë, me gjithë punën dhe përpjekjet që janë bërë deri më tani, ende nuk është në nivelin e duhur. Dëshmi për këtë janë rezultatet e testit ndërkombëtar PISA që mat aftësinë e 15-vjeçarëve për zbatimin e njohurive në praktikë. Ky test në vitin 2015 dhe 2018 e radhiti Kosovën në mesin e tri vendeve të fundit pjesëmarrëse.

Për të ngritur cilësinë në arsimin parauniversitar është e domosdoshme të kemi një sistem i cili ofron llogaridhënie në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit. Për këtë qëllim duhet të kemi një menaxhim efektiv dhe efikas përmes zbatimit dhe avancimit të politikave dhe kornizës ligjore në fushën e arsimit, ngritjes së kapaciteteve dhe forcimit të transparencës dhe llogaridhënies. Për më shumë duhet fuqizuar mekanizmat për zbatimin e sistemit për sigurimin e cilësisë, vlerësim të brendshëm dhe të jashtëm të institucioneve arsimore me fokus në ngritjen e cilësisë si dhe rritjen e besueshmërisë së testeve kombëtare dhe shfrytëzimin e rezultateve krahas atyre ndërkombëtare për vendimmarrje të bazuar në të dhëna.

Gjithashtu, përmes një sistemi efektiv të menaxhimit të infrastrukturës që siguron mjedise të shëndetshme, të sigurta dhe miqësore për nxënës do të përmirësohet cilësia e mësimdhënies në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit. Gjithashtu do të përmirësohet edhe përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta si dhe e pjesëtarëve të grupeve shoqërore të marginalizuara. Për këtë qëllim, është i nevojshëm një racionalizim i shpenzimeve përmes optimizimit të rrjeteve të shkollave që do të rriste buxhetin me fokus në një mësimdhënie cilësore.

Cilësia e arsimit parauniversitar nuk është e mundur pa zbatimin efektiv të kurrikulës, ashtu siç nuk është i mundur jetësimi i reformës kurrikulare pa një mekanizëm funksional për të udhëhequr, koordinuar dhe ngritur kapacitetet për zbatimin e kurrikulës. Për ngritjen e rezultateve të nxënësve, krahas masave tjera, nevojiten tekste cilësore dhe në përputhje me kurrikulën; mjete, materiale dhe burime mësimore alternative. Për të arritur këtë, MASHTI duhet të rregullojë bazën ligjore, ndërtojë mekanizmat dhe kapacitetet për zhvillimin dhe përdorimin e tyre në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënësve.

Në anën tjetër, cilësia e arsimit parauniversitar, mund të marrë drejtimin e duhur, atëherë kur sistemi siguron kualifikime adekuatë për mësimdhënësit e rinj, siguron zhvillim profesional të vazhdueshëm, informata kthyesë dhe ofron mbështetje për plotësimin e standardeve të mësimdhënies përmes vlerësimit të performancës së mësimdhënësve.

#### **Objektivi specifik 2.1:**

*Ngritje e efikasitetit dhe efektivitetit në menaxhim nëpërmjet forcimit të transparencës dhe llogaridhënies*

Në rrethanat kur sistemi i arsimit është i decentralizuar, përveç ekzistimit të autonomisë së plotë financiare dhe profesionale, avancimet në arsim varen kryesisht nga zhvillimi i kapaciteteve menaxhuese në nivelin qendror, komunal dhe të shkollës. Për të siguruar një menaxhim cilësor dhe efektiv në sistemin e arsimit parauniversitar, nevojitet zbatimi dhe harmonizimi i legjislacionit primar me atë sekondar.

Në nivel komunal, është i nevojshëm një ristrukturim i DKA-ve dhe ngritje të kapaciteteve. Për këtë qëllim është i nevojshëm hartimi i një udhëzuesi standard që do të përmbante rregulloret dhe ligjet ekzistuese e të reja që përcaktojnë fushëveprimin dhe punën e DKA-ve dhe fushat specifike të menaxhimit të sistemit të arsimit. Duhet gjithashtu të zhvillohen dhe fuqizohen mekanizma për komunikim dhe koordinim efektiv midis palëve të interesit të niveleve të ndryshme në sistem përmes raportimit dhe proceseve koordinuese.

Për një menaxhim profesional dhe të përgjegjshëm të shkollave duhet të sigurohet rekrutimi i drejtorëve/zv. drejtorëve të shkollave, personelit drejtues në bazë të standardeve profesionale, i bazuar në vlerësim të performancës dhe në barazi gjinore. Duhet ofruar gjithashtu përfshirje pa dallim gjinie në programet e zhvillimit profesional të drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe mësimdhënësve që synojnë karrierë menaxhimi. Duhet të fuqizohet menaxhmenti i mesëm përmes fuqizimit të rolit të Këshillit drejtues dhe Këshillit të Prindërve dhe rolit më aktiv të tyre në përmirësim të vazhdueshëm në shkolla. Ndarja e përvajës së mirë me komunitetet e të mësuarit së bashku do të ndihmonte në shkëmbimin e përvojave dhe rritjen e performancës në shkolla.

Racionalizimi i shpenzimeve përmes rishikimit dhe zbatimit të mirëfilltë të formulës së financimit i bazuar në riorganizim të shkollave duke marrë parasysh të dhënat mbi gjendjen infrastrukturorë dhe trendet demografike në vend për të përcaktuar modelin më efektiv të menaxhimit të rrjetit të shkollave. Kjo kërkon ngritje të kapaciteteve në shkolla dhe DKA për menaxhim financiar dhe hartimin e udhëzimeve për menaxhim financiar.

Rëndësi të veçantë ka edhe shfrytëzimi i raporteve për sistemin arsimor nga sektorët përkatës për politikëbërje dhe vendimmarrje.

#### **Objektivi specifik 2.2:**

*Fuqizimi i mekanizmave dhe kapaciteteve për zbatimin e sistemit për sigurimin e cilësisë*

Sigurimi i cilësisë është një ndër pikat më të dobëta të arsimit parauniversitar në Kosovë. Për ta funksionalizuar sistemin për sigurim të cilësisë është i domosdoshëm ndërtimi i kapaciteteve në të gjitha nivelet. Numri i kufizuar i inspektorëve ka paraqitur sfida të vazhdueshme që të realizohen vlerësimet e jashtme dhe të brendshme në funksion të përmirësimit të procesit mësimor. Prandaj, planifikohet jo vetëm rritja e kapaciteteve për inspektime dhe monitorime, por edhe përgatitja dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional i inspektorëve. Mbështetje këtij procesi do t'i ofrohet përmes



krijimit të ekipeve profesionale por edhe fuqizimit të rolit të aktiveve shkollore dhe koordinatorëve të cilësisë në shkolla, komuna dhe MASHTI.

Planet zhvillimore komunale të arsimit duhet të jenë një linjë me planet zhvillimore shkollore në pajtim me fushat e cilësisë. Përveç kësaj, çdo plan komunal i arsimit duhet të reflektojë prioritetet e zhvillimit në kuadër të komunës, dhe si i tillë, të shërbejë si bazë për zhvillimin e ardhshëm të planeve shkollore.

Për më tepër, do të jenë të nevojshme edhe aktivitetet e vetëdijesimit të bazuara në studime të ndryshme për performancën e sistemit arsimor që do të krijonin një mjedis ku promovohet llogaridhënia. Në këtë drejtim, një pasqyrë e performancës së shkollës përmes Kartave Raportuese të Shkollës do të mundësonte të dhëna të besueshme dhe monitorimin e progresit më transparent dhe efektiv të shkollave jo vetëm nga shkollat por edhe nga komuniteti.

### **Objektivi specifik 2.3:**

Rritja e përfshirjes dhe pjesëmarrjes aktive të nxënësve nga grupet e marginalizuara përmes krijimit të klimës nxitëse dhe përkrahëse

Rritja e përfshirjes dhe pjesëmarrjes aktive të nxënësve nga grupet e marginalizuara do të synohet përmes krijimit të një klime nxitëse dhe përkrahëse. Në këtë drejtim, planifikohen shërbimet mbështetëse për nxënësit që kanë vështirësi në mësim. Për nxënësit me aftësi të kufizuara duhet që çdo komunë të formojë dhe funksionalizojë ekipet profesionale (ekipet vlerësuese pedagogjike), por edhe të sigurojë mësimdhënës mbështetës dhe asistentë të cilët janë të domosdoshëm për përkrahje të këtyre fëmijëve por edhe për fëmijët që kanë vështirësi në arritjen e rezultateve të të nxënësve në fusha të ndryshme.

Braktisja është një çështje e cila sfidohet sidomos në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian e në veçanti për vajza por edhe te fëmijët/nxënësit me status të ulët socio-ekonomik dhe për këtë qëllim nevojiten masa për parandalim dhe reagim efektiv dhe mbështetje, por edhe ndërgjegjësim për palët e interesit dhe prindër.

Për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian, duke u bazuar edhe në strategjinë për këtë çështje, është planifikuar mbështetje për arsimin e mesëm përmes ofrimit të bursave për nxënësit, por edhe mbështetje për qendrat mësimore, harmonizim të programeve si dhe zgjerim të mësimin të gjuhës rome në nivel vendi.

Do të ofrohet mbështetje për identifikimin dhe përkrahjen e nxënësve me aftësi të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente të veçanta, duke i mbështetur mes tjerash edhe organizatat e ndryshme. Do të organizohen gara kombëtare dhe ndërkombëtare dhe do të ofrohen shpërblime të ndryshme jo vetëm monetare por edhe mundësi tjera jo monetare.

Gjithashtu një aspekt i rëndësishëm i gjithëpërfshirjes është mbështetja për fëmijët e riatdhesuar dhe të huaj, fillimisht me një sistemim të duhur të tyre dhe ofrimin e programeve për mësim të përsheptuar por edhe monitorim të aktiviteteve të parapara si dhe përgatitje e mësimdhënësve dhe zyrtarëve të DKA-ve që të njihen me proceset dhe përgjegjësitë e tyre lidhur me këta fëmijë. Gjithashtu, duhet të përkrahjet sistemi për organizimin dhe mbarëvajtjen e mësimin në diasporë.

**Objektivi specifik 2.4:**

Sigurimi i mjediseve shkollore të shëndetshme, të sigurta dhe të përshtatshme sipas normave dhe standardeve, që mundësojnë mësim cilësor

Nga këndvështrimi infrastrukturor prioritet do të konsiderohet sigurimi dhe mirëmbajtja e hapësirës së mjaftueshme funksionale dhe mjedisit të sigurt dhe të shëndetshëm, i cili do të arrihet jo vetëm përmes renovimit dhe ndërtimit të objekteve të reja shkollore, por edhe pajisjes së shkollave me inventar adekuat duke ofruar kështu kushte për mësim cilësor dhe gjithëpërfshirës në shkolla.

Kjo infrastrukturë duhet të ketë parasysh normat e zbatueshme për infrastrukturën edukative-arsimore dhe të përshtatet për qasjen e nxënësve me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, shkollat duhet të kenë hapësirat për punë laboratorike dhe kabinete, salla të edukatës fizike që mundësojnë zhvillim fizik dhe shëndetësor, kënde pushuese dhe rekreative për nxënës si dhe biblioteka të pasuruara me literaturë adekuate.

Identifikimi i lokacioneve për ndërtimin e shkollave të reja duhet të bëhet duke u bazuar në vlerësimet e nevojave dhe sipas normave dhe standardeve të zbatueshme dhe ndryshimeve të pritshme demografike.

Duhet të krijohen mekanizma për promovim të komponentës së shëndetit në nivel komunal dhe në nivel shkolle si dhe themelimi i grupeve ndërsektoriale që kanë për qëllim promovimin e shëndetit në shkolla. Për më shumë, duhet të hartohen materiale për edukimin shëndetësor, përfshirë shëndetin seksual dhe riprodhues dhe mjedisin shkollor të shëndetshëm. Të analizohen nevojat për ujë të pijshëm dhe nyje sanitare si dhe zhvillohen mekanizma për mirëmbajtjen e tyre. Është i nevojshëm gjithashtu hartimi i një udhëzuesi për sigurinë dhe reagim në raste emergjente.

Duhet të planifikohen aktivitete që kontribuojnë në zbatimin e masave për parandalimin dhe raportimin e të gjitha formave të dhunës (fizike, psikologjike, seksuale, neglizhimin, ngacmimin seksual, shfrytëzimin), homofobisë, bullizmit, gjuhës së urrejtjes dhe ekstremizmit në shkolla. Po ashtu, aktivitete që ndërlidhen me obligimet e institucioneve arsimore për të identifikuar, referuar dhe mbështetur fëmijët, të cilët, potencialisht, janë viktimë të drejtpërdrejta të dhunës në shtëpitë e tyre, ose dëshmitarë të dhunës në familje, në shtëpitë e tyre.

**Objektivi specifik 2.5:**

Rritje e besueshmërisë së rezultateve të testeve kombëtare dhe shfrytëzimi i tyre për politikëbërje, krahas rezultateve të testeve ndërkombëtare

Mungesa e një Qendre për Vlerësim dhe Standarde ka rezultuar me kapacitete të pamjaftueshme dhe sfida në mbarëvajtjen e proceseve të mirëfillta të vlerësimeve kombëtare dhe analizës së rezultateve nga vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare. Prandaj, është i nevojshëm krijimi i kësaj Qendre përmes së cilës do të sigurohen kapacitete të mjaftueshme njerëzore që do të rrisë besueshmërinë e testeve kombëtare dhe shfrytëzimin e tyre për politikëbërje.

Duhet të merren masa adekuate për sigurimin e mbarëvajtjes së procesit të testimit, përfshirë ofrimin e sigurisë dhe transparencën e komplet procesit përmes trajnimit të administruesve dhe raportimeve nga ky proces që do të përmirësojnë cilësinë dhe besueshmërinë e testeve kombëtare.

Për të rritur cilësinë e kërkesave do të vazhdohet me ngritjen e kapaciteteve të hartuesve të kërkesave dhe do të krijohet banka e kërkesave me materiale ndihmëse me modele të llojeve të pyetjeve, me modele pyetjesh që masin njohuri dhe aftësi të ndryshme dhe me modele testesh për të gjitha lëndët.

Do të vazhdohet me pjesëmarrjen e Kosovës në vlerësimet ndërkombëtare PISA (fëmijët 15 vjeçarë), TIMSS dhe PIRLS (klasa IV) dhe do të fillohet edhe me vlerësim ICILS (klasa VIII) për aftësinë e nxënësve të klasës së 8-të për të përdorur teknologjinë informative (TIK). Gjithashtu planifikohet edhe një vlerësim/studim ndërkombëtar nga TALIS i që fokusohet te puna e mësimit dhe drejtorëve të shkollave ku punojnë, kushtet e tyre të punës, mundësitë e të mësuarit, praktikat mësimore dhe besimet rreth mësimit dhe të nxënësve.

Testet kombëtare, si testi i arritshmërisë dhe Matura, por dhe ato ndërkombëtare si PISA, TIMSS dhe PIRLS, shihen si instrumente të rëndësishme për sigurimin e cilësisë, pasi ofrojnë informacion sistematik për anomalitë e sistemit dhe kurrikulumit dhe si të tilla, duhet të shfrytëzohen për ndërmarrjen e hapave drejt evitimit të tyre.

#### **Objektivi specifik 2.6:**

Zbatimi efektiv i të gjitha elementeve të kurrikulës së arsimit parauniversitar

Mungesa e një mekanizmi profesional që udhëheq e koordinon zhvillimet e reformës kurrikulare dhe ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e kurrikulës, ka rezultuar me një qasje të fragmentuar, jo të koordinuar e pak të kontrolluar në aspektin cilësor e përmbajtjesor të zbatimit të të gjitha elementeve të kurrikulës. Marrë parasysh nevojën dhe rëndësinë e madhe që ka krijimi i një institucioni profesional, shtrohet nevoja që fillimisht të analizohen gjithë mekanizmat ekzistues të arsimit parauniversitar dhe të përgatitet një konceptdokument për rolin që mund të marrë IPK në këtë fushë. Në anën tjetër, për të adresuar kapacitetet e kufizuara njerëzore në nivel të DKA-ve për mbështetjen e shkollave dhe mësimit për zbatimin e kurrikulës, do të jetë e nevojshme të mbështeten DKA-të për të angazhuar e punësuar zyrtarë/këshilltarë pedagogjik me prioritet për fushat kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, Matematika dhe Shkencat e natyrës.

Në kuadër të kësaj strategjie, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet rishikimit të kurrikulave bazuar në analizën e gjendjes së zbatimit të tyre dhe kahet e zhvillimit në fushat përkatëse, si p.sh. zhvillimet e shpejta në fushën kurrikulare Jeta dhe puna, përkatësisht kurrikulën lëndore të TIK-ut, si dhe mbështetjes së duhur për mësimit të avancuar, përmirësim të praktikave të vlerësimit të nxënësve dhe përdorim të rezultateve në aktivitete përkrahëse për nxënës. Më tutje, do të përmirësohen dhe avancohen format e mbështetjes dhe aftësimin të mësimit dhe drejtorëve të shkollave për zbatimin e kurrikulës, si një prioritet i veçantë në kuadër të këtij objekti, si dhe do të fuqizohet bashkëpunimi ndërinstitucional dhe bashkëpunimi me prindër. Gjithashtu, do të fuqizohet mekanizmat për monitorim të vazhdueshëm të zbatimit të kurrikulës, me qëllim që me kohë të identifikohen sfidat dhe problemet dhe të merren masat e nevojshme për tejkalimin e tyre.

Kompensimin e humbjeve mësimore dhe zvogëlimin e pabarazive në mësim, si rezultat i pandemisë COVID 19, MASHTI do t'i adresojë në bashkëpunim me partnerët mbështetës, duke koordinuar zhvillimin dhe ofrimin e programeve shpesh për mbështetjen e nxënësve. Gjithashtu, do të zhvillohet një mekanizëm efektiv dhe i përshtatshëm në ndihmë shkollave për vlerësimin e humbjeve mësimore dhe sigurimin e mbështetjes afatgjate të nxënësve.

**Objektivi specifik 2.7:**

Sigurimi i teksteve shkollore cilësore, burimeve, mjeteve e materialeve mësimore në harmoni me kurrikulën dhe standardet përkatëse.

Zbatimi efektiv i kurrikulës së arsimit parauniversitar, ndër të tjera varet edhe nga cilësia e teksteve shkollore, materialeve e mjeteve mësimore, por edhe materialeve didaktike dhe profesionale për mësimdhënës. Me qëllim që të plotësohen kërkesat e sistemit në këtë fushë, MASHTI do t'u kushtojë vëmendje të veçantë të gjitha këtyre aspekteve fillimisht duke kompletuar Njësinë për tekstet shkollore dhe materialet mësimore në MASHTI, apo në kuadër të institucionit përgjegjës. Si masë shtesë do të jetë miratimi i ligjit për tekstet shkollore dhe aktet nënligjore që mundësojnë zbatimin efektiv të tij. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet ndërtimit të mekanizmave dhe të kapaciteteve për përgatitje cilësore të teksteve shkollore dhe materialeve mësimore, të shtypura dhe digjitale, në harmoni me kurrikulën dhe standardet përkatëse, përfshirë barazinë gjinore<sup>65</sup>, në gjuhët zyrtare, gjuhë të huaja, në gjuhët e komuniteteve jo shumicë si dhe për kategoritë e ndryshme të nxënësve me nevoja të veçanta.

Procesi i përdorimit të teksteve shkollore dhe materialeve mësimore do të mbështetet edhe me materiale profesionale dhe didaktike për mësimdhënës si dhe do të bëhet aftësimi i mësimdhënësve për përdorimin dhe zhvillimin e materialeve mësimore (të shtypura dhe digjitale). Krahas me këtë, do të punohet në përmirësimin e qasjes në tekste dhe burime e materiale mësimore, do të bëhet furnizimi i shkollave me pako mësimore minimale, e cila përcaktohet me një akt nënligjor dhe shoqërohet me udhëzime për përdorimin e saj.

Me qëllim rritjen e mundësive për përfshirjen aktive të shoqërisë, përfshirjen e nivelit akademik dhe të mësimdhënësve në zhvillimin e teksteve shkollore dhe prodhimin e materialeve mësimore, do të organizohen debate të vazhdueshme me përfshirje të gjerë. Gjithashtu, do të mbështetet organizimi i ngjarjeve me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar, me prodhues të materialeve mësimore të shtypura e digjitale. Organizimet e tilla do të planifikohen me kujdes që të jenë në funksion të arritjes së këtij objekti.

**Objektivi specifik 2.8:**

Zbatimi i plotë i sistemit të licencimit të mësimdhënësve dhe shtimi i mundësive për zhvillim dhe avancim profesional të mësimdhënësve bazuar në standardet e mësimdhënies

Një aspekt i rëndësishëm i strategjisë së arsimit është përqendrimi në zhvillimin e mësimdhënësve në karrierë, përmes zbatimit të sistemit të licencimit të mësimdhënësve, vlerësimit të performancës dhe avancimit në karrierë. Niveli aktual i zbatimit të sistemit të licencimit, nuk mundëson avancim profesional dhe gradim të mësimdhënësve në sistemin e karrierës. Për të siguruar përmirësimin e zbatimit të sistemit të licencimit të mësimdhënësve nevojitet gatishmëri dhe mbështetje nga MASHTI si dhe ndryshim i qasjes në zbatimin e këtij sistemi.

Fillimisht, MASHTI do të analizojë mundësitë e zbatimit të plotë të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve. Pastaj, do të zhvillohet një koncept për të ardhmen e sistemit të licencimit të mësimdhënësve duke plotësuar edhe bazën e nevojshme ligjore. Funkcionalizimi i softuerit për bazën e të dhënave të sistemit të licencimit, rishikimi i kornizës strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve duke u bazuar në dokumentet e BE-së për mbështetjen e zhvillimit të kompetencave të mësimdhënësve, zbatimi i Ligjit për profesionet e rregulluara si dhe ndërtimi i një programi hyrës për mësimdhënësit fillestarë dhe përgatitja dhe pjesëmarrja e sistemit në vlerësimin/studimin ndërkombëtar për mësimdhënës – TALIS, janë disa nga aktivitetet me rëndësi të MASHTI-t për këtë fushë të intervenimit.

65 [https://abj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/ALB-Manual%20SteriotipetGjinore-ALB\(1\).pdf](https://abj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/ALB-Manual%20SteriotipetGjinore-ALB(1).pdf)

Ndërtimi i mekanizmit të financimit të ZHPM dhe sigurimi i mjeteve të nevojshme buxhetore për të ndërlidhur sistemin e licencimit të mësimit me sistemin e pagave, është masë tjetër të cilën MASHTI do ta adresojë e rregullojë.

Rritja e profesionalizimit të mësimit si prioritet e udhëheq gjithë angazhimin institucional në kuadër të aktiviteteve për ZHPM. MASHTI do të përcaktojë fushat dhe programet prioritare për aftësimin profesional të mësimit duke ofruar trajnime dhe udhëzues të bazuar në standardet për mësimit dhe në harmoni me filozofinë e kurrikulës së bazuar në kompetenca. Mbështetja e zbatimit të procedurave për zhvillim profesional të mësimit me bazë në shkollë, krijimi dhe mbështetja e rrjeteve profesionale dhe qendrave për ngritje profesionale në nivel komune, promovimi i zhvillimit të mësimit në karrierë, mbështetja e shkollave për pjesëmarrje në projektet Erasmus + që lidhen me trajnimin e mësimit si dhe nxitja e mësimit për krijimin e shoqatave të mësimit janë masa me rëndësi për MASHTI-n. Këto masa duhet të mbështeten me ngritjen e kapaciteteve të DKA-ve dhe drejtorëve të shkollave, planifikim dhe koordinim më të mirë në mes të institucioneve arsimore dhe partnerëve mbështetës në këtë fushë dhe përmes instrumentit për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e zbatimit të programeve për ZHPM të miratuara nga MASHTI.

#### **Objektivi specifik 2.9:**

*Përgatitja cilësore e mësimit para shërbimit të cilët iu përshtaten me kompetencë kërkesave të kurrikulës dhe nevojave praktike të punës me fëmijë/nxënës*

Përgatitja e mësimit para shërbimit për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, përfshirë edhe mësimit e shkollave profesionale, bëhet nga institucionet publike të arsimit të lartë. Edhe pse roli i MASHTI-t dhe fakulteteve që përgatisin mësimit është i rregulluar me legjislacionin përkatës, është shtruar nevoja që të bëhet një analizë e zbatimit të atyre politikave si dhe të shqyrtohen e bashkërendohen veprimet e MASHTI-t dhe Fakulteteve, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së politikave dhe programeve për përgatitjen dhe zhvillimin e mësimit.

Fakultetet që përgatisin mësimit, do t'i harmonizojnë programet/kurrikulat me standardet për mësimit dhe me filozofinë e kurrikulës që ofrohet në arsimin parauniversitar (nivelet përkatëse). Këtë proces do ta mbikëqyrë MASHTI përmes KSHLM dhe AAK. Krahas me harmonizimin e programeve/kurrikulave, fakultetet përkatëse do t'i kushtojnë vëmendje të veçantë ngritjes së kapaciteteve të stafit akademik për përmirësimin e praktikave të mësimit, zhvillimin e profesionalizimit, lidhjen e punës shkencore me sistemin e arsimit – arsimin parauniversitar dhe promovimin e punës hulumtuese në fushën e edukimit.

Gjithashtu, fakultetet që përgatisin mësimit do të ndërmarrin masa të veçanta për të avancuar pjesën praktike të studimit për ta bërë më relevante profesionin e mësimit dhe përgatitjen për hyrje në profesion duke siguruar mentorimin e vazhdueshëm gjatë praktikës profesionale të studentëve, krijimin e laboratorëve praktikë ku studentët do të aftësohen për punë praktike, zhvillimin e materialeve mësimore, demonstrimin dhe përdorimin e tyre, etj. Në ndërlidhje me këtë, do të sigurohet bashkëpunimi me shkollat dhe komunat si dhe bashkëpunimi me zyrën e projektit Erasmus+. Ky bashkëpunim do të ofrojë mundësi për përfshirje në programet e mobilitetit për mësimit të ardhshëm, si dhe do të promovohet puna hulumtuese në fushën e edukimit. Përgatitja e mësimit para shërbimit bëhet nga institucionet e arsimit të lartë, prandaj ky proces, domosdoshmërisht ndërlidhet edhe me objektivin strategjik për arsimin e lartë.

**Objektivi specifik 2.10:****Promovimi i multikulturalizmit dhe diversitetit në arsimin parauniversitar**

Niveli i pamjaftueshëm i trajtimit të çështjeve të ndërlidhura me multikulturalizmin dhe diversitetin në arsimin parauniversitar, ka ndikuar në rritjen e pabarazive në arsimin parauniversitar. Prandaj, adresimi dhe promovimi i këtyre aspekteve përmes ndërtimit të mekanizmave efektiv, ngritjes së kapaciteteve dhe sigurimin e resurseve relevante është më se i nevojshëm.

Fillimisht do të hartohen programe e module për komunitetet në lëndë kombëtare. Gjithashtu, do të planifikohen dhe ofrohen mundësi për mësimin e gjuhës rome përmes mësimin plotësues dhe formave tjera alternative, në shkolla të rregullta dhe në qendrat mësimore.

Programet dhe aktivitetet e të mësuarit të gjuhës shqipe për komunitetet pakicë do të mbështetet me materiale mësimore përkatëse mësimore dhe me mbështetje profesionale për shkollat ku ofrohen këto mundësi. Socializimi në mes të nxënësve të komuniteteve të ndryshme në shkollat multietnike do të mundësohet përmes themelimit dhe funksionalizimit të klubeve të ndryshme, mësimin të gjuhës së mjedisit dhe aktivitete tjera në nivel shkolle.

Hartimi, rishikimi, përkthimi dhe përshtatja e teksteve shkollore si dhe përgatitja e materialeve mësimore (të shtypura dhe digjitale) në gjuhët e komuniteteve jo shumicë, do të planifikohet dhe subvencionohet në vazhdimësi.

**Treguesit e ndikimit:**

- Shpenzimet publike në arsimin parauniversitar si përqindje e BPV-së (%)
- Përqindja e institucioneve arsimore (IEAA, DKA, IA, MASHTI) që e përmbushin rolin e tyre për sigurimin e cilësisë
- Rezultatet e nxënësve në lexim-shkrim, matematikë dhe shkenca në teste ndërkombëtare (PISA), të ndara në baza gjinore.

**Treguesit e rezultateve:**

- Zhvillohet, rishikohet dhe zbatohet legjislacioni primar dhe sekondar.
- Përqindja e realizimit të planit për riorganizim të rrjetit të shkollave.
- Përqindja e drejtuesve në institucionet edukativo-arsimore që përzgjidhen dhe performojnë në bazë të standardeve profesionale.
- Përqindja e shkollave që kanë kodin buxhetor dhe menaxhojnë buxhetin e tyre.
- Numri i inspektorëve të rinj të angazhuar dhe trajnuar (angazhimi sipas Ligjit për Barazi Gjinore, dhe ndarja në përqindje sipas gjinisë).
- Numri i drejtorëve/zv. drejtorëve të vlerësuar, (zgjedhja sipas Ligjit për Barazi Gjinore dhe ndarja në përqindje sipas gjinisë).
- Numri i shkollave që i nënshtrohen vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të performancës.
- Numri i komunave që i kanë hartuar planet zhvillimore komunale të integruara.
- Përqindja e braktisjes në arsimin e obligueshëm dhe të mesëm të lartë.
- Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollim të obligueshëm dhe të mesëm të lartë.
- Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e obligueshëm dhe të mesëm të lartë, me fokus vajzat e komuniteteve: rom, ashkali dhe egjiptian.
- Numri i fëmijëve me talente të veçanta të identifikuar në kuadër të sistemit arsimor.
- Numri i shkollave të ndërtuara dhe renovuara.
- Numri i IEAA që plotësojnë kushtet higjieniko-sanitare.

- Përqindja e rasteve të menaxhuara të të gjitha formave të dhunës, përfshirë abuzimin dhe ngacmimin seksual, bullizmit dhe ekstremizmit të identifikuar në shkolla.
- Shkalla e zbatimit të masave të ndërmarra për të siguruar besueshmërinë e rezultateve të vlerësimeve kombëtare (kl.9 dhe 12).
- Rezultatet nga vlerësimi ndërkombëtar PISA.
- Përqindja e kërkesave në vlerësimet kombëtare të bazuara në kompetenca.
- Përqindja e komunave që kanë angazhuar 3-4 mësimdhënës në pozitat zyrtarë për kurrikula/ këshilltarë pedagogjik.
- Përqindja e kurrikulave lëndore për klasë të rishikuara bazuar në vendimet për rishikim.
- Numri i mësimdhënësve dhe drejtorëve të shkollave, zyrtarëve arsimore në komuna dhe MASHTI, të përfshirë në trajnime shitesë dhe forma tjera të mbështetjes për zbatimin e reformës së kurrikulës.
- Raportet e monitorimit të zbatimit të kurrikulës pasqyrojnë trend pozitiv të zbatimit të të gjitha elementeve të kurrikulës së bazuar në kompetenca.
- Hartohen dhe zbatohen dokumentet e planifikuara për rregullimin ligjor në bazë të Ligjit të ri për tekstet shkollore, burimet, materialet dhe mjetet mësimore.
- Tekstet shkollore dhe materialet mësimore të zhvilluara, rishikuara apo adaptuara në bazë të legjislacionit të ri, janë në harmoni me kurikulën dhe standardet përkatëse.
- Përqindja e plotësisht të nevojave me tekste shkollore dhe materiale mësimore për kategoritë e ndryshme të nxënësve me nevoja të veçanta dhe për lëndët e gjuhëve të huaja.
- Mbi 60% e shkollave janë të pajisura me pakon e mjeteve dhe materialeve mësimore sipas fushave kurrikulare.
- Kuadri nënligjor i sistemit të licencimit i rishikuar dhe avancuar.
- Përqindja e mësimdhënësve, të ndarë sipas gjinisë, që marrin pjesë çdo vit në programe të zhvillimit profesional.
- Numri i mësimdhënësve, të ndarë sipas gjinisë, që i janë nënshtruar vlerësimit të jashtëm të performancës.
- Përqindja e mësimdhënësve, të ndarë sipas gjinisë, të vlerësuar që kanë plotësuar në nivel të lartë standardet/kompetencat për mësimdhënës dhe kanë përparuar në nivelet e avancimit në karrierë.
- Përqindja e mësimdhënësve fillestar, të ndarë sipas gjinisë, që i ofrohet mentorimi sipas programit hyrës në profesion.
- Numri i masave afirmative për ngritjen e numrit të grave dhe vajzave në pozita menaxheriale në arsimin parauniversitar.
- Përqindja e programeve të ri/akredituara për përgatitjen e mësimdhënësve para shërbimit, që janë në harmoni me standardet për mësimdhënës dhe me filozofinë e kurrikulës që ofrohet në nivelet përkatëse të APU.
- Përqindja e të diplomuarave në programet për mësimdhënës që dëshmojnë kompetencë profesionale në vlerësimet e fazës së hyrjes në profesionin e mësimdhënësit/es.
- Përqindja e shkollave që kanë përfituar nga programet dhe format tjera të mbështetjes për promovimin e multikulturalizmit dhe diversitetit.
- Numri i programeve/ moduleve, teksteve dhe materialeve mësimore (të shtypura dhe digjitale) të zhvilluara, rishikuara dhe përshtatura për mësim në gjuhët e komuniteteve jo shumicë.

### 5.3. Objektivi Strategjik 3 – Arsimi, aftësimi profesional dhe arsimi për të rritur

#### Objektivi strategjik 3:

Harmonizimi i arsimit dhe aftësimit profesional me zhvillimet dinamike të teknologjisë dhe tregut të punës, në funksion të mësimit gjatë gjithë jetës

Cilësia e pamjaftueshme e ofertës së arsimit dhe aftësimit profesional ka rezultuar me shkallë të ulët të kënaqshmërisë së punëdhënësve me shkathtësitë/kompetencat e arritura nga kandidatët e diplomuar në IAAP si dhe me shkallë të ulët të tranzicionit nga shkolla në punë. Mundësitë për mësim gjatë gjithë jetës dhe mobilitetet janë të kufizuara dhe nuk janë në hap me nevojën për riaftësim të vazhdueshëm të fuqisë punëtore. Rrjedhimisht, përqendrimi kryesor në kuadër të kësaj fushe tematike është rishikimi i ofertës së arsimit dhe aftësimit profesional si dhe përmirësimi i cilësisë, në funksion të zhvillimit të shkathtësive të transferueshme, shkathtësive digjitale, shkathtësive të ndërmarrësisë dhe shkathtësive teknike profesionale, në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me trendet e transformimit digjital dhe të gjelbër.

#### Objektivi specifik 3.1:

Përmirësimi i qeverisjes, financimit dhe sistemit të menaxhimit të informatave të arsimit dhe aftësimit profesional dhe arsimit për të rritur

Për një menaxhim cilësor dhe efektiv të arsimit dhe aftësimit profesional, fillimisht nevojitet rishikim i kornizës ligjore për të siguruar mbulimin e të gjitha funksioneve të sistemit të arsimit dhe aftësimit profesional në mënyrë gjithëpërfshirëse, përfshirë përcaktimin e qartë të përgjegjësive, linjave të autoritetit dhe llogaridhënies ndërmjet të gjitha institucioneve të sistemit të arsimit dhe aftësimit profesional. Përmes akteve nënligjore, ndër të tjera, do të bëhet standardizimi i përmbajtjeve të kualifikimeve të ofruara nga IAAP-të në përputhje me KKK. Riorganizimi i rrjetit të institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional do të bëhet në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe në nivel të shtatë rajoneve kryesore të Kosovës. Për më shumë, kategorizimi dhe standardizimi i organizimit të brendshëm të IAAP-ve do të mundësoj funksionalizimin e të gjitha organeve dhe shërbimeve të nevojshme brenda këtyre institucioneve.

Për të siguruar buxhetin e nevojshëm për përmirësim të cilësisë së arsimit dhe aftësimit profesional, formula financiare do të rishikohet bazuar në modelin e shpenzimeve reale për çdo kualifikim, ndërsa për të garantuar të dhëna relevante dhe të përditësuara për nevojat e tregut të punës, sistemi për menaxhimin e informatave të AAP-së dhe tregut të punës do të përmirësohet dhe integrohet. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edhe ngritjes së kapaciteteve njerëzore të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAPARr) dhe udhëheqjes së IAAP-ve për përmbushjen e të gjitha funksioneve që priten prej tyre.

#### Objektivi specifik 3.2:

Konsolidimi i mekanizmave për sigurim të cilësisë, në nivel qendror, lokal dhe në nivel të IAAP-ve, për të mundësuar qasje sistemore për menaxhim të cilësisë

Sigurimi efektiv i cilësisë nënkupton një kulturë të sigurimit të cilësisë dhe një qasje në shumë nivele për menaxhimin e cilësisë, që përfshin AKK, Inspektoratin e Arsimit, AAPARr dhe DKA-të. Edhe pse Korniza Kombëtare e Kualifikimeve pranon një sistem më të gjerë të sigurimit të jashtëm të cilësisë në AAP, kjo qasje nuk mbështetet mjaftueshëm nga korniza ligjore. Për të siguruar një ekuilibër midis qasjes kontrolluese dhe qasjes zhvillimore në sigurimin e cilësisë, do të duhet të përcaktohet roli i çdo mekanizmi të jashtëm për SC. Në këtë drejtim, përderisa fokusi i AKK është në kontrollimin e



cilësisë përmes sigurimit të cilësisë së kualifikimeve (akreditimi, validimi, verifikimi i vlerësimit dhe dhënia e kualifikimeve të aprovuara), fokusi i Inspektoratit të Arsimit, AAAPARr dhe DKA-ve duhet të jetë në përmirësimin e cilësisë, përmes monitorimit dhe mbështetjes së proceseve të sigurimit të cilësisë në sistemin e IAAP-ve. Kjo qasje sistimore dhe gjithëpërfshirëse e sigurimit të cilësisë duhet të përcaktohet më tej në KKK, në Ligjin për AAP si dhe përmes akteve nënligjore që përcaktojnë procedurat për sigurimin e cilësisë në IAAP.

Për të mbështetur proceset e brendshme të sigurimit të cilësisë, funksionet përkatëse duhet të institucionalizohen dhe rregullohen nga legjislacioni përkatës, përfshirë: pozitën e koordinatorit për Sigurim të Cilësisë, detyrat dhe përgjegjësitë e udhëheqjes së shkollave, organeve qeverisëse, organeve e shërbimeve profesionale si dhe mësimdhënësve. Krahas konsolidimit të sistemit për sigurim të cilësisë, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet edhe ngritjes së kapaciteteve të të gjitha institucioneve për sigurim të cilësisë.

### **Objektivi specifik 3.3:**

Finalizimi i pakos kurrikulare për kualifikimet që ofrohen nga institucionet e arsimit dhe aftësimin profesional, në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me trendet e transformimit

Me qëllim përmirësimin e ofertës për zhvillimin e kompetencave për jetë dhe punë, Korniza e Kurrikulës për AAP do të finalizohet ndërsa dinamika e hartimit, miratimit dhe verifikimit të standardeve të profesionit do të përshpejtohet për të udhëhequr procesin e finalizimit/hartimit të kurrikulave bërthamë për të gjitha profilet e profesionit që ofrohen nga IAAP-të. Kurrikulat bërthamë do të pasqyrojnë filozofinë e Kornizës së Kurrikulës për Arsimin Parauniversitar, të shprehur përmes parimeve të saj, do të udhëhiqen nga Korniza e Kurrikulës për AAP dhe të jenë në përputhje të plotë me KKK dhe standardet e profesionit. Rishikimi i dokumentacionit administrativ dhe pedagogjik për IAAP-të dhe zhvillimi i materialeve mësimore digjitale janë masa tjera të nevojshme për kompletimin e pakos kurrikulare të AAP-së.

Për të adresuar nevojat për zhvillim profesional të mësimdhënësve të AAP-së, përmes aktit nënligjor për kriteret e kualifikimit të mësimdhënësve të AAP dhe Kornizës për zhvillim profesional të mësimdhënësve të AAP, do të kompletohet baza rregullative. Zhvillimi profesional para shërbimit do të mundësohet përmes përgatitjes dhe ofrimit të një programi kualifikues për kuadrin mësimdhënës për AAP, ndërsa për zhvillim të vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve të AAP-së, IAAP-të do të mbështeten për zbatimin e zhvillimit profesional me bazë në shkollë. Për këtë qëllim, krahas udhëzuesve praktik për identifikimin e nevojave, planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve të ZHPM me bazë në shkollë, vëmendje e veçantë do të kushtohet edhe përgatitjes së mësimdhënësve mentor në secilin IAAP për planifikimin dhe zbatimin e kurrikulës së re, për realizimin e mësimin praktik, hartimin e materialeve mësimore, aplikimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe të nxënimit në përputhje me agjendën e BE-së për arsimin digjital dhe të gjelbër (përfshirë aplikimin e materialeve mësimore digjitale, përdorimin e pajisjeve të mençura teknologjike dhe platformave të realitetit të shtuar).

Krijimi i rrjeteve të udhëheqësve të IAAP-ve dhe të organeve e shërbimeve profesionale të IAAP-ve për shkëmbim të informatave dhe përvojave në formë të komuniteteve për të mësuar së bashku, si dhe mbështetja e IAAP-ve për pjesëmarrje në programet ndërkombëtare të bashkëpunimit dhe mobilitetit për AAP, janë masa tjera të nevojshme për t'i kontribuar zhvillimit të vazhdueshëm profesional të udhëheqjes së IAAP-ve dhe mësimdhënësve, në funksion të avancimit të menaxhimit të IAAP-ve, shërbimeve dhe proceseve mësimore.

**Objektivi specifik 3.4:**

Sigurimi i mundësive për realizimin e mësimit praktik dhe funksionalizimi i shërbimeve të këshillimit në karrierë

Për të trajtuar vështirësitë e shumta me të cilat përballen IAAP-të në realizimin e mësimit praktik, fillimisht do të bëhet një vlerësim i nevojave të menjëhershme për material shpenzues, pajisje dhe hapësira adekuate për realizimin e mësimit praktik në punëtoritë e IAAP-ve. Mbi këtë bazë do të planifikohet dhe ndahet buxheti i nevojshëm për adresimin e këtyre nevojave.

Krahas funksionalizimit të shërbimeve të nevojshme për bashkëpunim me ndërmarrje (në kuadër të OS1), vëmendje e veçantë do ti kushtohet edhe vlerësimit të kapaciteteve të ndërmarrjeve për realizimin e mësimit në vend të punës dhe modaliteteve të mësimit dual, ngritjes së kapaciteteve të udhëheqësve, mësimeve dhe instruktorëve për organizimin dhe realizimin e mësimit në vendin e punës, si dhe për zbatimin e modelit të shkollës ndërmarrëse të AAP-së. Ndarja e buxhetit dhe aranzhimet e nevojshme për sigurimin aksidental dhe transportin e nxënësve të IAAP-ve, veçanërisht për gratë dhe vajzat, për realizimin e mësimit në vendin e punës janë ndërhyrje tjera të domosdoshme për të mundësuar realizimin e mësimit në vend të punës dhe modaliteteve të mësimit dual.

Duke pasur parasysh faktin se këshillimi dhe orientimi në karrierë është shumë i rëndësishëm për një sistem funksional të AAP-së në vend, akti nënligjor për shërbimet e këshillimit në karrierë do të hartohet, standardet e cilësisë të shërbimeve të këshillimit në karrierë do të përcaktohen dhe kapacitetet e IAAP-ve për shërbimet e këshillimit dhe orientimit në karrierë do të ngriten. Masa të veçanta do të ndërmerren edhe për promovimin e rëndësisë së AAP-së si zgjidhje atraktive e aftësisë për punë dhe jetë si dhe për inkurajimin e pjesëmarrjes së nxënësve, nga kategoritë e cenushme sociale, sidomos për vajzat dhe gratë, të rinjtë me aftësi të kufizuara, si dhe grupet e nënpërfaqësuara përmes bursave dhe stimujve tjerë.

**Objektivi specifik 3.5:**

Përmirësimi i ofertës dhe rritja e pjesëmarrjes në ARr

Promovimi i mësimit gjatë gjithë jetës në kontekstin e ndryshimeve të vazhdueshme të kërkesave të tregut të punës përbën thelbin e ndërhyrjeve në kuadër të kësaj fushe tematike. Përqendrimi kryesor në kuadër të këtij objekti do të jetë në validimin e kompetencave të arritura përmes arsimit joformal dhe informal, ngritjen e cilësisë dhe plotësimin e ofertës për ARr, promovimin e rëndësisë së mësimit gjatë gjithë jetës dhe inkurajimin e pjesëmarrjes në programet e ARr.

Mungesa e një programi kualifikues që përgatitë mësimeve për arsim për të rritur, ka bërë që kuadri mësimeve për ARr të mos ketë kualifikimin dhe kapacitetet e nevojshme për ofrim dhe zbatim të ARr, prandaj vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përgatitjes dhe ofrimit të një programi kualifikues për kuadrin mësimeve për ARr.

Pasi që programet aktuale për ARr që ofrohen në IAAP përmes mësimit të përshpejtuar/kompensues bazohen në kurrikulat e njëjta që janë në zbatim për mësimin e rregullt, MASHTI do të përgatis kurrikula të veçanta për ARr për nivelet fillor, të mesëm të ulët, të mesëm të lartë dhe postsekondar. Krahas kësaj, institucionet arsimore duhet të zhvillojnë dhe të ofrojnë edhe kualifikime afatshkurtra dhe kurse joformale që mundësojnë zhvillim të vazhdueshëm profesional, riaftësim, njohuri dhe shkathësi për progres në jetë, punë apo në shkollim. Për këtë qëllim, NjMP duhet të fillojë të zbatohet dhe kapaciteti i IAAP-ve për zbatim të programeve të ARr dhe NjMP duhet të ngritet. Nga ana tjetër, me qëllim plotësimin e ofertës për programe të ARr, MASHTI në bazë vjetore duhet të shpallë ofertë për projektpropozime për ofruesit formal dhe joformal dhe të ndajë fonde për ofrimin e programeve të ARr.

Në funksion të bashkërendimit ndërinstitucional për përmirësim të ofertës dhe nxitje të pjesëmarrjes në ARr, AAAPARr dhe IAAP-të, duhet të bashkëpunojnë me Zyrat e Punësimit (ZP) dhe Qendrat e Aftësisimit Profesional (QAP) për të shkëmbyer informacionet për mundësitë e ofrimit të programeve të ndryshme. AAAPARr dhe IAAP-të, duhet që po ashtu të organizojnë fushata të ndryshme për nxitjen e pjesëmarrjes në ARr me qëllim që qytetarët të informohen për avantazhet e ARr-së si mundësi për zhvillimin personal të individit dhe lehtësimin e kalimit në tregun e punës, si dhe për ofertën që është në dispozicion.

Për të pasur më të lehtë qasjen në informacion për programet të cilat janë në dispozicion për ARr, do të krijohet një regjistër i ofruesve formal dhe joformal të ARr dhe i njëjti të vihet në dispozicion të qytetarëve për të lehtësuar qarkullimin e informacionit për të interesuarit. Për të nxitur interesimin e qytetarëve për ARr, nevojitet edhe alokimi i një buxheti të caktuar që ofron stimuj të ndryshëm për nxitje të pjesëmarrjes në ARr. Rritja e përfshirjes së personave nga grupet e cënueshme, personat me aftësi të kufizuara, e sidomos për vajzat dhe gratë, do të ketë vëmendje të veçantë përmes ofrimit të përparësive në bursa dhe stimuj tjerë për regjistrim në programet e ARr.

Element tjetër i rëndësishëm për ARr është edhe ndërkombëtarizimi; institucionet arsimore që ofrojnë ARr do të mbështeten për tu anëtarësuar në organizata të ndryshme ndërkombëtare për ARr, me qëllim nxitjen e lëvizshmërisë dhe pjesëmarrjes së nxënësve dhe mësimeve në projekte të ndryshme ndërkombëtare.

#### **Treguesit e ndikimit:**

- Përqindja e kualifikimeve formale dhe joformale që ofrohen nga IAAP-të, të regjistruara në regjistrin e kualifikimeve të KKK.
- Përqindja, e ndarë sipas gjinisë, e pjesëmarrjes në drejtimet deficitare.
- Përqindja, e ndarë sipas gjinisë, e sistemimit të të diplomuarve nga IAAP, në profesionet përkatëse dhe në arsimin e lartë.

#### **Treguesit e rezultateve:**

- Sistemi i qeverisjes dhe menaxhimit të AAP-së dhe ARr është riorganizuar. Niveli i financimit të IAAP-ve i plotëson nevojat e tyre.
- Rrjeti i institucioneve të arsimit dhe aftësisimit profesional është riorganizuar në përputhje me nevojat e tregut të punës.
- Të dhënat e integruara në Sistemin për Menaxhimin e Informatave në Arsim, Barometrin e Kosovës për Tregun e Punës dhe Gjurmimin e të Diplomuarve janë relevante dhe të përditësuara.
- Mekanizmat për sigurim të cilësisë janë funksionalizuar në të gjitha nivelet.
- Përqindja e IAAP-ve që kanë regjistruar trend pozitiv të përmirësimit të performancës.
- Përqindja e kualifikimeve që ofrohen nga IAAP-të për të cilat është miratuar dhe ka filluar të zbatohet pakoja e re kurrikulare.
- Përqindja e mësimeve të IAAP-ve që kanë marrë pjesë në programe të zhvillimit të vazhdueshëm profesional.
- Përqindja e kualifikimeve që ofrohen nga IAAP-të për të cilat janë siguruar mundësitë për realizim të mësimit praktik.
- Përqindja e IAAP-ve që ofrojnë shërbime të këshillimit dhe orientimit në karrierë.
- Përqindja e IAAP-ve që zbatojnë modelin e shkollës ndërmarrëse të AAP-së.
- Numri i IAAP-ve që zbatojnë NjMP.
- Rritja e pjesëmarrjes në arsimin për të rritur.

## 5.4. Objektivi Strategjik 4 – Arsimi i lartë

### Objektivi strategjik 4:

Përmirësimi i cilësisë, integritetit dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë

Ky objektivi është formuluar në përgjigje të mangësive strukturore në fushën e arsimit të lartë dhe synon të përmirësojë cilësinë dhe integritetin e arsimit të lartë, nëpërmjet zbatimit të procesit të akreditimit në pajtim me standardet ndërkombëtare të cilësisë, që ndër të tjera do të mundësojë rikthimin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim në ENQA dhe EQAR. Reformimi i arsimit të lartë, synohet të arrihet nëpërmjet avancimit të kuadrit ligjor, zhvillimit të kapaciteteve të mekanizmave për sigurim të cilësisë, rritjes së pjesëmarrjes në programe ndërkombëtare dhe përmirësimin të infrastrukturës akademike dhe kërkimore.

Cilësia e pamjaftueshme e programeve të studimit dhe kapacitetet e kufizuara për sigurim të cilësisë dhe nevoja për përmirësimin e qeverisjes dhe financimit të arsimit të lartë, medoemos ngrisin nevojën për fuqizimin e cilësisë së mekanizmit mbikëqyrës të AKA-së, nxitjen e përsosmërisë në mësimdhënie dhe zbatimin e standardeve të larta të vlerësimit institucional dhe të programeve të studimit. Në këtë kontekst, MASHTI duhet të rregullojë bazën ligjore dhe rishikojë legjislacionin ekzistues, të zhvillojë formulën e financimit dhe të zhvillojë sistem të avancuar të menaxhimit të informatave.

Ndër të tjera, masat e parapara synojnë të institucionalizojnë kontrollin antiplagjiaturë, të rrisin transparencën në arsimin e lartë, të sigurojnë qasje në literaturën bashkëkohore digjitale, të mbështesin studentët përmes skemave të ndryshme të bursave, të zhvillojnë programe ndërkombëtare të bashkëpunimit akademik dhe shkencor, të ndërlidhin programet e arsimit të lartë me tregun e punës dhe të ofrojnë mundësi për punë praktike për studentët, me fokus te vajzat dhe gratë.

### Objektivi specifik 4.1:

Rritja e cilësisë së arsimit të lartë përmes rishikimit të programeve të studimit, avancimit të infrastrukturës akademike, nxitjes së përsosmërisë në mësimdhënie dhe kërkim dhe zbatimit të standardeve të larta të vlerësimit institucional dhe të programeve të studimit

Cilësia e pamjaftueshme e programeve të studimit, infrastruktura e mangët akademike, kapacitetet e kufizuara për sigurim të cilësisë dhe për zhvillim profesional të stafit akademik, numri i kufizuar i publikimeve në revista ndërkombëtare dhe raporti i pafavorshëm staf akademik – student, medoemos kërkojnë rritjen e cilësisë së arsimit të lartë përmes rishikimit të programeve të studimit, avancimit të infrastrukturës akademike, nxitjes së përsosmërisë në mësimdhënie dhe kërkim dhe zbatimit të standardeve të larta të vlerësimit institucional dhe të programeve të studimit

Standardet e AKA-së bazohen kryesisht në përmbushjen e kritereve minimale për akreditimin dhe riakreditimin e programeve dhe institucioneve. Do të bëhet rishikimi i standardeve të AKA që të zbatohet një sistem i bazuar në qasjen e plotësimit/zgjerimit të cilësisë.

Programet e reja të studimit të IAL-ve janë të akredituara në përputhje me standardet e cilësisë të përcaktuara nga AKA. Rishikimi i programeve të akredituara paraprakisht dhe programeve të reja në vazhdimësi do të sigurojë një përpjekje të shtuar në drejtim të zgjerimit të kulturës së cilësisë, që mund të shërbejë si udhërrëfyes për vendimmarrje dhe planifikim strategjik. Gjithashtu, do të mbështetet hapja e programeve të përbashkëta cilësore të nivelit të doktoratës me institucionet ndërkombëtare të arsimit të lartë, në përputhje me nevojat për kuadro akademike profesionale.

Infrastruktura akademike vlerësohet e vjetruar dhe e mangët për të siguruar ofrim të shërbimeve cilësore akademike. Do të bëhet vlerësimi i nevojave për investime në infrastrukturën akademike dhe rrjedhimisht plani për investime në të gjitha IAL-të, që përfshijnë edhe investimet në pajisje laboratorike dhe ngritje të kapaciteteve të stafit për përdorim të këtyre pajisjeve. MASHTI do të sigurojë abonimet e stafit akademik në biblioteka ndërkombëtare elektronike.

Kosova nuk ka tregues kombëtarë të arsimit të lartë, të cilat do të mundësonin në vazhdimësi identifikimin e masave që duhen ndërmarrë në arsimin e lartë dhe do të ofronin të dhëna sasiore dhe cilësore, të ndara sipas gjinisë, për të informuar politikëbërjen dhe për të mundësuar vendimmarrjen e bazuar në dëshmi. MASHTI do të hartojë treguesit kombëtar që do t'i shërbejnë qëllimit të tyre për të ofruar informacion objektiv që nxit matjen e cilësisë, përmirësimin dhe inovacionin.

Zyrat për sigurim të cilësisë dhe zhvillim akademik nëpër IAL janë themeluar, por funksionojnë në nivele të ndryshme të cilësisë dhe kapacitetit. Stafi në këto zyre do të ndjekin trajnime të specializuara me qëllim të përkrahjes së IAL-ve për rishikimin e vazhdueshëm të metrikëve të cilësisë në institucionin e tyre, si dhe plotësimin dhe monitorimin e realizimit të kërkesave që dalin nga proceset e akreditimit institucional dhe të programeve.

Raportet vlerësuese të PSAK dëshmojnë se ka progres të ulët në funksionalizimin e Qendrave për Përsosmëri në Mësimdhënie (QPM) në IAL. QPM-të, duhet të themelohen dhe funksionalizohen për të identifikuar në vazhdimësi nevojat zhvillimore profesionale të stafit akademik dhe për të zhvilluar dhe ofruar programe dhe shërbime të zhvillimit akademik, përkatësisht programe të ndryshme të trajnimit lidhur me metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.

Puna kërkimore-shkencore vlerësohet jo mjaftueshëm e integruar në aktivitetet mësimore dhe në angazhimet profesionale të stafit akademik. IAL-të, përgjithësisht nuk e kanë të përfshirë kërkimin shkencor në obligimet kontraktuale të stafit akademik dhe ofrojnë mundësi të kufizuara për financimin e publikimeve shkencore dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore. Do të zhvillohen tutje skemat e qëndrueshme të financimit të publikimeve në revista ndërkombëtare dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare për të nxitur kulturën akademike për të hulumtuar dhe gjeneruar një dije të re që ndihmon zhvillimin e vendit, apo institucionit në veçanti.

Përjashtimi i AKA-së nga dy mekanizmat kryesor të sigurimit të cilësisë në Evropë, ENQA dhe EQAR kërkon shtim të përpjekjeve në plotësimin e rekomandimeve të ENQA dhe EQAR si mundësi qenësore për cilësinë e sistemit të arsimit të lartë në Kosovë.

#### **Objektivi specifik 4.2:**

Përmirësimi i qeverisjes dhe financimit të arsimit të lartë përmes rishikimit të legjislacionit, zhvillimit të sistemit të avancuar të menaxhimit të informatave, rritjes së kapaciteteve profesionale, përmirësimin të shërbimeve për studentë dhe sigurimit të integritetit akademik, transparencës dhe llogaridhënies në arsimin e lartë

Përmirësimi i qeverisjes dhe financimit të arsimit të lartë do të bëhet përmes rishikimit të legjislacionit, zhvillimit të sistemit të avancuar të menaxhimit të informatave, përmirësimin të shërbimeve për studentë dhe sigurimit të integritetit akademik, transparencës dhe llogaridhënies në arsimin e lartë.

Zbatimi i legjislacionit për arsimin e lartë, si Ligji për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, Ligji për Arsimin e Lartë dhe Ligji për profesionet e rregulluara do të mbështetet me rishikimin dhe zhvillimin e akteve nënligjore për të mundësuar realizimin e veprimeve lidhur me përmirësimin e qeverisjes dhe financimit në arsimin e lartë.

Do të hartohen rregulloret për Open Data për të mbështetur mbikëqyrjen publike të IAL-ve, monitorimin e aktiviteteve dhe cilësisë, si dhe për të mundësuar transparencë më të madhe. Në IAL-të në Kosovë mungon qasja Open Access në shfrytëzimin e laboratorëve dhe pajisjeve teknologjike. Ndaj, do të hartohen rregullore dhe protokolle të veçanta për shfrytëzimin e laboratorëve dhe pajisjeve teknologjike të miratuara në të gjitha IAL-të.

Rishikimi dhe miratimi i kodeve etike dhe kodeve të integritetit akademik, do të realizohen si dhe do të themelohen/funksionalizohen Këshillat e Etikës në të gjitha IAL-të. Gjithashtu, do të sigurohen kontrata afatgjate për shfrytëzimin e programeve antiplagjiaturë dhe të inkurajohet përdorimi i rregullt i tyre me qëllim të monitorimit të plagjiaturës dhe përmbushjes së standardeve etike gjatë hulumtimeve dhe punës akademike.

Mbledhja dhe përpunimi i informatave është i rëndësishëm për zbatim të formulës së financimit dhe promovim të cilësisë në arsimin e lartë. Strategjia parasheh hartimin e udhëzuesve për mbledhjen dhe analizën e të dhënave dhe trajnimin e zyrtarëve në nivel qendror dhe në nivel të IAL-ve për përdorim të SMIAL. Ngjashëm, do të investohet në regjistrin e hulumtuesve shkencor për të ofruar informata relevante për hulumtuesit.

Departamenti i Arsimit të Lartë në MASHTI dhe Qendra për Njohje dhe Informim Akademik (NARIC), në MASHTI funksionojnë me numër të vogël të stafit krahas përgjegjësive që këto dy njësi kanë. Prandaj, do të rritet numri i stafit të punësuar në këto zyre.

Konferenca e Rektorëve si organ këshillëdhënës, ndihmon MASHTI-n në orientimet e politikave programore të IAL-ve dhe në aspektet tjera organizative të përgjegjësive të përbashkëta. Konferenca e Rektorëve si mekanizëm do të mbështetet dhe fuqizohet në hartimin e politikave dhe rekomandimeve, si dhe në ndjekjen e takimeve të organizuara nga asociacionet ndërkombëtare të arsimit të lartë.

Metodologjia e financimit të IAL-ve mungon, përkundër që baza ligjore për këtë mekanizëm ekziston. Ndaj do të zhvillohet një metodologji e financimit të IAL-ve që formalizohet përmes një akti nënligjor, ngritja e kapaciteteve në nivel qendror dhe nivel të IAL-ve për këtë metodologji dhe zhvillimi i mekanizmit për zbatimin e formulës së re të financimit që bazohet në monitorim dhe vlerësim të performancës.

Duke filluar me përcaktimin e kriterëve për mbështetjen e studentëve të dalluar, studentëve të doktoratës, studentëve që studiojnë në drejtimet deficitare dhe në drejtimet STEM, me fokus të vajzat dhe gratë, si dhe studentët nga radhët e kategorive të cenushme sociale dhe komunitetet e nënperfaqësuar, dhe pastaj edhe në varësi të numrit të studentëve që plotësojnë këto kriterë, do të mundësohet mbështetja e studentëve përmes ofrimit të bursave. Për më shumë, do të zhvillohet databaza e përfituesve të bursave në skema të ndryshme për arsimin e lartë.

**Objektivi specifik 4.3:**

Ndërlidhja më e mirë e arsimit të lartë me tregun e punës përmes harmonizimit të programeve të studimit, rritjes së mundësive për punë praktike të studentëve, bashkëpunimit me ndërmarrje dhe rritjes së programeve ndërdisiplinare dhe programeve STEM

Ndërlidhje e ulët e programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës, oferta e kufizuar e programeve të studimit ndërdisiplinare, mundësitë e kufizuara për punë praktike të studentëve dhe mungesa e bashkëpunimit të IAL-ve me ndërmarrje, kërkon ndërlidhje më të mirë të arsimit të lartë me tregun e punës përmes harmonizimit të programeve të studimit, rritjes së mundësive për punë praktike të studentëve, me fokus të veçantë të vajzat dhe gratë, bashkëpunimit me ndërmarrje dhe rritjes së programeve ndërdisiplinare të studimit.

Do të zhvillohen programet e reja profesionale të nivelit të 5-të në të gjitha IAL-të publike, duke rritur kështu edhe numrin dhe llojin e programeve që ofrohen edhe numrin e studentëve që i ndjekin ato.

Programet që ofrohen në IAL dhe njohuritë/shkathtësitë që fitohen nga studentët nuk janë çdo herë në përputhje me nevojat e tregut të punës. Ndaj do të realizohen hulumtime të rregullta nga IAL-të për programet që ofrohen dhe nevojat e tregut të punës ku brenda tërësisë së hulumtimit, trajtohen edhe mundësitë e orientimit të njohurive dhe shkathtësive drejt nevojave të tregut të punës dhe vetëpunësimit me synim shtresat në nevojë, gratë dhe vajzat dhe komunitetet. Bazuar në të dhënat e mbledhura nga këto hulumtime, do të rishikohen programet aktuale dhe të hartohen programe të reja që janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Qendrat për Zhvillim të Karrierës (QZHK) në IAL operojnë me kapacitete të kufizuara të stafit dhe numri i përfituesve të shërbimeve të tyre është i vogël. Strukturat si QZHK-të janë të nevojshme për të nxitur ndërmarrësinë dhe ndërlidhjen me tregun e punës, ndaj do të mbështetet rritja e stafit të punësuar në këto qendra dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe organizative të tyre për ofrimin e shërbimeve të orientimit dhe këshillimit në karrierë të studentëve.

Projektet zhvillimore të përbashkëta në mes të IAL-ve dhe ndërmarrjeve janë pothuajse joekzistente. Do të ofrohen skema të granteve për të inkurajuar dhe mbështetur projekte të përbashkëta të IAL-ve me ndërmarrje.

Në IAL-të mungojnë programet ndërdisiplinare, që synojnë zhvillimin e kompetencave më të zgjeruara konform nevojave të tregut vendor dhe ndërkombëtar. Ndaj, bazuar në hulumtime të tregut të punës, do të zhvillohen programe ndërdisiplinare të studimit që do të ofrohen në IAL-të publike.

**Objektivi specifik 4.4:**

Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë përmes programeve të përbashkëta të studimit, rritjes së pjesëmarrjes në programe ndërkombëtare të bashkëpunimit akademik dhe shkencor si dhe integritit në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.

Kapacitete të kufizuara të IAL-ve për zhvillimin dhe menaxhimin e projekteve dhe ndërtimin e partneriteteve ndërkombëtare, mungesa e programeve të përbashkëta të studimit, mobiliteti i kufizuar i stafit akademik dhe studentëve, si dhe pjesëmarrja e ulët në programet ndërkombëtare për arsim të lartë dhe kërkime shkencore, kërkojnë shtim të përpjekjeve për ndërkombëtarizim të arsimit të lartë. Kjo do të bëhet përmes programeve të përbashkëta të studimit, rritjes së pjesëmarrjes në programe ndërkombëtare të bashkëpunimit akademik dhe shkencor, si dhe integrim në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.

IAL-ve, në Kosovë ju mungojnë përpjekjet e strukturuar për ndërkombëtarizim dhe planet konkrete të veprimit në këtë drejtim. Do të hartohen dhe miratohen strategji të ndërkombëtarizimit në secilën IAL.

Momentalisht në Kosovë nuk ofrohen programe të përbashkëta ndërdisiplinare të studimit me IAL ndërkombëtare. Do të mbështetet aplikimi i IAL-ve në skemat e granteve ndërkombëtare (dual/joint degree) për të siguruar financim për projekte ndërkombëtare të bashkëpunimit akademik, përfshirë programe të përbashkëta ndërdisiplinare të studimit me IAL-të ndërkombëtare.

Qendrat për zhvillim dhe koordinim të projekteve në IAL nuk janë funksionale në të gjitha IAL-të. Strukturat si këto janë të nevojshme për të mbështetur stafin akademik në zhvillimin e projekteve akademike dhe kërkimore si dhe në ndërtimin e partneriteteve ndërkombëtare. Ndaj do të iniciohet themelimi dhe funksionalizimi i tyre dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe organizative të tyre për ofrimin e shërbimeve për njësitë akademike dhe stafin akademik.

Mundësitë e mobilitetit për stafin akademik dhe studentët në Kosovë janë të shumta. Statistikat e IAL-ve tregojnë se numri i shfrytëzuesve të këtyre mobiliteteve krahas ofertës është i vogël. Do të fuqizohen dhe inkurajohen përpjekjet për rritjen e mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik përmes pjesëmarrjes në programet ndërkombëtare të bashkëpunimit akademik.

Kosova ka nivel të ulët të pjesëmarrjes në programin e BE-së për arsim të lartë. Do të fuqizohen përpjekjet për rritjen e pjesëmarrjes në programe evropiane për arsim të lartë dhe kërkim shkencor.

#### **Treguesit e ndikimit:**

- Përqindja e programeve të studimit që zbatohen në përputhje me standardet e cilësisë.
- Shkalla e zbatimit të metodologjisë së financimit të IAL-ve në bazë të performancës.
- Disponueshmëria e të dhënave për institucionet arsimore dhe publikun e gjerë.
- Shkalla e përputhjes së programeve të studimit që janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës.
- Numri i projekteve të përbashkëta të IAL-ve me ndërmarrje.
- Numri i projekteve të përbashkëta ndërkombëtare për arsim të lartë dhe kërkime shkencore.

#### **Treguesit e rezultateve:**

- Të gjitha programet e studimit të IAL-ve janë në përputhje me standardet e cilësisë.
- Avancohet infrastruktura dhe teknologjia për mësimdhënie dhe punë kërkimore në IAL.
- Mekanizmat për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë janë plotësisht funksional në të gjitha IAL-të.
- Mekanizmat për zhvillimin profesional të stafit akademik të IAL-ve janë plotësisht funksional.
- Numri i publikimeve shkencore në revista të indeksuara ndërkombëtare i stafit akademik të IAL-ve rritet për 10% në çdo vit.
- Raporti staf akademik – student në IAL publike është të paktën 1:30.
- AKA është anëtare me të drejta të plota në ENQA dhe EQAR.
- Kornizë e konsoliduar ligjore në arsimin e lartë që garanton pavarësi institucionale dhe financiare të AKA-së, si dhe autonomi institucionale dhe pavarësi akademike të IAL-ve.
- Mekanizmat për çështje të etikës dhe integritetit akademik janë plotësisht funksional në të gjitha IAL-të.
- Deri në vitin 2023, Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsimin e Lartë është plotësisht funksional.
- Deri në vitin 2023, Regjistri i Hulumtuesve Shkencor është plotësisht funksional.
- Deri në vitin 2024, fillon zbatimi i metodologjisë së financimit të institucioneve të arsimit të lartë në bazë të performancës.



- Staf i DAL/MASHTI dhe AKA-së rritet dhe zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme përmes trajnimeve profesionale.
- Skema të ndryshme të bursave ofrohen për studentët në arsimin e lartë.
- Programet e studimit janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës.
- Mekanizmat për zhvillim të karrierës janë plotësisht funksional në të gjitha IAL-të.
- Mundësi të shtuara për punë praktike për studentët.
- Zbatohen projekte të përbashkëta të IAL-ve me ndërmarrje.
- Rritet numri i studentëve që ndjekin programet e studimit në fushat e STEM
- Rritet pjesëmarrja e vajzave në programet STEM, përmes motivimit me bursa.
- IAL-të ofrojnë programe të përbashkëta të studimit me universitete ndërkombëtare.
- Mekanizmat për zhvillimin dhe koordinimin e projekteve janë plotësisht funksional në të gjitha IAL-të.
- Rritet mobiliteti i stafit akademik dhe studentëve në arsimin e lartë.
- Rritet pjesëmarrja në programet ndërkombëtare për arsim të lartë dhe kërkime shkencore.

## 5.5. Objektivi strategjik 5 – Digjitalizimi i arsimit

### Objektivi strategjik:

Përdorimi i teknologjisë digjitale për përmirësimin e shërbimeve dhe të cilësisë në arsim, në përputhje me trendet e transformimit digjital

Me qëllim që Kosova të lëvizë sa më shpejt në drejtim të digjitalizimit të të dhënave, ofrimit të shërbimeve digjitale dhe automatizimit të proceseve në fushën e arsimit dhe me qëllim të rritjes së përdorimit të teknologjisë digjitale për nevoja arsimore e në funksion të përmirësimit të cilësisë në arsim, Kosova gjatë pesë viteve të ardhshme do të punojë në pesë drejtime:

- 1 Krijimin dhe funksionalizimin e një platforme digjitale gjithëpërfshirëse e të centralizuar për fushën e arsimit.
- 2 Përgatitjen dhe prodhimin e materialeve mësimore digjitale shumëdimensionale e cilësore për nivele, klasë, lëndë e lloje të ndryshme.
- 3 Furnizimin e IEAA-ve dhe IAL-ve me rrjete të internetit cilësor dhe me pajisje teknologjike të nevojshme.
- 4 Kultivimin e kompetencës digjitale të të gjitha palët e përfshira në fushën e arsimit dhe të të gjitha institucionet arsimore të të gjitha llojeve dhe niveleve.
- 5 Krijimin e mekanizmave institucionalë që mundësojnë realizimin e digjitalizimit dhe përdorimin e teknologjisë në fushën e arsimit.

Të gjitha këto veprime janë të parapara në kuadër të pesë objektivave specifike, të cilat do të prezentohen dhe përshkruhen shkurtimisht në vijim, ndërsa detajet për të gjitha aktivitetet që do të ndërmerren në funksion të arritjes së këtyre objektivave specifike dhe përmbushjes së objektivit strategjik janë të prezentuara në planin e veprimit të këtij dokumenti.

**Objektivi specifik 5.1:**

Digjitalizimi dhe integrimi i të dhënave dhe proceseve në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve dhe rritjes së vendimmarrjes së mirinformuar, transparencës dhe llogaridhënies në fushën e arsimit

Siç mund të vërehet nga analiza e gjendjes, sa i përket digjitalizimit të të dhënave e shërbimeve dhe automatizimit të proceseve në fushën e arsimit, mbetet shumë punë për digjitalizimin e tërësishëm të të dhënave dhe integrimin e tyre në një platformë digjitale gjithëpërfshirëse të arsimit, në mënyrë që pastaj të mundësohet automatizimi i proceseve dhe ofrimi i shërbimeve digjitale për të gjitha palët e interesuara për të gjitha nevojat në fushën e arsimit. Prandaj, duhet të krijohet kjo platformë me elemente të e-Querisjes në arsim, të Sistemeve të Menaxhimit të Informatave në Arsim (EMIS), të Sistemeve të Menaxhimit të Shkollës/Arsimit (SMS/EMS), të Sistemeve për Menaxhimin e të Mësuarit (LMS), platformë për organizimin dhe publikimin e materialeve mësimore digjitale, etj., në mënyrë që brenda saj të përfshihen të gjitha nivelet e arsimit, prej nivelit parashkollor e deri te niveli universitar, përfshirë sektorin publik, jopublik dhe privat të arsimit në Kosovë. Kjo platformë duhet të jetë e integruar me të gjitha platformat tjera digjitale të të gjitha institucioneve të Kosovës. Më shumë detaje se çfarë duhet të përmbajë kjo platformë, janë përfshirë në shtojcë të veçantë bashkë me analizën e zgjeruar të gjendjes. Gjithashtu, kjo platformë duhet të jetë e përkthyer në gjuhët zyrtare dhe në gjuhët e komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Normalisht, krijimi i platformës digjitale duhet të pasohet me futjen e të dhënave digjitale të të gjitha niveleve të arsimit në platformën digjitale, në mënyrë që pastaj të mund të realizohet automatizimi i disa proceseve dhe ofrimi i shërbimeve digjitale në fushën e arsimit për të gjitha palët.

Një platformë e tillë do të lehtësonte barrën administrative të institucioneve, do të zvogëlonte mundësinë e gabimeve njerëzore dhe ndërhyrjeve joprofessionale në procese të rëndësishme të fushës së arsimit, do të mundësonte vendimmarrje të bazuar në të dhëna të plota, do të lehtësonte marrjen e shërbimeve nga të gjitha palët e interesuara, etj. Të gjitha këto bëjnë që të rritet transparenca dhe llogaridhënia në fushën e arsimit si dhe cilësia e sistemit të arsimit në përgjithësi në Kosovë.

Për ta rregulluar aspektin ligjor të digjitalizimit në arsim duhet që aspektet e përgjithshme të digjitalizimit dhe dokumentacionit në formatin digjital në fushën e arsimit, siç është dokumentacioni pedagogjik e administrativ, etj., të përfshihen dhe të rregullohen me ligjin përkatës për tekste shkollore, materiale mësimore e dokumentacion pedagogjik (i cili është në procedurë të rishikimit). Përveç ligjit, MASHTI duhet të hartojë Udhëzime administrative që i rregullojnë të gjitha çështjet që lidhen me digjitalizimin, automatizimin e proceseve, shërbimet digjitale, dokumentacionin digjital, etj..

Ndërtimit të kësaj platforme duhet t'i paraprijë një analizë e gjendjes, e detajuar dhe hartimi i Termave të referencës për platformën digjitale në mënyrë të detajuar. Termet e referencës duhet të përfshijnë përshkrimin dhe specifikimin e çdo funksionaliteti për çdo modul. Ky përshkrim duhet të përfshijë edhe UX/Mockup për çdo funksion dhe duhet të përfshijë edhe vlerësimin se kur duhet të vendoset prerja ("Dita Zero") dhe migrimi i të dhënave paraprake. Pas kësaj, përzgjedhja e entitetit që do ta ndërtojë këtë platformë duhet të bëhet përmes konkursit ndërkombëtar.

Pas krijimit, testimit dhe funksionalizimit të kësaj platforme, për vitet pasuese, kjo platformë duhet të mirëmbahet e përditësohet sipas nevojës nga ndonjë entitet që përzgjidhet për këtë qëllim. Gjatë gjithë procesit të krijimit dhe funksionalizimit të kësaj platforme, duhet bashkëpunuar ngushtë me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit (ASHI), në mënyrë që kjo platformë të jetë e vendosur në serverët shtetërorë, të ofrojë ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave, etj.

Me qëllim të informimit/aftësimit të palëve tjera për përdorimin e platformës digjitale të arsimit, duhet të hartohen dhe publikohen udhëzues të ndryshëm. Gjithashtu, platforma digjitale e arsimit duhet të ketë edhe shërbimin e përhershëm për ndihmë për përdoruesit që ofron sqarime e udhëzime për të gjithë përdoruesit për platformën digjitale sipas nevojës.

Meqë për shumë ofrues dhe përdorues të shërbimeve të fushës së arsimit në Kosovë, digjitalizimi mund të jetë një praktikë relativisht e re, atëherë ka nevojë për përgatitje dhe aftësim të duhur të të gjitha palëve për të kontribuar në procesin e digjitalizimit të të dhënave, automatizimin e proceseve si dhe në ofrimin dhe shfrytëzimin e shërbimeve digjitale në fushën e arsimit.

### **Objektivi specifik 5.2:**

Zhvillimi dhe përdorimi i materialeve mësimore digjitale në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënësve

Duke marrë parasysh zhvillimet e fundit në fushën e teknologjisë dhe përdorimin e saj për nevoja arsimore në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies e të nxënësve, rezulton më se e nevojshme që edhe Kosova të fillojë të punojë në drejtim të zhvillimit të materialeve mësimore digjitale për të gjitha nivelet dhe llojet e arsimit parauniversitar, në përputhje me kurrikulat shtetërore, programet lëndore dhe planet mësimore. Këto materiale mësimore digjitale do të jenë materialet mësimore shumëdimensionale, të cilat në varësi dhe në përputhje me specifikat e lëndës mësimore, fushës kurrikulare, nivelit e klasës, përmbajtjet do t'i kenë në disa formate të ndryshme, përfshirë pjesët tekstuale dhe audio-vizuale të niveleve të ndryshme (mësimi i individualizuar dhe i diferencuar), aparaturë didaktike interaktive, laborator virtual, animacione, ushtrime e detyra shtëpie të niveleve të ndryshme (mësimi i individualizuar dhe i diferencuar), si dhe lojëra edukative për nxënësit. Këto materiale do të ofrojnë mundësi vlerësimi nga mësimdhënësit dhe mundësi vetëvlerësimi për nxënësit, mundësi që mësimdhënësi të shtojë materiale shtesë, mundësi lidhjeje me burime të ndryshme të platformave online, mundësi lidhjeje me pajisjet teknologjike të mësimdhënësit dhe me pajisjet teknologjike të nxënësve në klasë e në shtëpi, etj.. Këto materiale mësimore do duhej të kalonin nëpër filtrat e vlerësimit të mekanizmave të ministrisë, në mënyrë që të mund të përdoren në nivel vendi si dhe pas blerjes do të jenë pronë publike. Këto materiale në fund do të publikoheshin në një platformë, e cila duhet të jetë e integruar në platformën digjitale të arsimit (të përfshirë në objektivin specifik 5.1), në të cilën kanë qasje të gjitha palët (nxënësit, prindërit, mësimdhënësit). Këto materiale do të përmirësohen dhe përditësohen në mënyrë sistematike.

Këto materiale mësimore digjitale do të fillojnë të prodhohen për nivele të ndryshme të arsimit të përgjithshëm parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët, të mesëm të lartë – gjimnaze), për arsim të mesëm profesional, për kategori të ndryshme të nxënësve me nevoja të veçanta, etj. Gjithashtu, këto materiale, përveç në gjuhën shqipe, do të jenë edhe në gjuhët e komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

Prodhimit të këtyre materialeve mësimore digjitale duhet t'i paraprijnë një varg aktiviteteve parapërgatitore. MASHTI duhet ta rregullojë bazën ligjore në ligjin përkatës për tekste shkollore dhe materiale mësimore (që është në proces të rishikimit), në mënyrë që në ligjin e ri të saktësohet forma, përmbajtja, standardet dhe procedurat për përgatitjen dhe aprovimin e materialeve mësimore digjitale. Roli i palëve të përfshira, obligimet e tyre, e drejta e përdorimit dhe qasja në këto materiale duhet të rregullohen me akte përcjellëse nënligjore. Për të përcaktuar standardet për përgatitjen e materialeve mësimore, formatin që duhet të kenë këto materiale, dhe për të siguruar cilësinë e tyre, MASHTI do të hartojë një akt nënligjor, bazuar në përvojat më të mira nga vende të cilat kanë traditë dhe sistem cilësor për përgatitjen dhe përdorimin e materialeve mësimore digjitale. Zbatimi i plotë dhe i drejtë i këtij akti

do të mundësohet përmes udhëzuesve të ndryshëm për përgatitjen e materialeve mësimore digjitale. Veç këtyre, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përgatitjes dhe publikimit të modeleve të ndryshme të materialeve mësimore digjitale për nivele të caktuara si dhe për fusha dhe lëndë të ndryshme mësimore, të cilat do të shërbejnë si shembuj dhe udhërrëfyes për formën, përmbajtjen dhe strukturën e mundshme të materialeve mësimore digjitale për palët e ndryshme të interesuara për përgatitjen e tyre.

Meqë për qasjen në këto materiale mësimore digjitale duhen pajisje teknologjike dhe jo të gjithë nxënësit i kanë mundësitë e duhura financiare, atëherë parashihet që një numër i nxënësve (me prioritet ata me gjendje të rëndë ekonomike dhe familjet që kanë numër të madh të nxënësve) të furnizohet me pajisje teknologjike nga ana e institucioneve (MASHTI dhe DKA-të). Për këtë, nga MASHTI do të përcaktohen kriteret për nxënësit që do të përfitojnë pajisje teknologjike nga institucionet shtetërore.

Krahas zhvillimit dhe publikimit të materialeve mësimore digjitale, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edhe aftësimin të mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve për përdorimin e këtyre materialeve. Për të adresuar nevojat për aftësimin e mësimdhënësve për përdorimin e materialeve mësimore digjitale, do të ofrohen trajnime për mësimdhënës/edukatorë, të cilat do të përcillen me udhëzime dhe shembuj praktik, foto ilustruese, si dhe video-udhëzime për përdorimin e materialeve mësimore digjitale, përfshirë aspektet teknike, teknologjike, pedagogjike e metodologjike. Pjesë e trajnimit do të jetë edhe mentorimi dhe monitorimi. Në mënyrë që materialet mësimore digjitale dhe burimet tjera mësimore digjitale të përdoren efektshëm nga nxënësit dhe prindërit, MASHTI do të hartojë dhe publikojë udhëzues të ndryshëm për nxënës dhe prindër, në gjuhët zyrtare dhe në gjuhët e komuniteteve në të cilat zhvillohen materialet mësimore digjitale dhe burimet tjera digjitale. Udhëzuesit do të përcillen me sqarime hap-pas-hapi, me foto ilustruese, si dhe video-udhëzues, si për nxënës ashtu edhe për prindër.

### Objektivi specifik 5.3:

Ofrimi i mundësive për shfrytëzim efektiv të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në IEAA dhe IAL

Digitalizimi i arsimit dhe përdorimi i teknologjive digjitale për nevoja arsimore nuk është i mundur nëse institucionet arsimore nuk posedojnë qasje në internet cilësor dhe në pajisje adekuate të TIK-ut.

Kështu që fillimisht parashihet që të ofrohet qasje në internet me brez të dedikuar – broadband prej të paktën 100 Mbps për të gjitha IEAA-të në Kosovë, përkatësisht në të gjitha hapësirat e IEAA-ve. Që interneti të shfrytëzohet në mënyrë efektive është e nevojshme që secila IEAA të ketë rrjet të brendshëm (LAN) me kablllo dhe/ose wireless, me qasje në gjitha hapësirat mësimore, ku përfshihen: klasat, bibliotekat, kabinetet, laboratorët, korridoret, zyrat, etj..

Meqë institucionet arsimore parauniversitare publike kanë nevoja të ndryshme sa i përket pajisjeve të TIK-ut, do të fillohet me hartimin e standardit për furnizimin e tyre me pajisje të TIK-ut, ku do të përcaktohet qartë se çfarë lloj pajisjesh duhet siguruar dhe ku duhet të vendosen ato. Një standard i tillë duhet të parasheh që secila dhomë ku zhvillohet mësimi (rreth 9 mijë sosh) të ketë të paktën një projektor, tv smart ose tabelë interaktive, si dhe një kompjuter që do të shfrytëzohet për qëllime mësimore. Përveç kësaj, në varësi nga numri i nxënësve, shkollat duhet të kenë edhe numër të caktuar kompjuterësh në dispozicion të nxënësve në hapësira të përshtatshme siç janë kabinetet e TIK-ut, bibliotekat, laboratorët, etj.. Bazuar në këtë pastaj do të bëhet pajisja e institucioneve arsimore me kompjuterë, tabela interaktive, tv smart, projektorë dhe aksesore të tjerë. Përveç institucioneve të arsimit parauniversitar, sipas nevojës do të bëhet edhe furnizimi i IAL-ve publike me pajisje të ndryshme të TIK-ut.

Duke marrë parasysh kapacitetet financiare të kufizuara, do të jetë e nevojshme që mësime të ndërhënësit dhe nxënësit/studentët t'i shfrytëzojnë pajisjet e tyre personale brenda institucionit arsimor. Për ta rregulluar këtë çështje, MASHTI do të nxjerrë një akt nënligjor për shfrytëzimin e pajisjeve personale në institucionet parauniversitare, i cili, sipas nevojës, do të pasohet me udhëzime më të detajuara. Duke njohur rëndësinë e shfrytëzimit të teknologjisë digjitale nga personeli mësimor (edhe jashtë orarit të rregullt të punës) dhe nga studentët, MASHTI, në bashkëpunim me SBASHK dhe organizatat studentore, bizneset e TIK-ut dhe bankat komerciale, do të zhvillojë një skemë për kreditimin e blerjes së kompjuterëve personalë për mësime të ndërhënësit e arsimin parauniversitar dhe për studentët e arsimin të lartë. Kjo skemë do të bëjë të mundur që secili mësime të ndërhënësit dhe student, një herë në 3 vjet, të blejë një kompjuter personal me kushte të volitshme të pagesës.

Përvoja e deritanishme në Kosovë tregon se mirëmbajtja e pajisjeve të TIK-ut në IEAA është një ndër problemet kyçe në nivelin parauniversitar (në IAL gjendja është më e mirë, meqë ato kanë të punësuar zyrtarë të IT-së), dhe ky problem do të bëhet edhe më i dukshëm kur IEAA-të të pajisen edhe më shumë me pajisje të TIK-ut. Prandaj, për ta adresuar këtë, në komuna (në nivel të DKA-ve) do të krijohen njësi të veçanta të specialistëve të TIK-ut/IT-së, detyrë e të cilëve është mirëmbajtja e pajisjeve të TIK-ut dhe e rrjetit të internetit në IEAA (për më shumë rreth kësaj shih objektivin specifik 5.5.). Krahas ekipeve të specializuara, në shkolla do të ngriten klube të nxënësve për mirëmbajtje bazike të pajisjeve të TIK-ut. Këto klube do të përbëhen nga nxënës që shprehin interesim për TIK-un dhe do të jenë nën udhëheqje të mësime të ndërhënësit të TIK-ut. Klubet do të funksionojnë mbi bazë vullnetare, ndërsa për nxënësit do të hartohen programe aftësimi, ku synohet edhe pjesëmarrja e barabartë gjinore. Po ashtu, klubet do të kenë komunikim të drejtpërdrejtë me ekipet komunale të specialistëve të TIK-ut/IT-së.

Pajisja e IEAA-ve (edhe e IAL-ve) me shumë pajisje të TIK-ut nënkupton që për përdorimin e tyre duhet të sigurohen edhe softuerë të licencuar të negociuar për nevoja arsimore. Prandaj, parashihet që për këto pajisje të sigurohen me kosto të volitshme softuerë të licencuar (sistem operativ dhe pako tjera të softuerëve të domosdoshëm), me kusht që për nxënësit dhe studentët këto licenca do të jenë pa pagesë. Pavarësisht kësaj, të mësime të ndërhënësit, nxënësit dhe studentët do të kultivohet gradualisht edhe kultura e shfrytëzimit të softuerëve “open source”, të cilët janë pa pagesë.

#### **Objektivi specifik 5.4:**

**Zhvillimi i kompetencës digjitale të të gjitha palët në funksion të transformimit të suksesshëm digjital të arsimin dhe zhvillimit të përgjithshëm shoqëror**

Duke marrë parasysh zhvillimet e fundit globale dhe vendore në fushën e teknologjisë dhe duke vlerësuar se edhe gjeneratat e ardhshme të Kosovës mund të konsiderohen “digital natives”, atëherë bëhet e qartë që Kosova duhet të punojë maksimalisht në zhvillimin e kompetencës digjitale të të gjithë qytetarët e vet përmes sistemit arsimor. Kompetenca digjitale është një nga tetë kompetencat e përfshira në Kuadrin Evropian të kompetencave kyçe për mësimin gjatë gjithë jetës dhe ka të bëjë me aftësinë e individit për shfrytëzimin dhe ndërveprimin konfident, kritik dhe të përgjegjshëm me teknologji digjitale me qëllim të të nxënës, të kryerjes së detyrave të punës dhe të pjesëmarrjes në shoqëri. Ajo përfshin të kuptuarit e informacionit dhe të dhënave, komunikimin dhe bashkëpunimin, të kuptuarit e medias, krijimin e përmbajtjes digjitale (përfshirë kodimin), sigurinë (përfshirë mirëqenien digjitale dhe sigurinë në internet), çështjet që kanë të bëjnë me pronën intelektuale, si dhe zgjidhjen e problemeve dhe të menduarit kritik e krijues. Së këndejmi, kultivimi i kompetencës digjitale tek të gjithë qytetarët është e një rëndësie të madhe dhe barrën kryesore për këtë e bartë sistemi i arsimin dhe institucionet arsimore të të gjitha niveleve.

Fillimisht, MASHTI do të përcaktojë dhe zyrtarizojë dokumentet bazë, të cilat do të shërbejnë si orientim për zhvillimin dhe kultivimin e kompetencës digjitale te të gjitha palët. Këto dokumente janë tri dokumentet kryesore të BE-së për kompetencën digjitale, përkatësisht tri dokumentet në vijim:

- 1 Korniza Evropiane e Kompetencës Digjitale për Qytetarët (DigComp).
- 2 Korniza Evropiane e Kompetencës Digjitale për Mësimdhënësit (DigCompEdu).
- 3 Korniza Evropiane e Kompetencës Digjitale për Organizatat Arsimore (DigCompOrg).

Pas zyrtarizimit, këto dokumente do të përkthehen dhe përshtatën në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e komuniteteve. Pastaj do të hartohen udhëzues praktikë për zbatimin e këtyre tri kornizave, përfshirë kategorizimin niveleve të ndryshme të zotërimit të kompetencave të ndryshme për secilën kategori, si dhe do të krijohen/adaptohen instrumentet për vlerësimin e kompetencës digjitale te kategori të ndryshme në përputhje me këto tri korniza.

Për zhvillimin e kompetencës digjitale te të gjitha palët (mësimdhënës, staf akademik, nxënës, studentë, personel tjetër i institucioneve të fushës së arsimit, etj.) në përputhje me tri dokumentet e përmendura më sipër parashihen intervenime të ndryshme në nivele dhe forma të ndryshme, por gjithsesi duhet theksohet se para çfarëdo ndërhyrjeje në këtë drejtim, fillimisht do të bëhen analiza, hulumtime ose vlerësime të mirëfillta për nivelin e kësaj kompetence dhe për nevojat e mënyrat e zhvillimit të saj te kategori të ndryshme dhe vetëm pas kësaj do të ndërmerren masat e nevojshme apo të bëhen ndërhyrjet e duhura.

Zhvillimi i kompetencës digjitale te mësimdhënësit aktualë të arsimit parauniversitar parashihet të realizohet kryesisht përmes programeve të trajnimit, të cilat do të konceptohen dhe përgatiten për këtë qëllim, në mënyrë që mësimdhënësit të aftësohen për përdorimin e teknologjive digjitale për nevoja arsimore dhe në të njëjtën kohë ta kultivojnë kompetencën digjitale te nxënësit. Ndërsa, për zhvillimin e kompetencës digjitale te mësimdhënësit e ardhshëm parauniversitarë, parashihet të intervenohet në kuadër të programeve përkatëse të studimeve, ku këta studentë përgatiten për mësimdhënës të ardhshëm. Ndërsa, sa i përket përgatitjes së mësimdhënësve të ardhshëm të TIK-ut, parashihet zhvillimi dhe hapja e një programi të ri Bachelor në FE të UP-së për këtë qëllim.

Sa i përket zhvillimit të kompetencës digjitale te personeli akademik i IAL-ve, në nivel të politikave parashihet që kompetenca digjitale e personelit akademik futet si kërkesë – standard i ri në UA-në përkatës që e rregullon këtë çështje, ndërsa do t'ju kërkohet që të përfshijnë në planet e tyre për zhvillim profesional të personelit akademik edhe fushën e kompetencës digjitale për mësimdhënie dhe kërkime shkencore, në mënyrë që të ofrojnë mundësi trajnimi për personelin akademik për zhvillimin e kësaj kompetence.

Për zhvillimin e kompetencës digjitale te nxënësit parashihen ndërhyrje të ndryshme që përfshin: përfshirjen më të madhe të përmbajtjeve mësimore që e zhvillojnë kompetencën digjitale te nxënësit në kuadër të të gjitha lëndëve mësimore; rishikimin dhe përditësimin e përmbajtjeve mësimore të lëndës së TIK-ut në mënyrë që kjo të jetë në përputhje me nevojat e nxënësve për zhvillimin e kompetencës digjitale te ta; fillimin e kultivimit të kompetencës digjitale te nxënësit në moshë sa më të re te ta

përmes lëndëve ekzistuese apo përmes lëndëve të reja, si kodimi, programimi, etj.. Veç këtyre, do të bëhet vlerësim sistematik i nivelit të kompetencës digjitale te nxënësit, në mënyrë që praktikat të përmirësohen vazhdimisht. Gjithashtu, institucionet prej nivelit të ministrisë e deri në nivel të IEAA-ve, do të organizojnë aktivitete të ndryshme që i kontribuojnë zhvillimit dhe promovimit të kompetencës digjitale te nxënësit.

Krahas fokusit për zhvillimin e kompetencës digjitale te nxënësit, do të punohet edhe me IAL për zhvillimin e kompetencës digjitale te studentët, në mënyrë që studentët e të gjitha drejtimeve të jenë në gjendje që ta përdorin teknologjinë digjitale në profesionin e tyre të ardhshëm. Për realizimin e saj parashihet që MASHTI përmes ndryshimit të UA-së përkatës, ta bëjë të detyrueshme si kusht për akreditim për secilin program studimi të IAL-ve përfshirjen dhe zhvillimin e kompetencës digjitale te studentët. Kjo do të përcillet me udhëzime më të detajuara që lidhet me përfshirjen e kompetencës digjitale te studentët si çështje ndërkurrikulare në programet akademike, vlerësimin e kompetencës digjitale te studentët, si dhe mënyrën e raportimit për zhvillimin e kompetencës digjitale te studentët nga IAL në raportet e vetëvlerësimit të IAL dhe në raportet e AKA-s.

Përveç te kategoritë e mësipërme, kompetenca digjitale parashihet të zhvillohet edhe te personeli administrativ, menaxherial, udhëheqës e profesional jo mësimdhënës i të gjitha institucioneve arsimore (MASHTI, DKA, IEAA, IAL, Agjenci, Institute, etj.). Kjo parashihet të bëhet kryesisht përmes programeve të trajnimit. Krahas kësaj parashihet që MASHTI të hartojë një udhëzues për përgatitjen dhe ofrimin e programeve trajnuese në fushën e kompetencave digjitale për organizatat arsimore (përfshirë personelin e tyre), i cili do të përmbajë udhëzime për planin digjital të institucionit arsimor, udhëheqjen digjitale, vlerësimin e institucionit, sigurimin e cilësisë në këtë fushë, përfshirjen adekuate gjinore, përfshirjen dhe mbështetjen e prindërve në arsimin digjital, etj.

#### **Objektivi specifik 5.5:**

*Krijimi i mekanizmave institucionale që mundësojnë realizimin e digjitalizimit dhe përdorimin e teknologjisë në fushën e arsimit në mënyrë efektive dhe efikase*

Realizimi i digjitalizimit dhe përdorimi i teknologjisë digjitale në fushën e arsimit në Kosovë, ashtu siç parashihet me këtë dokument, nuk është i mundshëm pa u krijuar mekanizmat e duhur institucionale që mundësojnë realizimin e digjitalizimit dhe përdorimin e teknologjisë në fushën e arsimit në mënyrë efektive dhe efikase. Prandaj, për këtë parashihet krijimi i Divizionit për Teknologji dhe Digjitalizim në Ministrinë e Arsimit dhe punësimi i zyrtarëve për Teknologji dhe Digjitalizim në MASHTI. Gjithashtu, parashihet punësimi i Koordinatorëve për Teknologji dhe Digjitalizim nga DKA-të për përkrahjen e IEAA-ve për përdorim të teknologjisë dhe digjitalizimit në arsim. Veç këtyre, parashihet që edhe institucionet tjera (IAL, Agjencitë, Institutet, etj.) të punësojnë ose të caktojnë Koordinatorë për Teknologji dhe Digjitalizim.

Ndërsa, siç u përmend te objektivi specifik 5.3, për nevoja të mirëmbajtjes së rrjetit dhe pajisjeve teknologjike nëpër IEAA, do të punësohen Zyrtarë të IT-së nga DKA-të, përkatësisht në komuna (në nivel të DKA-ve) do të krijohen njësi të veçanta të specialistëve të TIK-ut/IT-së, detyrë e të cilëve është mirëmbajtja e pajisjeve të TIK-ut dhe e rrjetit të internetit në IEAA. Struktura organizative e këtyre njësive do të përcaktohet me akt nënligjor të veçantë, duke u bazuar në numrin e IEAA-ve që ka komuna përkatëse dhe teknologjinë digjitale që posedojnë ato. Ekipet e tilla duhet t'u shërbejnë IEAA-ve e komunës përkatëse online ose të intervenojnë në hapësirat e shkollës kur paraqitet nevoja. Po ashtu, ekipet duhet të kenë një buxhet për pjesë këmbimi ose komuna duhet të lidhin kontratë me kompani lokale për riparimin e pajisjeve kur nevojitet këmbimi i pjesëve.

Me rastin e punësimit parashihet që të bëhet edhe trajnimi i personelit të punësuar në Ministri, DKA, IAL, Agjenci, Institute, të cilët kanë përgjegjësi për realizimin e digjitalizimit dhe përdorimin e teknologjisë në fushën e arsimit në Kosovë.

#### **Treguesit e ndikimit:**

- Disponueshmëria e të dhënave, shërbimeve dhe proceseve digjitale në fushën e arsimit që ofrohen në platformën gjithëpërfshirëse digjitale të arsimit.
- Numri i orëve mësimore për të cilat janë zhvilluar materiale mësimore digjitale.
- Numri i pajisjeve të reja teknologjike për qëllime arsimore të blera për IEAA dhe IAL.
- Përqindja e mësimdhënësve, personelit udhëheqës e administrativ të institucioneve arsimore dhe nxënësve, e ndarë sipas gjinisë, që dëshmojnë kompetencë digjitale themelore në fusha përkatëse që lidhen me rolin e tyre.
- Numri i të punësuarve në nivele dhe lloje të ndryshme të institucioneve që mundësojnë realizimin e digjitalizimit dhe përdorimin e teknologjisë në fushën e arsimit.

#### **Treguesit e rezultateve:**

- Hartimi dhe zbatimi i legjislacionit për digjitalizimin dhe dokumentacionin në formatin digjital.
- Përqindja e popullimit të platformës digjitale të arsimit me të dhëna për të gjitha nivelet dhe llojet e institucioneve.
- Numri i shfrytëzuesve të platformës digjitale të arsimit sipas kategorive (nxënës/student, personel i IEAA-ve/IAL-ve, qytetarë, zyrtarë, etj.).
- Numri i personelit kyç që dëshmon kompetencë për t'i kontribuar digjitalizimit në fushën e arsimit, në proceset për të cilat kanë përgjegjësi institucionale.
- Hartimi dhe zbatimi i legjislacionit dhe standardeve për materiale mësimore digjitale.
- Klasat, nivelet, kategoritë, për të cilat janë prodhuar dhe miratuar materiale mësimore digjitale.
- Numri i nxënësve që furnizohen nga MASHTI dhe DKA- të me pajisje teknologjike (laptopë) brenda vitit.
- Numri i mësimdhënësve të aftësuar për përdorimin e materialeve mësimore digjitale në procesin mësimor.
- Përqindja e IEAA-ve që kanë qasje në internet Broadband dhe që kanë shtrirje të rrjetit të internetit deri në nivel klase.
- Raporti nxënës- kompjuter në arsimin parauniversitar.
- Numri i licencave të paguara për vit për user/kompjuterë për qëllime arsimore.
- Numri i nxënësve dhe studentëve që përfitojnë licenca falas për vit për kompjuterë për qëllime arsimore.
- Përqindja e mësimdhënësve/edukatorëve në shërbim dhe atyre të ardhshëm në arsimin parauniversitar që dëshmojnë nivel themelor të zotërimit të kompetencës digjitale për mësimdhënës (bazuar në DigCompEdu).
- Numri i personelit akademik në IAL të aftësuar/avancuar për përdorimin e teknologjisë digjitale për mësimdhënie e kërkime shkencore dhe për kultivimin e kompetencës digjitale te studentët.
- Përqindja e nxënësve që dëshmojnë nivel themelor të zotërimit të kompetencës digjitale për qytetarë (bazuar në DigComp) me rastin e përfundimit të klasës së nëntë dhe nivel mesatar me rastin e përfundimit të klasës së dymbëdhjetë.
- Përqindja e institucioneve arsimore (IEAA, IAL, DKA, MASHTI, Agjencitë, Institutet) që i përmbushin kërkesat bazë të kompetencës digjitale për organizatat arsimore (bazuar në kornizën DigCompOrg).
- Numri i zyrtarëve për Teknologji dhe Digjitalizim në arsim të punësuar në Ministri.
- Numri i zyrtarëve të IT- së të punësuar nga DKA-të për mirëmbajtjen e rrjetit dhe pajisjeve teknologjike nëpër IEAA.




- Numri i koordinatorëve për Teknologji dhe Digjitalizim të punësuar nga DKA-të për përkrahjen e shkollave për përdorim të teknologjisë dhe digjitalizimit në arsim.
- Numri i koordinatorëve për Teknologji dhe Digjitalizim të caktuar/punësuar nga IAL. Agjencitë, Institutet, etj..

## 6. Zbatimi, monitorimi dhe raportimi

Procesi i zbatimit, monitorimit dhe raportimit të SA 2022-2026, është i ndërlidhur dhe koordinohet me procesin e njëjtë të SKZH 2030. Për të siguruar konsistencë të këtij procesi, SA përcjellë formën e kaskadimit duke u ndërlidhur me SKZH 2030 sikur në figurën më poshtë.

Figura 9.: Kaskada e ndërlidhjes së SA dhe SKZH



## 6.1. Mekanizmat për zbatim


Përgjegjësia primare për zbatimin e Strategjisë së Arsimit, i takon Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), roli i së cilës është zhvillimi dhe vënia në zbatim e politikave arsimore në vend. Në varësi nga objektivat strategjikë, në proces duhet të përfshihen ministrinë e linjës, universitetet, institutet, agjencitë e institucionet tjera relevante në Kosovë. Është me rëndësi edhe përfshirja aktive në proces e komunave, të cilat janë përgjegjëse për funksionimin e institucioneve të nivelit parauniversitar brenda territorit të tyre, si dhe e vet institucioneve të arsimit parauniversitar dhe atyre të arsimit të lartë si pjesëtare e përfituese të drejtpërdrejta nga aktivitetet e SA.

MASHTI duhet të sigurojë një bashkërenditje të mirë dhe efikase me nismat e partnerëve zhvillimorë të Qeverisë, ku bëjnë pjesë donatorët, si dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare që, në një mënyrë ose tjetër, shprehin gatishmëri për t'i kontribuar zbatimit të SA.

Gjithashtu, në kuadër të strukturës së vet organizative, MASHTI duhet të sigurojë fuqizimin e divizioneve dhe departamenteve të caktuara në mënyrë që të sigurohen kapacitetet e nevojshme profesionale për zbatimin me sukses të SA. Për këtë arsye, në kuadër të procesit të ristrukturimit të brendshëm, MASHTI do të planifikojë angazhimin dhe punësimin e personelit përkatës në fusha/ sektore të caktuara të veprimtarisë së saj.

MASHTI do të krijojë Grupin për Zbatimin e SA i cili drejtohet nga Ministri (ose Zëvendësministri në emër të tij/saj); i koordinuar nga Sekretari i përgjithshëm dhe në përbërje të të cilit janë zyrtarët përgjegjës të njëjësive organizative të MASHTI të ngarkuara me zbatimin e aktiviteteve të SA, si dhe përfaqësues nga Zyra për Planifikim Strategjik dhe Ministria e Financave.

Figura 10: Kuadri institucional për monitorim dhe raportim



**Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij grupi janë:**

- Hartimi i planeve vjetore të veprimit për zbatimin e SA;
- Hartimi i buxhetit vjetor për zbatimin e SA në kuadër të kufijve buxhetorë të përcaktuar me KASH dhe me qarkoret buxhetore përkatëse;
- Analiza e progresit në zbatimin e SA, në bazë të informatave të mbledhura nga MASHTI dhe burimet e tjera;
- Shqyrtimi dhe miratimi i masave plotësuese për të siguruar zbatimin e SA;
- Hartimi i kërkesave për mbështetje nga programet e donatorëve me qëllim të sigurimit të zbatimit të SA.

Ky grup do të takohet të paktën një herë në dy muaj, ndërsa mbështetja teknike do të ofrohet nga Zyra e Sekretarit të përgjithshëm ose njësi organizative që cakton Sekretari.

Të paktën dy herë në vit, takimet e Grupit për zbatimin e SA do të mbahen në përbërje të zgjeruar, me pjesëmarrje të përfaqësuesve të IAL-ve, Agjencive, Instituteve, Asociacionit të Komunave të Kosovës, partnerëve zhvillimorë dhe palëve të tjera të interesit që ftohen nga kryesuesi.

Në secilën komunë do të emërohet zyrtari përgjegjës për koordinimin e zbatimit të aktiviteteve të SA brenda komunës me qëllim të koordinimit të planeve zhvillimore komunale me aktivitetet e SA. Komunikimi me këta zyrtarë komunal do të jetë përgjegjësi e Departamentit/Divizionit përgjegjës kryesor për planifikim në arsim në MASHTI.

## 6.2. Monitorimi dhe raportimi

Monitorimi duhet të kuptohet si proces i vazhdueshëm që synon të sigurojë informacion për MASHTI dhe palët me interes për progresin drejt arritjes së objektivave strategjike. Raportimi është pjesë integrale e monitorimit, me synim të ofrimit të informacionit thelbësor në mënyrë sistematike dhe në kohën e duhur në intervale të caktuara kohore.

Monitorimi i SA-së do të bëhet në dy nivele:

- 1 **Monitorimi i aktiviteteve** me të cilin përcaktohet nëse aktivitetet janë kryer në kohën e duhur dhe në cilësinë e duhur. Mjeti kryesor për monitorimin e aktiviteteve është plani i veprimit, i cili përcakton kalendarin e implementimit për secilin aktivitet. Sa herë që veprimtaritë e ndryshme devijojnë nga orari i tyre, duhet të shihet se a ka pasoja për veprimtaritë dhe burime të tjera. Arsyet e devijimeve të tilla duhet analizuar, ndërsa plani i zbatimit duhet të korrigjohet në aspektin kohor. Nëse vonesa e veprimtarive ndikon në orarin e implementimit të veprimtarive të tjera, atëherë MASHTI duhet të reagojë duke i përshtatur planet dhe duke bërë rindarjen e burimeve ekzistuese. Burimet duhet të jenë në dispozicion në kohën e duhur, edhe atë me cilësi dhe sasi të duhur. Koha e nevojshme për t'i siguruar burimet shpesh nënvlerësohet. Kjo ka të bëjë me burimet njerëzore dhe ato fizike. Për të siguruar likuiditetin e zbatimit, duhet monitoruar vazhdimisht sasia e fondeve që janë në dispozicion, përfshirë situatën në buxhetin publik, etj. Nëse partnerë të tjerë i kontribuojnë financimit të veprimtarive të SA, duhet të sigurohemi se mund t'i plotësojnë kushtet financiare. Menaxhimi i SA duhet të sigurojë se planifikimi i veprimtarive reflekton kohën e nevojshme për mobilizimin e burimeve.

- 2 Monitorimi i objektivave** bazohet në treguesit e tyre. Treguesit kanë vlerën bazë, synimin e ndërmjetmë dhe synimin e vitit të fundit në përputhje me periudhën e dokumentit strategjik. Që monitorimi të jetë efektiv, synimet e ndërmjetme duhet të caktohen në baza vjetore, duke u bërë pjesë e planit vjetor të punës. Atëherë, përfundimi nxirret përmes krahasimit të vlerës aktuale me synimin e përcaktuar.

Monitorimi i mirë nënkupton mbledhjen në vazhdimësi të të dhënave në lidhje me SA, qoftë përmes vizitave në terren, takimeve me palët relevante apo analizës së dokumentacionit dhe raporteve në dispozicion.

Ashtu siç kërkohet me nenin 16 të Udhëzimit administrativ, MASHTI do të përgatisë 2 raporte:

- Raportin gjashtëmujor për zbatimin e planit të veprimit të SA
- Raportin vjetor mbi zbatimin e SA.

- 1 Raporti gjashtëmujor** përgatitet për të përcjellë zbatimin e planit të veprimit. Ai përgatitet deri në fund të muajit pas periudhës raportuese. Raporti i parë i gjysmëvjetorit mbulon 6 muajt e parë të vitit, ndërsa raporti i dytë i gjysmëvjetorit përfshin periudhën prej 12 muajsh. Raporti fokusohet në përfundimin e veprimeve siç parashihen në planin e veprimit, arsyet për vonesa, rreziqet që lidhen me zbatimin e veprimeve dhe hapat e ardhshëm. Në vijim është dhënë formati i përgjithshëm i raportit gjashtëmujor:

- Plani i punës për periudhën e raportimit.
- Përshkrim narrativ i punës së bërë aktualisht.
- Përshkrimi i problemeve të ndeshura dhe shpjegime të shmangieve të mëdha nga plani i punës.
- Përmbledhje e shpenzimeve të planifikuara për gjashtëmujorin e shoqëruar me ndonjë koment apo shpjegim.
- Rekomandim për përmirësimin e planit të zbatimit, ndryshimin e masave, buxhetit, etj.
- Plani i punës për periudhën e ardhshme gjashtëmujore.

- 2 Raporti vjetor** përgatitet për të dhënë një llogari në zbatimin e dokumentit strategjik. Ai përgatitet deri në fund të tremujorit të parë të vitit vijues. Fokusi i raportit vjetor është si vijon:

- Arritja e objektivave krahasuar me objektivat e treguesit (të paktën për dy vitet e fundit).
- Përfundimi në kohë i veprimeve të ndërmarra.
- Përdorimi i burimeve financiare.
- Pengesat kryesore në zbatim.
- Masat korrektuese.

Formati i përgjithshëm i raportit vjetor është dhënë në vijim:

- 1** Përmbledhje ekzekutive.
- 2** Plani i punës për periudhën e raportimit dhe vlerat e synuara të objektivave strategjike dhe specifike.
- 3** Pasqyrë përmbledhëse për zbatimin e aktiviteteve të SA (në formë tabelare):
  - a. Përshkrimi i ndonjë problemi të ndeshur dhe shpjegime të shmangieve të mëdha nga plani i punës.

- b. Përmbledhje e shpenzimeve të planifikuara vjetore e shoqëruar me ndonjë koment apo shpjegim.
- 4 Pasqyrë përmbledhëse e përmbushjes së objektivave, duke bërë krahasimin e vlerave të synuara të treguesve me ato aktuale dhe komente eventuale për shmangie nga planifikimi.
  - 5 Rekomandim për përmirësimin e planit të zbatimit, ndryshimin e aktiviteteve, buxhetit, ridefinimin e objektivave ose treguesve të tyre.
  - 6 Plani i punës për vitin vijues.
  - 7 SHTOJCA: Të dhënat e nevojshme për dokumentimin e arritjes së treguesve (p.sh. numri i objekteve të ndërtuara për shërbime të EFH, numri i mësimitdhënësve të trajnuar sipas komunave, lista e shkollave të pajisura me internet, etj.)

### 6.3. Vlerësimi

Vlerësimi është procesi më i hollësishëm për të analizuar suksesin e zbatimit të strategjisë, duke identifikuar se çfarë ka shkuar mirë, duke shqyrtuar arsyet prapa asaj që ka shkuar keq dhe pastaj duke ripërshtatur drejtimin strategjik në përputhje me rrethanat. Dizajni dhe ekzekutimi i fazës së vlerësimit zakonisht është i pavarur nga korniza e rregullt e monitorimit dhe raportimit. Vlerësimi përfshin përpilimin e pyetjeve të vlerësimit, mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për të marrë përgjigjet e këtyre pyetjeve, dhe mbledhjen e provave për të formuluar përfundimet dhe rekomandimet.

MASHTI do të kërkojë ndihmën e partnerëve zhvillimorë që të bëhen tri vlerësime të jashtme të SA, pas përfundimit të vitit të dytë, të katërt dhe të pestë/gjashtë të SA. Dimensionet e vlerësimeve do të jenë si më poshtë:

- 1 **Relevanca** - përputhshmëria e qëllimeve dhe objektivave të programit me nevojat e qytetarëve dhe prioritetet e Qeverisë;
